Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (111). KORRIK 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

Gjenden xhevahire në Shpellën e Rusit në Çidhën



Nga datat 4 -11 korrik, 11 speleologë bullgarë eksplorojnë shpellën e Rusit në Çidhën dhe shpellën ujore të Sopanikës në burimet e Setës. Zbulimet mahnistin shkencëtarët dhe të dhënat që pritet të publikohen së shpejti mund të çojnë në riklasifikimin e zonës si pasuri e mbrojtur kombëtare dhe rritjen e numrit të turistëve. Gëzohen ambjentalistët: Ky zbulim mund të ndalojë ndërtimin e HEC-it në lumin Seta.

SPECIALE FAQE 13,24

- "Shpella e Rusit është një humnerë vertikale. Në ekspeditën e mëparshme që u zhvillua në vitin 2013, ne arritëm vetëm 60 metra në thellësi, ndërsa këtë vit ne kemi arritur deri në 200 metra dhe akoma fundi i shpellës nuk shihet".
- "Shpella e Rusit, në disa sektorë është shumë e gjerë dhe e pasur. Atje ka stalaktite, stalagmite, xhevahire – gjithçka që mund të shihet nën tokë. Është një shpellë shumë e bukur".

Reportazh

Në Dibër, aty ku dhe ëndrrat shihen me rrugën e Arbrit, Radikën dhe Amerikën



Një fundjavë në Dibër: Nga kufiri si postobllok te projekti i Mennyt "Dibra 4K Video", turizmi, festa e SHBA, punimet në shëtitore, problemet e ekosistemit. Një qytet që po ndryshon në pritje të fëmijëve që kthehen me pushime dhe lajmeve të mira për Rrugën e Arbrit dhe Radikën.

FAQE 4-5

Veprimtari

Nazmi Koçi, "Qytetar Nderi i Peshkopisë"

FAQE 18

Na mblodhe përsëri, o Naim Plaku!

FAQE 20

Turizmi, një mundësi e pashfrytëzuar

■ Turizëm në tokën ku Korabi përkëdhel Lurën ■ Lumi Drin, një destinacion pushimi ■ Turizmi në Mat, burim kulture, punësimi dhe kënaqësie

- **Dibra ka shumë ç'të ofrojë, pasi është rajoni më i pazbuluar për turistët e huaj. Natyra e virgjër, mjetet tradicionale të punimit të tokës dhe transportit shfaqin interes për turistët e huaj.**
- **Dibra ofron mundësi të mira turistike, sidomos në atë malor, historik, alpinistik, aventuresk, agroturizëm, balnear, dashamirës të faunës, peshkim, hipizëm etj.**
- **Deri më tani zyrtarët lokalë planifikonin mbi 10 veprimtari në vit, që synojnë propagandimin e kulturës, traditës, folklorit dhe festat popullore, si një mundësi për shtimin e lëvizjes së turistëve në Dibër, por deri më tani vetëm "Oda Dibrane" ia ka dalë të bëhet një veprimtari e përvitshme.**
- **Shqipëria është një vend që ofron turizmin e aventurës dhe një ndër këto vende ideale është rrethi i Dibrës.**
- **Rafting në Dri, një nga risitë e turizmit gjatë këtij viti.**

Turizmi: çfarë ofron Dibra për turizmin gjatë gjithë vitit, destinacionet, resurset e pashfrytëzuara, shërbimi hotelerik, problemet e shfaqura dhe çfarë duhet bërë që kjo ekonomi lokale të vihet në shfrytëzim.

Raport special nga BUJAR KAROSHI, HAMDI HYSUKA, MIRAN TAFA

FAQE 2-10,13,24



cyan magenta yelloë black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (111). 1 - 31 Korrik 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Miran TAFA
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Adem BUNGURI
Hamdi HYSUKA
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Sulejman TOMÇINI
Dionis XHAFA
Përparim TOMÇINI
Arjeta TAFÇIU
Edmond HASANI
Ilmi DERVISHI
Samet ZAGRADI
Ramazan BUCI
Viron KONA
Elmaz LALA
Zabit LLESHI
Mevlud BUCI
Jahe DELIA (SELMANI)

Falenderojmë: Natasha MAZARI, Edi TRUKA dhe Hamit SALKURTI për ndihmën e dhënë në përgatitjen e këtij numri.

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Turizmi në Dibër, një mundësi e pashfrytëzuar

Nga **BUJAR KAROSHI**


Foto: © Hamit Salkurti

Dibra ofron mundësi turistike në të gjitha stinët e vitit, por gjatë verës këto mundësi shtohen, duke tërhequr dashamirësit e ecjeve në natyrë, eksploruesit e shpellave, rrënojave të kalave dhe kishave të vjetra, por edhe vizitorët e liqeneve akullnajorë të Lurës dhe Balgjajt.

Por, ndërkohë që mundësi të tilla janë të pakufizuara dhe numri i turistëve vazhdon gjithmonë në rritje, kjo nuk ka arritur të lëvizë ekonominë lokale, të ardhurat e së cilës janë në shifra minimale.

Një ligj mbi turizmin u miratua në Parlamentin shqiptar më 27 korrik. Ligji synon të formalizojë veprimtarinë e operatorëve turistikë në vend, gjë e cila jo vetëm që do të rrisë të ardhurat në buxhet, por do të synojë edhe përmirësimin e shërbimeve që ofrojnë operatorët turistikë ndaj klientëve.

Dy vite më parë, gjatë një vizite në një panair turistik në Tiranë, kur e pyeta drejtuesin e një agjencie të madhe turistike, nëse kishin guida për rajonin e Dibrës, më pa me dyshim dhe tha shkurt dhe ftohtë: "Jo!"

Pyetjes time se pse nuk ofronte shërbime turistike në këtë rajon, ai më tha se "dibranët janë të mirë e mikpritës, ka edhe shumë vende interesante për vizitorët, por nuk kanë mësuar akoma të presin turistë, kryesisht të huaj". Dhe për këtë, ai me renditi brenda një minute më shumë se njëzet arsye, duke filluar nga çmimet që luhaten shpesh brenda një agjende turistike, deri te kultura e shërbimit.

Si paraqitet turizmi në rajon? Çfarë mundësish turistike fsheh Dibra? Çfarë problemesh paraqiten? Si është shërbimi dhe çfarë pritet të përmirësohet në të ardhmen, në mënyrë që kjo degë e ekonomisë lokale të marrë zhvillim?

DIBRA, MUNDËSITË TURISTIKE

Deri më tani zyrtarët lokalë planifikonin mbi 10 veprimtari në vit, që synojnë propagandimin e kulturës, traditës, folklorit dhe festat popullore, si një mundësi për shtimin e lëvizjes së turistëve në Dibër, por deri më tani vetëm "Oda Dibrane" ia ka dalë të bëhet një veprimtari e përvitshme. Por, edhe ajo, nuk ka arritur të sjellë flukse turistike, duke mos folur për të ardhurat lokale nga kjo veprimtari që kanë qenë pothuajse të pandjeshme, së paku për operatorët turistikë në qytet.

"Dibra ofron mundësi të mira turistike, sidomos në atë malor, historik, alpinistik, aventuresk, agroturizëm, balnear, dashamirës të faunës, peshkim, hipizëm etj.," - thotë Hamit Salkurti, i cili operon në këtë fushë në më shumë se një dekadë.

Natasha Mazari, e cila së bashku me motrën e saj, Teutën, drejtojnë agjencinë turistike "AlpJon" me qendër në Tiranë, thotë se "Dibra ka shumë ç'të ofrojë, pasi është rajoni më i pazbuluar për turistët e huaj. Dibra ofron mundësi për udhëtimet në natyrë, ecjet me kalë, peshkim në Dri. Gjithashtu, natyra e virgjër, mjetet tradicionale të punimit të tokës dhe transportit, shfaqin interes për turistët e huaj".

"Shumëllojshmëria e bimëve dhe e luleve është një mundësi e shkëlqyer në periudhën maj-qershor për adhuruesit e natyrës', - thekson Natasha.

"Shqipëria është një vend që ofron turizmin e aventurës dhe një ndër këto vende ideale është rrethi i Dibrës", - thotë Edi Truka, menaxher i Peshkopia Backpacker Hostel (PBH), duke ofruar turizmin malor, turizmin e bardhë (gjatë dimrit, ski), turizmin lumor, liqenor (liqenet artificiale) dhe gjithashtu peshkimin.

DESTINACIONET

"Destinacioni më i preferuar është Korabi dhe Lura, - thotë Edi Truka, - sepse janë dy vende që njihen dhe që gjenden në çdo guidë turistike në internet, si dhe ka shumë shkrime, sidomos në anglisht, që i reklamojnë këto destinacione".

Parku natyror Korab - Koritnik, që shtrihet mes tre shtetesh, Shqipëri-Kosovë-Maqedoni, është një guidë e njohur për eksploruesit e natyrës. Një rrugë këmbësore është hapur vitin e kaluar me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Ndërsa në çdo fshat nga Bllata në Kala të Dodës janë vendosur tabela turistike të financuara nga ANTTRAC, një organizatë që mbështet forcimin e institucioneve lokale për një zhvillim të qëndrueshëm.

Parku Kombëtar i Lurës me 7 liqenet e saj është një dëshirë turistike që e kërkojnë shumë, por gjithashtu edhe liqenet e Balgjajt, që shtrihen në masivin malor mes Bulqizës, Selishtës dhe Matit, është një destinacion i kërkuar vitet e fundit.

"Por nuk duhen harruar edhe destinacionet e tjera që ne po mundohemi të promovojmë, - thotë Truka, - i cili përmend gjeomonumentet, hidromonumentet dhe biomonumentet e qarkut të Dibrës.

Agjencia e tij turistike ka ofruar këtë vit edhe rafting në Lumin Drin, e cila ka qenë një për turistët e huaj si dhe ka ngjallur interesin e turistëve brenda dhe jashtë vendit.

Pasuritë natyrore të rajonit janë të lidhura edhe me trashëgiminë kulturore dhe historike të banorëve vendas, duke formuar kështu baza të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.

Sipas Edi Trukës, në Dibër ka pasur një zhvillim të madh të artizanëve të ndryshëm, si zejtarët, rrobaqepësit, zdukthtarët apo edhe specialistë në fushën e bujqësisë, frutikulturës etj. Gjithashtu, në fushën e sportit ekipi i Korabit ka pasur suksese ndër vite, si në volejbolli, mundje, alpinizëm. Po ashtu, edhe të rinjtë e cirkut e kanë bërë të njohur Dibrën gjatë viteve të fundit. Të gjitha këto janë një mënyrë për të njohur Dibrën, por edhe për të thirrur vizitorë.

Edhe në fushën e kulinarisë, recetat tradicionale dibrane janë shumë të shijshme për vizitorët. Sheqerparja, gurabijet, jufkat me pule, qepa e Ramazanit", etj., gatime, janë shumë të shijshme për turistët dhe krejt origjinale.

Kullat karakteristike janë në interesin e vizitorëve. Kulla e Zunës në Sohodoll, banesa e Zef Doçit në Lurë, ajo e Dine Hoxhës në Muhurr e shumë të tjera, janë ndër më të kërkuarat.

Gjithashtu, në Dibër mund të vizitohen edhe xhami dhe kisha karakteristike. Xhamia


Rafting në lumin Drin,
një nga risitë e turizmit gjatë kësaj vere
Foto: © PBH

turizëm

- **Deri më tani zyrtarët lokalë planifikonin mbi 10 veprimtari në vit, që synojnë propagandimin e kulturës, traditës, folklorit dhe festat popullore, si një mundësi për shtimin e lëvizjes së turistëve në Dibër, por deri më tani vetëm "Oda Dibrane" ia ka dalë të bëhet një veprimtari e përvitshme.**
- **Dibra ofron mundësi të mira turistike, sidomos në atë malor, historik, alpinistik, aventuresk, agroturizëm, balnear, dashamirës të faunës, peshkim, hipizëm etj.**
- **Dibra ka shumë ç'të ofrojë, pasi është rajoni më i pazbuluar për turistët e huaj. Natyra e virgjër, mjetet tradicionale të punimit të tokës dhe transportit, shfaqin interes për turistët e huaj**
- **Shqipëria është një vend që ofron turizmin e aventurës dhe një ndër këto vende ideale është rrethi i Dibrës**

e Allajbegisë dhe ajo e ndërtuar në vitin 2006 në Peshkopi, janë një destinacion turistik. Po ashtu, kisha e Shën Sotirit në Kërçisht, ajo e Shpërfytyrimit në Herbel shfaqin të njëjtin interes.

Kalaja e Grazhdanit është një ndër më të vizituarat, megjithëse disa shenja shpjeguese vendosur para disa vitesh, janë dëmtuar. Kalaja e periudhës së vonë romake zë një sipërfaqe prej 34 hektarësh dhe mendohet se ka qenë një ndër më të mëdhatë në Ballkan.

Një faqe në internet diber.gis-dev.com ofron informacion të vlefshëm për ata që planifikojnë të vizitojnë Qarkun e Dibrës.

"Ideja e aplikimit është krijimi i një sistemi WebGIS që mund t'i vijë në ndihmë publikut me informacione mbi pika interesi dhe vendndodhjen e tyre në qarkun e Dibrës, - thotë përmes e-mail-it Erald Kuka.

"Ky ishte një projekt i financuar fillimisht nga një OJQ, - tregon Kuka, por është zhvilluar dhe pasuruar me informacion falë dëshirës dhe pasionit të vetë kompanisë "GisDev". Për shkak se ortakët e kësaj firme janë dibranë, - thekson ai, aplikimi vazhdon të mbahet online në serverat e kompanisë pa kosto nga të tretë".

ÇFARË I MAGJEPS TURISTËT?

"Natyra, ushqimi, mikpritja, qetësia, mungesa e zhvillimit, jeta rurale", - janë disa nga gjërat që turistët, kryesisht të huaj, pëlqejnë në Dibër", - thotë Hamit Salkurti.

Ndërsa Edi Truka thotë se "gatimet tradicionale, monumentet arkeologjike dhe kulturore janë gjithmonë një gjë e veçantë për turistët". Por, sipas tij, mikpritja që gjejnë të huajt në rrugëtimin që marrin në zonat e Dibrës është ajo që i dallon zonat e tjera.

"Megjithëse shumica e mikpritësve nuk dinë anglisht, ata përshtaten menjëherë me turistët, ku jo vetëm të huajt, por edhe shqiptarët, ndjehen mirë. Shprehjet: "Mirë se erdhe!" apo "Mos ki turp, rri sikur me qenë në shtëpinë tende!", - i bëjnë turistët që të ndjejnë menjëherë qetësinë që kërkojnë në këto anë", - thotë Truka.

Turistët në Dibër vijnë nga gjithë vendet e Europës, kryesisht nga Holanda, Austria, Zvicra, Gjermania etj. Në Dibër janë vënë re edhe turistë çekë apo klube alpinistike nga ky vend. Kohët e fundit ka pasur një fluks turistësh edhe nga trevat shqiptare, kryesisht nga Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi.

"Më pëlqeu shumë Dibra", - thotë një vajzë, e cila së bashku me shokun e saj kanë marrë një tur me biçikletë nëpër Ballkan. "Këtu na pritën mirë dhe na shërbyen ushqime shumë të shijshme: Jufka me pulë, djathë i bardhë, dhallë dhe shumë gjëra të shijshme ".

Çiftin e të rinjve e takuam në fillim të korrikut pranë fshatit Erebarë, të magjepsur nga pamja që ofronte fshati, mbështjellë me ngjyrën e gjelbër të pranverës dhe të verdhën e arave me grurë, gati për t'u korrur.



"Më pëlqeu shumë Dibra", - thotë një vajzë, e cila së bashku me shokun e saj kanë marrë një tur me biçikletë nëpër Ballkan. "Këtu na pritën mirë dhe na shërbyen ushqime shumë të shijshme: Jufka me pulë, djathë i bardhë, dhallë dhe shumë gjëra të shijshme ". *Foto: B.Karoshi*

GUIDAT TURISTIKE MES REALITETIT DHE SURREALES

Turistët e huaj, kur vijnë përmes një agjencie turistike, kanë një axhendë të përcaktuar. Por shumë informacione që paraqesin guidat turistike, shpesh nga nevoja për të thithur turistë, është jo e saktë dhe shumë e ekzagjeruar për shërbimet që ofrojnë. Dhe kur turistët përballen me realitetin, mbeten të zhgënjyer. Gjithashtu, informacionet që janë shkruar në guidat turistik shpesh janë sipërfaqësore dhe mungojnë të dhënat kryesore për lëvizjen e turisteve në terren. Disa muze të paktë në rajon shpeshherë gjenden të mbyllur ose objekte turistike të reklamuara si të tilla, bëhen ta pavizitueshme për shkak të pengesave artificiale.

"Ndodh shpesh që rrugët këmbësore që të çojnë në gjeomonumente janë të zëna me gardhe, - thotë Natasha Mazari. Pronësia e pazgjidhur mbi tokën dhe mbyllja e rrugëve, edhe këmbësore, janë një pengesë e paparashikueshme për adhuruesit e ecjes në natyrë".

"Natyra e virgjër ku nuk ka infrastrukturë rrugore, rrugët e prishura dhe ushqimet e pastra bio, janë disa të veçanta të axhendave turistike në Dibër", - thotë Hamit Salkurti.

Natasha tregon se për Dibrën kanë disa guida 7 ditore dhe 5 ditore, kryesisht në atë që ajo e quan si "Community Tours".

"Ne kemi vënë re se të huajve u pëlqen se si jetohet në fshat, ndaj kemi krijuar disa guida të posaçme që lidhen me jetën në komunitet. Guida nis me fshatrat e Rabdishtit, Bellovës e Cerjanit dhe më pas zbret në fshatrat buzë Drinit, Muhurr e Fushë Alie dhe në fund ngjitet në Sllovë dhe Korab". Të njëjtën guidë "AlpJon Albania" e ka edhe për një axhendë 5 ditore.

Motrat Mazari kanë menduar që guidat e tyre turistike t'i kombinojnë edhe me ture turistike matanë kufirit, në Maqedoni.

"Shpesh klientët tanë preferojnë të vijnë në Shqipëri përmes aeroportit të Shkupit, për shkak të çmimeve më të ulëta, kështu që ne kemi menduar që të krijojmë guida të posaçme turistike, ku të përfshihen edhe Mavrova, Struga dhe Ohri. Kjo, thonë ata, mund të sjellë një rritje të turistëve në rajonin e Dibrës".

Po sa kushton një tur turistik në Dibër?

Për këtë nuk ka një çmim. Një ekspert lokal i turizmit thekson se çmimi fillon mbi 30 Euro dita, ku përfshin të gjitha shpenzimet, përveç guidës.

Është pak e vështirë të thuhet në mënyrë të prerë, pasi varet nga lloji i shërbimit që turistët apo grupet turistike kërkojnë, në varësi të ecjes në mal, guidës së përfshirë etj. Një guidë turistike në Dibër paguhet nga 50-75 Euro në ditë dhe, sa më i madh të jetë grupi, aq më pak paguajnë turistët.

Mesatarisht, sipas operatorëve turistikë që operojnë në rajon, një tur 5 ditor mund t'i kushtojë afërsisht 300 Euro, përfshirë këtu të gjitha shpenzimet.

PROBLEMET

Por më shumë se mungesa e infrastrukturës, një problem në shërbimet turistike mbetet cilësia e shërbimit dhe kushtet higjieno-sanitare.

"Higjiena në fshat nuk është në kushtet e duhura", - thotë Hamiti. Ai nënvizon se edhe niveli i ulët i shërbimit në restorante, kafe, hotele dhe shtëpitë pritëse lë shumë për të dëshiruar. Ndërsa gjatë dimrit dhe verës, kondicionerët edhe në hotelet në Peshkopi lënë për të dëshiruar.

"Ajo që i mungon turizmit në Dibër është kultura e shërbimi, - thekson Natasha Mazari. Në Dibër nuk mungon mikpritja, por mënyra se si u shërbehet turistëve është shumë larg asaj që duhet".

Një operator turistik në rajon për shërbimet që ofron në disa fshatra, kryesisht malor, merr me vete një anëtar të familjes që ofron shërbimet për turistët, pasi banorët e zonës nuk pranojnë që gratë dhe vajzat e tyre të shërbejnë në dhomat e shtruara në mënyrë tradicionale ku vendosen të huajt.

"Nivelet e shërbimeve janë tepër të ulëta, - thotë Hamit Salkurti. - Ato vështire se kuptojnë së çfarë duhet. Gjithçka e lidhin me ushqimin që do të ofrojnë në tavolinë dhe sipas tyre nënkupton sasinë e mishit dhe llojin e tij. Dhe, nëse këtë e realizojnë, ti duhet të paguash për të gjithë sasinë, pavarësisht se ushqimi që u shërbehet turistëve është shumë herë më i vogël. Në të shumtën e rasteve unë insistoj në përgatitjen e menysë për grupet që unë çoj në fshat që edhe ato të jenë të kënaqur", - tregon Hamit Salkurti.

"Në fshatra të ndryshëm ka shërbime të ndryshme, sepse nuk është investuar që në çdo fshat të ketë struktura të mirëfillta pritëse. Por duhet theksuar, se në disa fshatra janë vetë njerëzit që me bujarinë dhe mikpritjen që karakterizon gjithë zonën, ofrojnë me kënaqësi një kafe dhe një gote raki, ndoshta edhe diçka për të ngrënë, natyrisht BIO që është për t'u vlerësuar, ulur ndoshta edhe për tokë, duke bashkëbiseduar dhe ndarë hallet dhe problemet që kanë. Ky është një shërbim jo i përgatitur nga ne, ose ndryshe, spontan që turistët mbeten të magjepsur ndaj këtij fenomeni", - thotë Edi Truka.

Një problem mbetet peshkimi në lumin Drin, fatkeqësisht nuk është i shfrytëzueshëm, thotë Edi Truka.

Edhe pse kohët e fundit me anë të ligjeve në fuqi dënojnë peshkimin dhe gjuetinë e paligjshme, ka njerëz që akoma nuk e kanë kuptuar. Autoritetet duhet që të bëjnë të pamundurën që ky fenomen të zhduket dhe të japë mundësi që ta shijojmë ashtu siç duhet natyrën, gjë që doemos sjell shtimin e turistëve për njohjen e Dibrës jo vetëm nga të huajt, por edhe nga shqiptarët, që kohët e fundit është rritur interesi, për ta parë dhe shijuar".

PBH ka ofruar këtë vit rafting në lum dhe është një risi e këtij viti në Dibër.

GUIDAT TURISTIKË DHE NEVOJA PËR KUALIFIKIM

Guidat turistike në terren janë shumë të rëndësishme për agjencitë turistike. Ata paguhen nga 50 deri në 75 Euro, por shpesh ata nuk janë të përgatitur mjaftueshëm me njohuri kulturore, historike apo arkeologjike, në mënyrë që t'u ofrojnë turistëve shërbimin e kërkuar.

Sipas Natasha Mazarit, mungon bashkëpunimi i operatorëve turistikë në rajon jo vetëm për operimin me guida të përbashkëta, por edhe në shkëmbimin e përvojave pozitive apo negative që dalin gjatë punës në terren.

Natasha ka mundur të gjejë donacione për një kualifikim të të rinjve që merren me shërbimin ndaj turistëve, por nuk ka mundur të gjejë kapacitetet e nevojshme për ta thithur këtë projekt. Hotelet dhe agjencitë e tjera nuk kanë ofruar bashkëpunimin në mënyrë që të krijohej numri i mjaftueshëm i personave për një trajnim në fushën turistike.

"Në Dibër nuk është se ka një strukturë që

(Vijon në faqen 6)



Kamping në mal. Foto: © Hamit Salkurti

Rruga e Arbërit nr. 111

reportazh



Një fundjavë në Dibër: Nga kufiri si postobllok te projekti i Mennyt “Dibra 4K Video”, turizmi, festa e SHBA, punimet në shëtitore, problemet e ekosistemit. Një qytet që po ndryshon në pritje të fëmijëve që kthehen me pushime dhe lajmeve të mira për Rrugën e Arbrit dhe Radikën.

Dibra fotografuar me dron. Foto: © Gazmend Kërkuti

Në Dibër, **aty ku** *dhe* **ëndrrat shihen** *me rrugën e* **Arbrit**, *Radikën dhe* **Amerikën**

Nga **BUJAR KAROSHI**

Një fundjavë në Dibër, sidomos gjatë verës, është një mundësi e mirë për të pushuar. Sidomos kur atje të pret Gazmend Kërkuti, një nga të rinjtë dibranë, i cili jeton në Neë Jersey, por mendjen dhe zemrën i ka në Dibër, ashtu si dhe qindra të tjerë si ai. Menny, siç i thërrasin shkurt, edhe ëndrrat i sheh me Dibrën.

KUFIRI SI POSTBLLOK

Siguracioni i makinës për të kaluar kufirin kushton 40 Euro, kështu që është shumë shtrenjtë për një pasdite në Dibër. Vendosa të marr një taksi që më thanë se kushton 300 lekë. Por, miqtë që më dërgojnë mesazhe në Viber dhe kërkojnë të dinë se ku ndodhem, nuk më lënë ta provoj taksinë. Afrimi “për 5 minuta” është në doganë me makinën e tij.

Për të kaluar dy postat kufitare na duhet gati më shumë se 20 minuta. Afrimi më thotë se mbaron më shpejt ditët e tjera të javës, por të shtunën dhe dielën është më shumë trafik.

Për zhvillimin e turizmit në këto anë do të ishte më mirë, sidomos gjatë verës, që kontrolli të bëhej vetëm në një pikë doganore. Kjo do t’i shkurtonte procedurat burokratike dhe do të bënte që turizmi nga Ohri, Mavrova apo Korabi të jenë më të prekshme për të huajt.

MENNY DHE PROJEKTI “DIBRA 4K”

Në Dibër na pret Menny, i cili këtë radhë ka sjellë një dron të versionit të fundit, së bashku me idenë e tij për projektin “Dibra 4K Video”. Menny thotë se ky projekt ka për qëllim prezantimin e natyrës dhe bukurive të Dibrës. Projekti është vazhdim i një pune të nisur në vitin 2006. Që nga ajo kohë ai ka bërë me qindra foto dhe video nga e gjithë Dibra, deri në Lurë, dhe i ka shpërndarë falas në ëeb dhe rrjetet sociale, por edhe përmes DVD-ve te miqtë e tij.

Droni që ka sjellë Menny nga Amerika ngjitet deri në 6000 metra lartësi, qëndron në ajër 23 minuta dhe, pasi të bësh video HD në formatin 4K si dhe foto me rezolucion 12 mp, mund të kthehet vetë në shtëpi.

“Unë do ta lë dronin në Dibër, - thotë Menny, - dhe do ta kenë lejen për ta përdorur të gjithë anëtarët e grupit që duan të bëjnë diçka të mirë për Dibrën”. Në grupin e atyre që bashkëpunojnë me Menny-n prej disa vitesh jam edhe unë me një ndihmë krejt modeste. Ndërsa grupit që është bashkuar rreth projektit të ri përbëhet nga Adhurim Kaja, Bardhyl Marku, Ibrahim Kolari, Mice Cenobafte dhe Afrim Kërkuti, ndihma e të cilëve fillon që nga këshillat, realizimi dhe montimi i videove, por edhe me ndonjë kontribut financiar.

“Ka njerëz që me duan, por ka edhe njerëz që nuk me duan. Unë vazhdoj të punoj për ata që më duan mua, por duan edhe Dibrën”, - thotë Menny.

Ai nuk ka asnjë dilemë për grupin dhe asnjë dyshim se dikush mund ta përdorë për qëllime personale. “Në na bashkojnë idetë dhe dashuria për Dibrën. Kush i do këto parime, është i pranuar në grupin tonë”, - thotë Menny.

Gjatë ditëve që ai qëndron në Dibër, shumë e falënderojnë për ato foto dhe video që përcjell, duke ua afruar Dibrën dhe bukuritë e saj në shtëpinë e tyre, në të katër anët e botës.

PRANË LIQENIT NË “PRITJE TË TURISTËVE”

Në shtëpinë e Menny-t, ndërsa bisedojmë për “projekte”, shpesh futuriste në dukje, vjen Bajram Kllobuçishta, një bashkëmoshatar i Menny-t. Bajrami ka një dyqan të vogël ku shet pajisje satelitore për TV dhe internet. “Unë pres verën për të punuar”, - thotë ai, pasi gjatë verës shumë dibranë që jetojnë jashtë kthehen për pushime në vendlindje, dhe me këtë rast blejnë edhe pajisjet satelitore për familjet e tyre”.

Me makinën e tij shkojmë te restorant “Perla”. Aty takojmë Argëtim Fidën, mjek gjinekolog, ish kryetar i Komunës së Dibrës. Vëllai i tij ka në pronësi kompleksin, ndërtuar bukur e me shije, në harmoni me natyrën.

Në Dibër është muaj Ramazani, kështu që restoranti, ashtu si edhe lokalet dhe kafenetë në të gjithë qytetin, janë pothuajse bosh. Ata që gjenden në lokal, janë kryesisht të ardhur me pushime. Ndërsa në çadrat buzë liqenit shikon njerëz më pak se gishtat e dorës, kryesisht fëmijë.

Me Menny-n dhe Argëtimin biseda shkon që në fillim të Rruga e Arbrit. “A do vijnë turistë nga Tirana kur të bëhet Rruga e Arbrit?”, - pyet Menny.

Argëtimi e sheh me optimizëm këtë. Ndërsa unë provokoj në bisedë, duke thënë se pavarësisht se sa do të vonohet ndërtimi i rrugës, dibranët duhet të përgatiten, të mësojnë, që jo vetëm t’i presin vizitorët një fundjavë apo disa ditë, por edhe t’u shërbejnë atyre në mënyrë të kulturuar.

“Për momentin, - thotë Argëtimi, i cili ka qeverisur për 8 vite Dibrën, - qyteti përballon flukset e pakta të turistëve. Ndërsa në të ardhmen, ai ka besim se nuk do të ndjehet kjo vështirësi, pasi shumë shtëpi në Dibër janë bosh dhe mund të kthehen në vatra të vërteta pritëse. Ndërsa përsa i përket çështjes nëse do të dimë t’i presim turistët, kjo nuk ka asnjë pikë dyshimi për të, se turistët në Dibër do të gjejnë më të mirën e këtyre anëve, së pari natyrën, por edhe shërbimin.

“Dibra e merr veten menjëherë me rikthimin e dibranëve me pushime, pastaj 9 muaj të tjerë kthehet në një gjendje apatike”.

Argëtimi thotë se në Dibër gjatë muajve të verës kthehen së paku më shumë se pesë mijë dibrane që jetojnë në perëndim, kryesisht në Shtetet e Bashkuara.

Dhe kjo ndjehet edhe gjatë një xhiroje në bulevardin e qytetit.

PAVARËSIA E SHBA FESTOHET SI DITË LIRIE

Është 4 korrik dhe motoristët e bashkuar rreth “Illyrian Moto Club - Dibër” do të parakalojnë nëpër qytet me motorët e tyre të zhurmshëm. Shoqëria e tyre nuk është e regjistruar akoma zyrtarisht, por ata janë në detajet e fundit të themelimit zyrtar të klubit. Njëri prej qëllimeve të klubit mendohet të jetë bashkëpunimi i të rinjve që jetojnë në SHBA dhe Dibër.

Veprimtaria është e organizuar në bashkëpunim me “Shoqatën për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit”, drejtuar nga Shuip Marku.

“Njëri nga qëllimet e shoqatës është bashkëpunimi ndërkufitar mes dy Dibrave në Maqedoni dhe Shqipëri, por shfrytëzohen edhe ditë festive si *Dita e Europës, Ditët e Kulturës*

(Vijon në faqen 5)



Motoristët e klubit “Illyrian Moto Club - Dibër” gjatë festimeve të 4 Korrikut. © Foto: B.Karoshi

(Vijon nga faqja 4)

Franceze apo *Festën e Pavarësisë së Amerikës* për të organizuar veprimtari festive".

"Dibra është e lidhur me Shtetet e Bashkuara, - tregon Shuipi, ndërsa po merret edhe me detajet e fundit të veprimtarisë. Të gjithë ata që merren me organizimin janë vullnetarë, që nga fonia e deri të motoristi i fundit pjesëmarrës".

"Kjo veprimtari, - thotë Shuipi, - është një mënyrë për të afruar të rinjtë që jetojnë në Dibër me ata që janë në Amerikë. Jetojnë në dy realitete të ndryshme dhe dy kultura të ndryshme, dhe veprimtari të tilla i afrojnë me njëri-tjetrin, për të kuptuar njëri-tjetrin".

Valentina Marku e nisi veprimtarinë duke kënduar live himnin e SHBA. Valentina ka lindur dhe jetuar në Amerikë, por tashmë të ardhmen e vet po e ndërton në Dibër.

Bena Kërluku, një aktiviste e klubit rinor, mban fjalën e rastit në emër të organizatorëve. Në fjalën e saj vihet në pah gjithë çfarë përfaqëson 4 korriku për SHBA-në, por edhe për shqiptarët.

"Ajo që e bën të kujtohet çdo ditë këtë Deklaratë të Pavarësisë është fakti se aty thuhej se të gjithë kanë lindur të barabartë, të gjithë janë pajisur me të drejtën e patjetërsueshme dhe fuqia e qeverisë buron nga pëlqimi i të qeverisurve. Asnjë progres dhe asnjë sukses nuk mund të arrihet as në ditët e sotme, nëse nuk mbështetet në parimet e lartpërmendura", - lexon Kërluku.

"Festa e Amerikës është edhe festë për shqiptarët, sidomos për dibranët. Forca e vërtetë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk vjen as nga shkalla e pasurisë dhe as nga forca e armëve, por nga fuqia e idealeve, që nënkuptojnë demokracinë, lirinë dhe shpresën për ta pasur Amerikën gjithmonë të papërkulur dhe të suksesshme".

Më pas, mbi 40 motoristë, mbështjellë me flamuj amerikanë dhe shqiptarë, bëjnë xhiro nëpër rrugët e Dibrës. Ndërsa pranë Liqenit, Menny dhe miqtë e tij të projektin "Dibra 4K" realizojnë fotot dhe videot e radhës.

PUNIMET DHE DHURIMET PËR SHËTITOREN VAZHDOJNË

Një xhiro në shëtitoren e re që është duke u restauruar nuk mund të mungojë. Në një foto të Dibrës të bërë me dron nga lart, shëtitorja duket si një vijë e bardhë qumështi. Edhe gjatë ecjes, në shëtitoren ku më shumë dëgjohen trokitjet e çekiçit sesa ecja e njerëzve, ndjehet Amerika.

"Kjo shëtitore, - thotë Afrimi, - po ndërtohet pothuajse e gjitha me kontributet e qytetarëve dibranë që jetojnë në SHBA, por edhe disa bizneseve që operojnë në Dibër".



Një shëtitje në shëtitoren që po ndërtohet
© Foto: B.Karoshi

Afrimi tregon se gjithë kjo punë po bëhet me kontribute vullnetare. Bashkësia Islame e Dibrës ka dhënë një kontribut të madh si dhe dy firmat ndërtuese, "Vizion" dhe "Euro Kualitet".

Për shëtitoren, që u ka dhënë hapësirë dyqaneve përreth, kanë investuar më së shumti dibranët që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Betonin për sheshin thuhet se ka dhuruar Ibrahim Kolari, një biznesmen që jeton mes Dibrës dhe SHBA.

"Xhamia e Dibranëve në Neë Jersey, përmes anëtarëve të saj Baudin Çanka, Refik Kosovrasti, Ramazan Rexha, Arijan Marke, Shpëtim Miftari, Irfan Koxha dhe Emin Lata kanë mbledhur 40 mijë dollarë dhe me këtë shumë kanë paguar punëtorët që janë marrë me punimet në shëtitore", - shkruhet në një status në facebook të kryetarit të Bashkisë, Ruzhdi Lata. Sipas tij, për shëtitoren kanë ndihmuar edhe dibranë të tjerë që jetojnë në SHBA, si Faton Mashkulli, i cili ka kontribuar me një ndihmë prej 10 mijë dollarësh per ndërtimin e shëtitores, Refik Kosovrasti ka marrë përsipër ndriçimin e saj me një financim prej 20 mijë dollarësh, ndërsa Petrit Jani ka kontribuar me 3 mijë dollarë dhe Refik Sela me 1000 dollarë.

BUKURIVE TË NATYRËS

Një ditë më pas, Menny, Afrimi dhe Bardhyli kanë vendosur të na çojnë të shohim Ujëvarën e Duf-it, njëra nga më të bukurat në rajonin e Dibrës. Bashkë me ne bashkohet edhe Pranvera dhe Rona. Ndërsa Alba, vajza 10 vjeçare e Menny-t, kënaqet sa në njërën anë të rrjedhës në anën tjetër, ngjitet në majë shkëmbi për një fotografi, madje kërkon edhe vende të rrezikshme, vetëm e vetëm që kur të kthehet në Neë Jersey, t'i çudisë me fotografi shokët dhe shoqet e saj të shkollës.

Ujëvara e Duf-it është rreth 40 minuta në këmbë nga fshati Rostush. Fshati është një destinacion turistik gjatë verës, për shkak se shërben si një udhëkryq për turistët.

Rruga për te ujëvara futet në një grykë të ngushtë dhe zëri i ujit që përplaset gjatë rrjedhës dhe fëshfërima e pemëve që luhaten lehtë, të krijojnë përshtypjen se je njësh me natyrën. Rruga është përshtatur për këmbësorët, duke vendosur parmakë anësorë kapur për pemësh. Pranë ujëvarës disa stola dhe vendqëndrime janë ndërtuar buzë ujit që rrjedh furishëm dhe bashkohet poshtë me lumin e Radikës.

Gjatë muajit korrik, ujëvarën e Duf-it e vizitoi edhe ambasadori amerikan në Shkup dhe bashkëshortja e tij."Të rifreskuar nga uji i ftohtë dhe ajri i pastër i ujvarës së Duf-it", - shkruan ambasadori në një fotografi të tij të publikuar në facebook, me sfond ujëvarën.

Vende-vende, pak plehra të lënë nga ndonjë turist i rastësishëm e prishin peizazhin magjepsës të natyrës. Dhe kjo i ka bërë përshtypje edhe ambasadorit amerikan në Shkup.

"Plehrat mund ta prishin një vend të bukur, por pas disa minutash pastrim, gjithçka duket mirë përsëri", - shkruan ambasadori amerikan Jess Baily në njërën nga fotot, duke dhënë një shembull që nuk thuhet dot me fjalë.

Hemler Rashiti, - guida jonë turistike, - një djalë i ri nga Rostusha, thotë se në këtë rajon ka shumë vende që i preferojnë turistët. Shumica e tyre vijnë nga Anglia, por vijnë edhe nga vende të tjera si Polonia, Çekia, etj. Në këtë rajon, përveç liqeneve të Mavrovës, njerëzit mund të shfrytëzojnë edhe bukuritë natyrore të Lumit të Radikës, liqenit akullnajor të Llukovës apo ecjet në malet e Korabit, Bistrës, Kërçinit dhe Deshatit, apo mund të eksplorojnë edhe shpellat në grykën e Sharrit dhe Kalinës etj.



"Fluturimi i Albës"
© Foto: B.Karoshi

Në këto anë është edhe ujëvara e Korabit, që vendasit i thonë "Prroi i fell". Ajo konsiderohet si ujëvara më e madhe në Maqedoni dhe lartësia e saj llogaritet në 100-138 metra, sipas sasisë së rënies së ujit. Nivelet më të larta të ujit në këtë ujëvarë janë në fund të majit dhe fillim të qershorit, kur është edhe koha më e mirë për ta vizituar. Në qoftë se vera mban e thatë, në gusht dhe shtator ajo mund të mos ketë ujë.

MJEDISI NË RREZIK

Çështjet e mjedisit, kryesisht ujit që buron nga këto male, janë një temë e ndezur dhe për të cilat Bardhyl Marku nuk përton të flasë. Ai ka ndjekur që në fillim çështjen e devijimit të ujërave të Radikës dhe ka marrë pjesë vazhdimisht në udhëheqjën e shoqërisë civile për t'i penguar këto projekte të ELEM-it, shoqërisë energjetike maqedonase.

"Këtu nuk është fjala për disa metra kub ujë, - thotë Bardhyli. - Këtu bëhet fjalë për ruajtjen e biodiversitetit, ruajtjes së natyrës së këtij rajoni. Devijimi i këtyre ujërave mund të sjellë pasoja katastrofike, në radhë të parë për Dibrën, por edhe për gjithë Maqedoninë".

Angazhimi i tij personal ka bërë të mundur që kundër këtyre projekteve, sidomos hidrocentralit të Llukovës dhe Urës së Boshkut, të bashkohen më shumë se 40 shoqata mjedisore në Maqedoni, që kërkojnë ndalimin e financimit të këtyre objekteve.

Përpjekjeve të tyre u është shtuar edhe *RiverWatch* dhe *Euronatur*, si dhe disa organizata dhe shoqëri europiane që janë kundër prishjes të asaj që quhet si "zemra e kaltër e Europës", një rrjet lumenjsh natyrorë në Ballkanin Perëndimor.

Një delegacion i Konventës së Bernës, në kuadër të misionit të tyre në Maqedoni për grumbullim të fakteve lidhur me hidrocentralet në fushë të Lukovës dhe Ura e Boshkut, ka mbajtur edhe një takim në Dibër më 25 qershor.


"Unë nuk munda t'i takoj, - thotë Bardhyli, - por sipas informatave, ndërsa për hidrocentralin e Fushës së Lukovës ka pasur kundërshtim absolut, për atë të Urës së Boshkut nuk ka pasur edhe aq kundërshti".

Bardhyli tregon se parimi i hidrocentralit të Urës së Boshkut është me vërshime, që do të thotë se në disa orë në ditë do të ketë vërshime ujërash me rrëmbim, ndërsa më pas nuk do të ketë ujë fare. Kjo do të sjellë një dëm të pariparueshëm për biodiversitetin e rajonit, duke filluar nga Dibra.

Një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim nga Këshilli Komunal i Dibrës më shumë se një vit më parë nuk ka qenë funksional. Komisioni kishte për synim mbledhjen e fakteve dhe provave për t'i kundërshtuar këto dy projekte, por deri më tani nuk e ka kryer qoftë edhe një mbledhje, së paku edhe formalisht.

* * *

Në Dibër ndjen se edhe ëndrrat shihen me rrugën e Arbrit, Radikën dhe Amerikë. Është muaji i Ramazanit dhe qyteti gjallërohet në mbrëmje deri pas mesnate. Në baret e qytetit njerëzit takohen me njëri-tjetrin, çmallen dhe bisedojnë. Temat e ditës në Dibër: mbrojtja e Radikës, ndërtimi i Rrugës së Arbrit, zhvillimi i turizmit, ndërtimi i shëtitores etj., mund t'i hasësh sapo ulesh në çdo tavolinë. Por aty shesh edhe shpresën për të ardhmen e këtyre çështjeve, zgjidhja e të cilave, sipas dibranëve që takova, është në Tiranë.



Ujëvara e Duf-it.
© Foto: B.Karoshi



Menny, Pranvera dhe Rona

Rruga e Arbërit nr. 111

speciale

"Peshkopia Backpacker Hostel", një mënyrë e re për të shijuar bukuritë turistike të Dibrës

"Peshkopia Backpacker Hostel" është një frymë e re e pritjes së udhëtarëve dhe vizitorëve, duke garantuar çmime të arsyeshme dhe cilësi në shërbime, përmes një atmosfere magjepsëse, krejt ndryshe nga çfarë ofrojnë hotelet e zakonshme.

Ajo është themeluar nga Ilir Hysa, një nga pionierët e rrjeteve *"Backpacker Hostel"* në Shqipëri dhe Edi Truka, një djalë i ri i diplomuar në Itali për projektet urbane të territorit dhe mjedisit.

Udhëtarët që qëndrojnë në hostele janë tipe të veçantë klientësh. Atyre u mjafton një *"Backpacker"* që në shqip mund të përkthehet si *"çantë shpine"*, dhe me të bredhin botën. Fjala mund ta ketë origjinën nga filmat vizatimore me Tomin dhe Xherrin. Tomi fuste të gjitha gjërat në një çarçaf dhe me anë të një shkopi i mbante gjithë kohës së udhëtimit mbi supe. Nisur nga kjo, të gjithë udhëtarët që mbajnë një çantë gjigante mbi supe, janë *backpackera*, që tashmë është kthyer në një simbol i udhëtarëve që pëlqejnë hostelet.

Gjithashtu, këto udhëtarë shpenzojnë sa me pak buxhet në çdo lëvizje, duke përdorur shërbimet e transportit publik si dhe duke mos ngurruar në ngritjen e dorës për "autostop", me shpresën se dikush do t'i marrë me makinë.

Karakteristikë tjetër e këtyre udhëtarëve është se pëlqejnë të shikojnë me përpikmëri çdo gjë ku ata shkojnë, që nga monumentet kulturore dhe tradicionale, të dëshira për të njohur mënyrën e jetesës së vendit. Kanë qejf festat tradicionale, të njihen me natyrën, të krijojnë miqësi, shkëmbejnë eksperienca dhe bashkëbisedime për çështje të ndryshme kulturore, ndoshta edhe duke dhënë mendime dhe ide në përmirësimin e shërbimeve dhe ofertave që duhen ndërmarrë për rritjen e turizmit.

"Backpacker-at" e adhurojnë natyrën dhe janë të rreptë në mbrojtjen e saj dhe pikërisht kjo është ideja e "Peshkopia Backpacker Hostel", - thotë Edi Truka, menaxher i saj, - të krijojmë dhe zhvillojmë një ekoturizëm të qëndrueshëm që t'u shërbejë më të mirën e mundshme vizitorëve që shfaqin kureshtje për rajonin e Dibrës".

Për më shumë ndiq faqen në Facebook
https://www.facebook.com/Peshkopiahostel?fref=ts
ose telefononi në numrin 069 92 99 369



© Foto: PBH

Turizmi në Dibër, një mundësi e pashfrytëzuar

(Vijon nga faqja 3)

mundëson shërbim me anë të guidave. PBH është i pari që në bashkëpunimi me "Outdoor Albania Association" po trajnojnë guidat turistike lokale.

"Mund të themi se jemi të kënaqur për punën që po bëjmë, edhe pse ka mungesa në burime njerëzore, sepse si kusht kryesor për të qenë një guidë e mirëfilltë është një anglishte e folur dhe e shkruar në mënyrë perfekte", - thotë Edi Truka.

"Ka shumë për të thënë se çfarë mungon dhe çfarë nuk shkon, - thotë Truka. Por e rëndësishmja është që të përveshim mëngët dhe të punojmë për të ngritur disa struktura që të perfeksionohen shërbimet, për të pritur në një të ardhme të afërt shumë e më shumë turistë".

"Po kalove në Dibër njëherë, nuk të rrihet pa ardhur prapë brenda një kohe të shkurtër, dhe kjo është provuar nga shumë vizitorë që kanë ardhur në këtu për herë të parë dhe jemi ritakuar brenda një afati të shkurtër kohe", - thekson Truka.



Ndërtimet, si në rastin "mashnave me blloqe betoni" në bjeshkët e Ilnicës, janë një shëmti e madhe vendosur mes bjeshkëve. Foto: © E.Hasani

ÇFARË DUHET TË NDRYSHOJË?

Duhen politika rajonale të përbashkëta për ta rritur ofertën turistike në Dibër. Gjithashtu, është emergjente vendosja si prioritet për njësitë e qeverisjes vendore zhvillimin i turizmit si degë e rëndësishme e ekonomisë lokale.

"Identifikimi i familjeve që do të merren me zhvillimin e turizmit, mbështetja e tyre me trajnime dhe politika fiskale lokale, asistencë për familjet me ekspertë të fushës për mënyrën e arredimit, kulinarisë, si dhe higjienës, mbështetje me kredi pa interes për ndërtimin e shtëpive pritëse me kushtet e nevojshme, të paktën për 5 vjet, si dhe zgjidhjen e çështjes së pronësisë mbi pyje, kullota, lumenj, liqene, ku pronarët të kenë të drejtë të bëjnë kontrata qiraje apo dhe shitje të pronave për destinacion turizmin, janë disa nga masat urgjente që duhen marrë në këtë fushë", - thotë Hamit Salkurti.

"Një bashkëpunim i mirëfilltë i të gjithë strukturave pritëse do të ishte hapi i parë për rritjen e ofertave turistike, - thotë Edi Truka. Promovimi i zonave, fshatrave dhe eventeve të ndryshme të rrethit Dibër, përshkrimin dhe prodhimin e guidave turistike të mirëfillta, për zonën, tabela me informacione në vendet kyçe dhe bashkëpunim me dibranët në mirëmbajtjen e tyre, informacion kulturor dhe të detajuar për shoqërinë dibrane se çfarë fitimesh mund të sjellë për çdo familje zhvillimi i turizmit".

Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar edhe ndërtimeve të reja në zonat turistike. Ato duhet të jenë në harmoni me natyrën dhe larg betonizimit. Ndërtimet, si në rastin "mashnave me blloqe betoni" në bjeshkët e Ilnicës, janë një shëmti e madhe vendosur mes bjeshkëve. Njësitë e reja vendore tashmë i kanë të gjitha mundësitë që t'i ndalojnë këto ndërtime, që jo vetëm nuk thithin grupe turistike, por e shkatërrojnë të ardhmen turistike në rajon.

DIBRA, NJË DESTINACION TURISTIK NË RRITJE

"Pritshmëria që ne kemi, njëkohësisht duke punuar në përgatitjen e strukturave për të ardhmen e këtij sektori, do të jetë shumë pozitive", - thotë Edi Truka kur flet për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

Por që Dibra të rrisë të ardhurat nga turizmi duhet që njerëzit që banojnë në zonat pritëse, të kuptojnë më mirë rreth shërbimeve turistike për ta zhvilluar atë, por pa e përjashtuar qeverisjen vendore nga kjo sfidë, e cila duhet të fitohet vetëm me bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, veçanërisht tani me mënyrën e organizimit të qeverisjes vendore, ku e gjithë Dibra është një njësi, duhet ta marrë më seriozisht këtë sektor në politikat e saj zhvilluese të zonës.

Hamit Salkurti, edhe për shkak të një përvoje të gjatë në këtë fushë, thotë se "në Dibër nuk ka pasur asnjëherë vëmendje për ta zhvilluar seriozisht turizmin dhe veçanërisht atë malor, që është dhe një turizëm gjithë vjetor. Nga qeveritë qendrore dhe ato lokale apo dhe të shoqërisë civile askush nuk ka menduar për të ngritur dhe kapacitetet e këtyre njerëzve që përpiqen për të bërë pak në këtë rrugë të vështirë atëherë. Kjo le për të dëshiruar se edhe të ardhurat janë aq minimale, saqë nuk ka pasur motivim për ta zhvilluar sektorin dhe kapacitetet si guidat krahasuar këtë me vendet e ngjashme si Dibra, që janë Thethi, Kelmendi, Shkreli, Valbona, Dardha dhe Voskopoja në Korçë, lugina e Përmetit, Mali i Tomorit, etj."

"Të gjitha qeveritë e mëparshme, edhe e tanishmja apo donatorët si GTZ apo dhe të tjera organizata, kanë qenë më dashamirëse në promovimin dhe investimin direkt të përmirësimit të kushteve për pritjen e turistëve në këto zona.

Gjithashtu dhe në ngritjen e kapaciteteve për guidat turistik apo dhe shërbimeve të informimit apo reklamimit promovimit të këtyre zonave në televizionet kombëtare dhe promovimin nëpër panairet e turizmit të organizuara në Evropë pa përmendur turizmin detar që është sezonal. Pra, duke parë këtë, nuk kemi asnjë pikë krahasimi të ndonjë guide në Dibër, që me sakrifica mundohet të mësojë një fjalë këtu dhe një atje, duke gërmuar nëpër libra të ndryshëm që të mundohet edhe ai të bëjë gjoja turizëm me guidat e zonave të tjera që për çdo vit mund të marrin disa trajnime specializuese në këtë fushë".

"Deri më tani Dibra ka shfrytëzuar vetëm 1 për qind të burimeve të saj turistike, kështu që mundësitë për zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen janë shumë të mëdha", - thotë Hamit Salkurti.

B.KAROSHI

7 pyetje rreth turizmit në Dibër

1. PSE DUHET TË VIZITOJ QARKUN E DIBRËS?

Me një fjalë, diversitet. Ju do të gjeni pamje që të lëne pa frymë, traditat e bukura, kuzhinë të larmishme dhe histori magjepsëse, mundësi për aktivitete sportive dhe të kohës së lirë. Përveç këtyre ekzistojnë muzetë interesante dhe të pazakontë, pazare në fshatra të ndryshme, kështjella mesjetare, ski, udhëtime sfiduese me biçikletë dhe qytete historike. Lista është e pafund dhe nëse nuk e besoni, shkoni dhe shikojini me sytë tuaj!

2. A DUHET TË UDHËTOJ VETËM APO ME GRUP?

Kjo varet nga disa gjëra. Sa rehat ndiheni ju kur udhëtoni vetëm me familjen/shokët apo preferoni të udhëtoni me njerëz të tjerë? Ju do të gjeni guida të mjaftueshme turistike për të vizituar vendet e preferuara në mënyrat e përmendura më sipër.

3. SI ËSHTË MOTI?

Moti mund të variojë në male dhe ju duhet të visheni me kujdes. Në përgjithësi vera është e nxehtë dhe e thatë ndërsa dimri është i ftohtë, me borë dhe i lagësht. Atje do të gjeni vende të përsosura për rrëshqitje me ski në dimër dhe kamping malor në verë.

4. A FLITET ANGLISHT?

Njerëzit e përfshirë në turizëm flasin Anglisht dhe Italisht. Ata mund t'ju ndihmojnë të gjeni informacionet e nevojshme për udhëtimin tuaj.

5. SI JANË HOTELET?

Hotelet që sugjerojmë janë hotele me 2, 3 dhe 4 yje. Shumica e tyre drejtohen nga familjare dhe dekorimi i tyre është tradicional me karakteristika të zonës, duke kombinuar modernen me tradicionalen.

6. CILAT JANË VENDET MË TË BUKURA?

Ne ju këshillojmë të vizitoni qytetet kryesore: Peshkopi, Burrel, Bulqizë. Gjithashtu, spikasin fshatrat turistike si: Lura, Macukulli, Kalaja e Dodës, Xibri, Begjunec, Bellova, Darsi, Qyteti i Skënderbeut, Ura e Vashës dhe një sërë banesash e kullash historike apo kisha e xhamia të ndryshme.

7. SI MUND TË SHKOHET ATJE?

Kështillohet që udhëtimet të zhvillohen me makina relativisht të fuqishme, për shkak të terrenit të fortë malore. Qytetet kryesore aksesohen lehtësisht me mjete të shpejta. Udhëtimet e mëtejshme mund të zhvillohen në këmbë, duke shijuar bukurinë e këtyre zonave.

(Marrë nga www.diber.gis-dev.com.
Në këtë faqe mund të gjeni edhe të dhëna të tjera mbi vendet turistike në Dibër.)

turizëm

Lumi Drin, një destinacion pushimi



Nga **MIRAN TAFA**

Në Dibër, megjithë vështirësitë infrastrukturore dhe mungesën e investimeve, turizmi po i ndihmon ekonomisë familjare. Në planin e ofruesve të shërbimeve, zhvillimi i turizmit është një mundësi e mirë për rritjen e mirëqenies së familjeve të tyre. Ndërsa në planin e konsumatorëve familjarë mundësitë që ofron lumi Drin janë mëse të mira për të kaluar pak ditë të qeta.

Ky lumë tradicionalisht është frekuentuar gjatë stinës së nxehtë të verës, por vetëm nga grupmoshat e reja dhe kryesisht meshkujt. Gjatë viteve të fundit janë vënë re ndryshime të ndjeshme në strukturën moshore dhe gjinore të pushuesve, por edhe numri i pushuesve është rritur ndjeshëm. Kjo gjë bëri që të rritej interesi për investime përgjatë brigjeve të lumit.

Banorë të fshatrave kanë ndërtuar lokale modeste, të cilët ofrojnë shërbime mjaft të mira, me çmime të arsyeshme dhe mbi të gjitha tradicionale vendase. Një ndër to është edhe Aqif Mikli nga fshati Muhur. Ai ka ndërtuar një shtëpi pritjeje në vitin 2001.

"Në fillim ndërtova një barakë të vogël, hapëm rrugën, për të hyrë automjetet. Babai, që në vitin 1991, mbolli disa rrënjë plepa, të cilat sot janë rritur dhe bëjnë hije shumë të mirë për ato që duan të drekojnë", shprehet Aqifi.

Ai i kategorizon pushuesit në lloje të ndryshme. Vendasit i frekuentojnë pak lokalet. Qytetarët shpesh herë i marrin ushqimet të përgatitura në shtëpi, vetëm pijet i marrin në lokal.

"Ka edhe nga ato të cilët preferojnë ushqimin që ofrojmë ne"- thotë ai.

"Unë punoj thuajse vetëm me familjarët, në këtë lokal ofrojmë vetëm ushqime të përgatitura vetë"-thekson Aqifi. I pyetur se si ka ndryshuar numri i pushuesve nga viti në vit ai shprehet se Drini është kthyer tashmë në një destinacion turistik, por njerëzit shpenzojnë pak. Megjithatë për pushuesit mbetet një opsion i leverdisshëm.

Pse duhet të vijnë këtu në Drin pushuesit?

Aqifi thotë se "e para e punës, ne si komunitet jemi mikpritës. E dyta, Muhurri është fshati i parë në Dibër që ka ofruar shërbime për pushuesit dhe për këtë arsye i njeh mirë shijet dhe preferencat e tyre".

Pronarët e lokaleve kanë investuar që të krijojnë kushte të mira për sidomos me ambientet relaksuese. Diell, hijë, kuzhinë, qetësi, shërbime, të gjitha këto i gjen në në lumin Drin. Nëse klienti e kërkon diçka, nuk e kthejmë duarbosh, p.sh. "petulla malsaje me mjaltë" kërkohen shpesh dhe ne i ofrojmë". Ky është një gatim tipik i zonës që ka shumë famë dhe preferohet, është specialiteti ynë.

"Bukën e misrit, të cilën e gatuajmë në kushte tradicionale duke filluar me bluarjen në mulli me ujë e deri tek pjekja në saç" – thotë Aqifi. Ai thotë se shumë vijnë edhe për kurim, në zall të Drinit me rekomandim të mjekut. Në darkë vijnë me familje për të soditur lumin, i cili është relaksues.



Edhe emigrantët vijnë për të kaluar pushimet me familjarët. I pyetur se çfarë shërben ky lokal për klientët, ai përgjigjet se shërben gatime të vendit, të gjitha bio: si sallata, patate, mish në prush, pula në prush, pula vendi me qull ose jufka, bukë misri, spece në gjizë, petulla malsaje me mjaltë etj. Këto janë gatimet më të preferuara të klientëve.

"Ajo që i bën pushuesit të jenë të kënaqur nga shërbimet, përveç cilësisë së mirë janë edhe çmimet e ulëta, ato që kanë në plan vijnë dhe shijojnë dreka e darka pranë lumit me pak para" shprehet ai. Për të ilustruar këtë gjë Aqifi përmend një rast kur në lokalin e tij erdhën disa pushues nga Përmeti, të cilëve përveç të tjerave ju përgatita gjizë, speca djegës, djath, spece në prush etj., të gjitha të bëra vetë. Kur paguan, mbetën të çuditur sepse me atë faturë që këtu hëngrën një familje, në ndonjë vend tjetër nuk mund të hajë vetëm një person. U detyrova thotë ai të sqaroja se çdo gjë e bëj vetë në kopshtin tim, pra nuk blej asgjë në treg, prandaj kam mundësi ti ofroj me çmime të lira. Edhe pulat e peshkun i kam të miat. Unë blej vetëm pijet freskuese. Mundohemi që edhe ne të fitojmë diçka edhe njerëzit të dalin të kënaqur. Një disavantazh është rruga e cila nuk është në gjendje të mirë".

Poshtë Urës së Muhurrit është edhe kompleksi turistik "Drini", i cili ofron kushte për pushime, kryesisht për të rinj. Gjatë verës, mbrëmjeve organizohen koncerte.

Përveç fshatit Muhurr, pushuesit preferojnë edhe vende të tjera. Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur edhe fshatin Luzni, ku kanë filluar të ndërtohen disa lokale, të cilat mundohen të ofrojnë shërbime primare për pushuesit. Ajo ç'ka ofron më shumë ky fshat është rruga e mirë. Podgorca gjithashtu, është një vend shumë i frekuentuar. Në Fushë Alie tek Ura e Lushës lumi gjallërohet nga zërat e pushuesve vendas, kryesisht të rinj dhe fëmijë. Vlen të theksojmë se përveç këtyre fshatrave që frekuentohen nga të dyja gjinitë dhe të gjitha grupmoshat në pamundësi për të shkuar në bregdet.

"Ajo që i tërheq më së shumti pushuesit janë pamjet mbresëlënëse dhe uji shumë i pastër gjë që s'mund të ofrohen kudo", thotë një pushues. Ndërsa një tjetër thotë, "jemi të kënaqur që me kaq pak shpenzime arrijmë të kënaqim familjet tona. Dikur ishte problem peshkimi me dinamit dhe me gjenerator. Kjo dëmtonte faunën dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe kryesisht të fëmijëve. Sot kjo gjë nuk ndodh më si pasojë masave të marra nga policia. Për këtë shkak, numri i pushuesve është gjithmonë në rritje nga viti në vit.



Cekat në Fushë-Alie



Luzni, Foto: © E.Hasani

Rruga e Arbërit nr. 111

reportazh

‘K’tu na ke vjet për vjet…’



Nga **JAHE DELIA (SELMANI)**

Ishte viti 2010 dhe dëshirës së një grupi intelektualësh e banorësh të Radomirës që jetonin në Tiranë, ku mori udhë festa e Radomirës. Ashtu si dhe vitet e kaluara, edhe këtë vit, djemtë dhe burrat e Radomirës u mblodhën së bashku në vendlindje, rreth sofrës së madhe, me këngë e me valle.

U KËNDOFTË SHPIRTI E ZEMRA!

Ky urim do t’i shoqëronte të ftuarit e posaçëm, që i dhanë shpirt aktivitetit të datës 19 korrik, që ishte dhe dita e tretë e Bajramit të Madh. Dhe sa me zemër e uroi këtë ditë të madhe regjisori Fran Vukaj.

-Jemi vëllezër, gëzimet i ndajmë bashkë,- thotë Frani i ngazëlluar. Ai mënjanë dhe disa punë të tijat e iu bashkua grupit ku ishte këngëtari i përmendur i trevës së Gjakovës e Hasit, Musa Dauti, bilbili i këngës dibrane, Sherif Dervishi dhe, ëmbëlsira për fund, kanarina e këngës popullore jo vetëm dibrane, Saihe Poleshi (Saje, siç jemi mësuar ta thërrasim). Me Franin si regjisor u ndërtua një skenar që do t’i përshtatej aktivitetit, që do t’u shkonte për shtat e shije këtyre banorëve e këtyre maleve.

Këngëtari i Radomirës, tashmë i përmendur do të ishte jo vetëm këngëtar në duetet me Sajen e Masain me të cilin bashkëpunon vazhdimish, por dhe një shoqërues i denjë e ciceron bashkë me vëllain, Hajredinin, dhe ky një këngëtar me përvojë e organizator.

18 korriku na mblodhi në Paskuqan, ku Lavdrimi, Nurishi, Hajredini etj. debatojnë se duan të jenë të parët për të qerasur miqtë dhe të tjerët. Dhe këto lloj debatesh nuk kemi mundur t’i shmangim edhe në takimet e shpeshta të punës ku Ramazani, Bashkimi, Hasani,etj. nuk të lënë të paguash, aqsa, shpesh duhet ta ujdisësh me kamarierin tinëzisht për t’u ndjerë dhe ti pjesë e tavolinës. Një bujari e lindur, një sinqeritet mes shokësh.

Në makinën që e nget Florani është dhe Saja që, kur kujton ato kohë kur shkonte në shkollën mjekësore në Vlorë e i duheshin tri ditë udhë, gati sa nuk përlotet. Edhe kur merrte udhën për në Tropojë ku krijoi familjen, kështu ishin vuajtjet. Këto kujtime ia ngacmon ajo udhë që sot i shkurtoi distancat nga ditë në orë. Një pushim te Kastrati është i merituar, por Saja ngul këmbë e vendos kundër nesh duke na dhënë kafen me gjithë zemër.

-Ta pimë një kafe të qetësohemi, se ky Florani e ngiste makinë si aeroplanin e tij,- bën shaka Saja.

Dini merr në telefon klubin e Vasije nga na përgjigjet i qeshur Bilbil Lamallari duke na premtuar një “Sofër për miq”. Eliminuam qëndrimin në Kukës dhe brenda orës, në Vasije. U ulëm në tarracën e sipërmë ku vapa ia kishte lënë vendin freskisë, se këtu fryn Corokoli. Nga një cigare nga pronari të cilës vetëm Saja i del për zot dhe freskohemi për t’u ulur në drekë. Ajo ishte bio dhe plot shije, freskia, shakaja e fotografitë na shoqërojnë.

-Nuk kaloni pa e pirë një kafe nga unë, thotë Ahmet Daku! E pamë se ishte i kotë kundërshtimi, ulemi dhe gati me lot në sy kujton ato ditë e net të vështira para 10 viteve kur vëllai i tij, Mustafa, pritej të vdiste e Saja, që shërbente aty, u jepte çelësin e dhomës edhe kur nuk ishte me shërbim. Ajo nuk e kujton, se nuk ishte i vetmi rast humanizmi nga kjo dibrane zemërmirë e zëmirë.

Udha deri në të dalë të Cerenit të kënaq, por kthesa për Radomirë të zhgënjen, fillojnë gropat e pluhuri, maqinat shfryjnë bashkë me të zotët, por ia dalim. Pak pushim te klubi i Sutki Ahmatit e Haxhi Himës dhe freskim në dhomat e hotelit ku u sistemuan miqtë, që kurrsesi nuk pranojnë të quhen të tillë. E ndiejnë veten vendas, të gjithë i njohin, të gjithë i ftojnë për kafe e shakatë e kujtimet janë prezente në çdo vend. Ulemi dhe në livadhet plot gjelbërim e aty nuk mungojnë Sulë Ahmati e Hysen Tabulli që e sjellin djathin e freskët e pa rracion. Frani e zotëron tavolinën dhe padurimit të radomirasve e të ftuarve i jep fund duke i ftuar këngëtarët “për ta ndezur” vendin. Buçet klubi i Haxhiut e Sutkiut.

-U knoftë zemra, bre!- urojnë fëmijë, të rinj e të moshuar. Por Qemal Kupa pret te shpia siç e ka pasur dhe e ka zakon. Është pak i pamundur nga shëndeti, por ruan atë gjallëri që sfidon moshën. Hajredini e Arifi kanë motrën te Qemali për djalin e tij, por Qemali i detyron për t’i marrë me vete miqtë. Dhe nuk i vjen hiç mirë që kanë zënë hotel. Qingji i shoqëruar me të gjitha të mirat zbukuron atë sofër bujare. Minja, e shoqja, shërben si me qenë e re. Do që miqtë të kënaqen e ta ndiejnë veten si në shtëpinë e tyre.

DITË E PAHARRUAR

Në njoftimet e vënë nëpër lokalet e radomirasve në Tiranë e Radomirë ishte vënë dhe orari i nisjer nga Tejsi te Liqeni i Zi, por padurimi i shumë të rinjve e thyen orarin. Ata nisen më herët, i gjejmë atje duke luajtur futboll e dikush shijonte lulesh-trydhe që ishin me aq bollëk e të linin erën e një parfumi të rrallë në gojë.

Liqeni i Zi, një panoramë e rrallë, një mrekulli natyre, por pak i tërhequr ngaqë i ka rënë niveli, se dikush ujit tokat me të. Por përsëri të fton më përzemërsi. Një zjarr i ndezur që mbrëmë akoma nxjerr tym. Nurishi, Lavdrimi e shumë të tjerë të fisit Ahmati edhe këtë vit kanë ardhur të organizuar. Çadrat i kanë me vete, qingjat e Korabit i pjekin e shijojnë nën tingujt e këngës e valles duke prishur qetësinë e pyllit madhështor. Nuk mungon dhe Ali Lita, daja i Nurishit i ardhur para ca javësh nga Belgjika, arratisur pas Çlirimit nga përndjekjet e shtetit komunist. Sa shumë e shijon këtë bukuri e këtë panoramë bashkë me nipa e stërnipa, bashkë me shumë të tjerë nga ky fis i madh.

Në një lëndinë ziejnë kazanat, ndihet që larg aroma e mishit të Korabit, e neve që konsumojmë lloj-lloj mishi në Tiranë, na ngacmon më shpejt.Të habit gjelbërimi në këto ditë korriku. Askund gjatë rrugës nuk e pamë, ai filloi të na shfaqet si surprizë vetëm kur dolëm në Kodër të Kalasë në Ploshtan, pët t’u bërë i plotë në Radomirë. Duket si ditë maji a qershori, askund një fije bari e djegur, gjallëri tjetër na del para syve. Një shkak për përmirësuar më tej gjendjen shpirtërore. Kur i shikon gjithë ata të rinj e të reja, fëmijë e të moshuar duke u përshëndetur e biseduar si vëllezër, ngazëllehesh dhe zemra të thotë që duhet bërë edhe më shumë për vendlindjen. Është një sebep më shumë për të njohur njëri-tjetrin. Shkëmbejnë dhe adresat djem që kanë lindur e janë rritur brenda e jashtë vendit e nuk janë njohur deri tani. Vëllezërit e kushërinjtë Ahmati-Blerimi, Gjurani, Jonuzi e Afrimi sapo kanë ardhur nga Anglia dhe menjëherë janë nisur lart, por kanë marrë dhe fëmijët, tani të rritur e aq të dashuruar me vendlindjen e baballarëve, edhe ata të ikur në moshë shumë të vogël. Është një detyrim për vendlindjen, për Radomirën që nuk duhet braktisur e po jep shënja ringjalljeje. Këta djem nuk mjaftohen me donacione në dorë, premtojnë të nxjerrin ujët në këtë pyll që të lë pa mend.

Arben Mena e ka përgatitur mirë qendrën e zërit, Hajredini i fton pjesëmarrësit të afrohen e një lëndinë më hijet e pishave mbushet plot. Porosia e parë ishte që asnjë mbeturinë të mos hidhet, por të futet në qese për t’u mbartur në vendgrumbullimin e fshatit. Para fillimit të aktivitetit u përkujtuan dhe ata që në harkun e një viti nuk janë ndër ne e mes të cilëve edhe të rinjtë Shefki Gjorgji, Haxhi Daku, Bujar Daku e Xhetan Hoxha që ndërroi jetë vetëm 4 ditë para aktivitetit që e pristë me aq gëzim e nuk mungonte asnjëherë.

Mikrofoni bie “në dorë të ustait”,. Frani, që me zërin që të kujton gjëmimin e Veleshicës në pranverë të përzier me qartësinë e ngjyrave të ylberit që rrezaton në Korab, hyn menjëherë në zemrat e njerëzve. Të gjithë janë në pritje, Frani sikur i lexon në sy dëshirat e tyre, dhe ai nuk vonon t’u shprehë mirënjohjen e malësorit të Pukës për pritjen. Më shumë i flet zemra, i duket se është në pyjet madhështore të Pukës, sikur është në Dardhën e bukur mes malesh. Ndërsa në sfond shoqëron fjalën e tij kënga tash e njohur “Radomirë-Radomirë” e dy djemve të Radomirës, Munir Hoxha e Arif Madana, të pranishmit dëgjojnë strofa pikante për Korabin, Kalanë e Dodës e Radomirën, që këtë ditë, nën interpretimin e Franit kishin një tingëllim tjetër.

Atmosfera sa vjen e ndizet, këngët vijnë si buqetë e ardhur nga larg për të përkujtuar ditën e shënuar të këtij 5-vjetori. Një reklamë e bukur e fiksuar mes dy pishave e shoqëron tërë aktivitetin. Një skenë që do të kishte zili dhe më i miri skenarist. Saja me atë zë që nuk njeh plakje fare, Sherifi të cilit kënga i del nga thellësia e zemrës, Musai që sjell qartësinë e tingullit të Gjakovës e Hasit, Arifit që, qoftë vetëm, qoftë në duet me Sajen dhe Musain sjell tingujt karakteristikë të Korabit, e ndezin më shumë atmosferën, por publiku nuk ngopet dhe kërkon më shumë. Dhe këngët e potpuritë vijnë njëra pas tjetrës. Ato i ndërpret një valle që formon një hark të madh me të gjitha moshat e që e përçon entusiazmin deri në majën e Korabit.

Veterani Fehmi Ahmati, dhe pse i afrohet shekullit, është plot shëndet mendor e fizik. Ai, përmes urimit porosit ta duam vendlindjen, Korabin, Atdheun. Kështu dhe biznesmeni Hakik Daku, që flet për nevojën e gjallërimit të Shoqatës, për dashurinë mes njërëzve e që nuk harron të premtojë donacione siç ka vepruar dhe herë të tjera bashkë me vëllezër.

Të bën përshtypje numri i pjesëmarrësve dhe nga krahina e zona të tjera, se gëzimet bëhen më të plota kur bëhemi bashkë. Latifi me Denin kanë ardhur nga Tirana. Luli, dhe pse pas disa orësh do të udhëtojë për në Mançester, është bërë pjesë e festës me gjithë të afërmit dhe shumë të tjerë. Të bie në sy një grup jo i vogël me të cilët shoqërohet Shefit Gjoniku, janë miq të tij që e kanë lënë të festojnë me ne. Janë dhe turistë që kanë ardhur para disa ditësh dhe sot janë mes nesh. Janë kombësi të ndryshme.

Një djalë plot shëndet e energji të mbush me krenari kur thotë që ka ardhur me disa nga nxënësit e tij nga Tirana. Është Kamber Ferati nga Kalisi fqinj me Kalanë dhe prezantohet si president i Federatës Botërore të Karatesë e premton se vitin tjetër do të vijë me projekte për këtë festë. Shpresa Krasniqi ka ardhur me gjithë të shoqin Ethem Doda nga Rahoveci, e ndjen veten si pjesë e pandarë e takimit, është mbesë Kalaje, nëna është bija e Harun Domit në Caren. Me ta është dhe çifti nga Skënderaj heroik që fikson shumë foto nga ky eveniment.

Një surprizë erdhi në mes të aktivitetit: Hajredini më prezanton me një burrë energjik të cilit nuk ia përcakton moshën, por marr vesh se është aty me djalin, Rasimin, me djalim e Rasimit Burhanin, me djalin e Burhanit, Korabin, pra katër breza. Ata kanë ardhur nga Gostvari, janë arratisur familjarisht në vitet ’50, por kurrë nuk e harruan Radomirën. E sot duan të përshëndesin. Mallëngjehesh kur Xhelili që nuk ngjan me një kastragjysh, se është plot energji e shëndet, don të hedhë dhe lekë në këtë aktivitet dhe, kur pamë sa u prek kur ia refuzuam, ne u thyem.-Pse më përjashtoni nga fshati im?- tha gati i përlotur.

Dhe festa nuk ndalet, orët kalojnë pa u ndier. Islam Ahmati do që t’i plotësohet kërkesa për këngën e trimit Tahir Sinani që e njohu jo vetëm Radomira ku u bë si bir i saj dhe e dha jetën në krahët e radomirasve, por e njohu gjithë kombi këtë bir Tropoje. Nuk mund të refuzohet kjo kërkesë nga Musai e Sherifi, e Islami mallëngjehet me të drejtë, se e mbajti në shtëpi atëherë.

Një drekë e përbashkët në hijen e pishave vjen si një mbyllje mbresëlënëse dhe të kujton qershorin e vitit 2010 kur mbi 500 vetë u ulën në sofrën e madhe të Korabit. Janë marrë masat, mishi e kosi i Korabit kanë kryet e vendit, por njërëzit nuk e kanë mendjen aty, por te bashkimi në një sofër, nuk është sofër buke, por sofër uniteti, është mikpritja e lashtë shqiptare e trashëguar në breza e që përtërihet.

Kënaqesh kur sheh mes të pranishmëve, që shumica janë të rinj, të moshuarit Kasem Hima,Besim Tabulli Jahe Ahmati etj.

-U ula në këtë sofër të madhe, vetëm sa i provova këto gatime me aromë Korabi, hëngra shumë pak, por jam ngopur si asnjëherë në jetë,- shprehet Kasem Hima, që sot është me gjithë djemtë që kanë ardhur nga Anglia e Amerika. Iliazi ka menduar dhe për kosin e deles së Korabit, shumica ishte dhuratë. Rexhep Domi ka bërë gatimin e një profesionisti, por ndarja e ushqimit për atë sofër gjigante, nuk ishte e lehtë. Zaimi, Hasani, Bashkimi, Kujtimi et. nuk kanë kohë të ulen, janë në shërbim, kurse Ramazani futet vetë në shpërndarje, të rinjtë shpërndajnë ushqimin që aq mirë e shpejt e sistemon. Sa e lehtë ishte shlyerja e detyrimeve të kësaj guzhine origjinale! Ishin të përjashtuar miqtë, fëmijët, askush nuk regjistroi emra, lekët vinin vetë të personat e caktuar.



“KTU NA KE VJET PËR VJET. . .”

Është premtimi i dhënë edhe përmes këngës e me këtë duam të ndahemi. Të gjithë flasin se ç’munt të bëjmë më mirë, por te të gjithë është shqetësimi që sjell mungesë e asfaltit për Radomirë. Është një shqetësim mëse i drejtë që nuk po gjen zgjidhje. Por ka dhe probleme të tjera.

Nuk po promovohet Korabi, Radomira, Kalaja e Dodës. Mediat promovojnë, me të drejtë Thethin, por nuk ulën për Kalanë e Radomirën. Turistët vijnë nga çdo anë e globit, por jo përmes një guide të plotë, por përmes internetit e duke njoftuar njëri-tjetrin. Edhe këtu duhet të punohet përmes Shoqatës që tani i mbushi 5 vjet.

E urimi për t’u mbledhur çdo vit e me më shumë njërëz, na shoqëron të gjithëve deri në ndarjen me njëri-tjetrin e nisjen për në vendbanimet e të ftuarve e të radomirasve.

turizëm

Mikpritja në traditën e matjanit është nga virtytet më të rëndësishme. Por turizmi familjar është praktikë e re, që kërkon parapërgatitje për krijimin e një mjedisi tërheqës turistik. Në kuadër të planit për sezon turistik, sidomos Matit, i duhen guidat dhe sinjalistika turistike. Ligji i ri i turizmit sanksionon që guida turistike është institucion më vete.



Kalaja e Stelushit
Foto: © H.Hysuka

Turizmi në Mat, burim kulture, punësimi dhe kënaqësie

Nga **HAMDI HYSUKA**

Gjeografikisht Mati i takon Rajonit Verilindor të Shqipërisë dhe shtrihet në qendër të Krahinës Malore Qendrore, në formën e një trikëndëshi, me sipërfaqe 1028 km2, në të dy anët e lumit me të njejtin emër. Rrugës nacionale për të shkuar atje ndeshesh me panoramë mahnitëse. Lugina lumore, nëpër të cilën kalon rruga automobilistike, rrethohet nga male të larta, të cilët vijnë duke u ngritur shkallë-shkallë. Karakteristike janë tarracat lumore dhe fshatrat e ndërtuara rrëzë kodrave e maleve. Zona më e lartë është mali i Dejës, 2248 m i lartë.

Pranë e pranë, me reliev malor e klimë mesdhetare kodrinore, Mati ka Mirditën, Kurbinin, Dibrën, Bulqizën, Krujën e Tiranën. Është nga vendet më të bukura klimatike, piktoreske dhe me vlera të shumta historike. Qyteti më i rëndësishëm i krahinës është Burreli, qendër administrative, me vlera dhe tradita kulturore. Në Burrel takon historinë, traditat dhe kulturën matjane.

Kjo krahinë nuk ka vetëm natyrën e bukur, por dhe histori mijëra vjeçare. E banuar që në lashtësi nga fiset ilire të Pirustëve dhe Albanëve, Mati ka histori qëndrese, kulture dhe jetese, pjesë e shtetit të Arbërit, qendër e principatës së Kastriotëve. Është vendi i kuvendeve të mëdha kombëtare. Pjetër Budi, Rexhep pashë Mati, mbreti Zogu I, Ibrahim Dalliu, Ibrahim Temo, Shahin Toçi, Gjin Marku, Abdi Mati, Shaban Çollaku, Dilaver Kurti, Qamil Xhika... të gjithë me "pasaportë" matjane, para se të jenë shqiptarë të mëdhenj, ishin e janë matjanë të denjë, qytetarë të mirë të artit, shkencës, politikës dhe botës së letrave.

Resurset natyrore të Matit janë të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe historike të banorëve vendas, duke formuar kështu bazat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Prandaj kjo krahinë, nga më të bukurat në Shqipëri, me pasuri të gjithanshme mbi e nëntokësore, burime dhe klimë malore të lakmueshme, me florë e faunë të pasur, në çdo stinë të vitit fton e pret vizitorë.

Secili ndjen kënaqësi kur dëgjon për zhvillimin me sukses të turizmit bregdetar, se e ka dhe e meriton përkushtimin e të gjithëve. Por në raport me vlerat dhe rëndësinë, është dhe turizmi malor, i cili duhet t'a ketë interesimin e organizmave të qeverisjes vendore e qëndrore, që në Mat mungon.

Për mjaft turistë krahina e Matit konsiderohet nga vendet më të bukura malore në të gjithë Shqipërinë, më interesantet për t'u vizituar. Vendet ku duhet të shkosh për turizëm janë të shumta. Kurioziteti është i madh që ato, pikat turistike, t'i shohësh vetë. Zonat turistike dhe pikat më tërheqëse, që afron kjo trevë, janë: Liqeni i Ulzës dhe Shkopetit, liqenet e Balgjajt, lumi i Matit, Muzeu Historik, Stellushi, Shën-Trinia, Kuvendi i Dukagjinit, mali i Dejës, Parku kombëtar "Zall-Gjoçaj dhe Mbasdejë", vendbanimet shpellore në laç-Bruç etj.

* * *

Kushtet për zhvillimin e turizmit në Mat janë të përshtatshme, pasi krahina është një kompleks i tërë turistik. Duke hedhur vështrimin e duke parë me syrin e turistit gjithë brezin gjeografik, që nga Ulëza, Derjani e deri në Xibër, dallohen lehtë mjedise tërheqëse me të gjithë faktorët dhe elementët e nevojshëm, kërkesë për një qendër turistike të pa shfrytëzuar deri tani.

Një nga pikat piktoreske në këtë mrekulli natyrore padyshim është Stellushi, i quajtur ndryshe Varoshi ose "Kalaja e Skënderbeut". Stellushi ishte qendër e fortifikuar, jo vetëm kështjellë e fortë, por qytet mesjetar, me fortifikime, banesa, ekonomi të veçantë, rol drejtues në jetën politike, administrative e ushtarake të krahinës. Dokumentat arkivore e bëjnë kryekështjellë të Matit dhe seli të Kastriotëve.

Vendi i dokumentit të parë të shkrimit shqip është Mati. Më 8 nëntor 1462 në Manastirin e Shën-Trinisë, mbi fshatin Shëlli, u mblodh Kuvendi Kishtar i Kastriotëve, nën drejtimin e Pal Engjëllit, kryepeshkop i Durrësit. Në atë Kuvend, krahas të tjerave, u vendos që fëmijët e lindur të pagëzoheshin në gjuhën shqipe. Teksti i shkruar u quajt "Formula e Pagëzimit", i pari dokument që dëshmon se gjuha shqipe është shkruar në atë kohë. Kjo ka rëndësi për historinë e gjuhës e të kulturës sonë kombëtare. Pranë lapidarit, në përkujtim të manastirit ku është mbajtur kuvendi kishtar, shpaloset një bukuri natyrore e veçantë. Rruga automobilistike malore aty të çon.

Në Kishën e Madhe të Shën-Aleksandrit, mes fshatit Dukagjin të Matit, në dhjetor të vitit 1601 u mblodh Kuvendi i Madh Mbarëkombëtar i Dukagjinit, me delegatë nga Dukagjini, Prizreni, Dibra, Shkodra, Zadrima, Lezha, Mati e Myzeqeja, ku u vendos për të filluar luftën e armatosur kundër turqve osmanë. Lapidari ku mbajt Kuvendi, pret e përcjell vizitorë të shumtë.

Edhe fshati Laç-Bruç fton viziorë. Vazhdimësia iliro-arbërore-shqiptare në Luginën e Matit është e vërtetuar dhe e dokumentuar me studimet e vendbanimeve të hershme në shpellat e këtij fshati, me tumat ilire të Matit, rrënoja kalash e faktorë të tjerë, që kanë tërhequr vëmendjen e arkeologëve, spelologëve, gjeografëve etj. Kuvendi i Bruçit, në Fushën e Nredysë, më 26 korrik të vitit 1943, vendoi për shpërthimin e Kryengritjes mbarëpopullore të 31 Korrikut, ku u sulmua ushtria italiane në Burrel, German, Klos e Bulqizë. Jo larg qendrës së fshatit, ku mbahen festime të përvitshme, ndodhen shpellat e Nezirit, Këputës, Pëllumbave e Blazit, secila më interesante se tjetra, në pritje të vizitorëve turistë.

Rrugët kryesore të krahinës janë Burrel-Tiranë dhe Burrel-Peshkopi. Nëpër Mat kalonte rruga e vjetër e karvaneve Tiranë-Dibër, ose Rruga e Arbërit, ku stacion të rëndësishëm kishte fshatin Guri i Bardhë. Ajo qendër e banuar përfaqëson një trevë me vlera historike. Në Gur të Bardhë u lind Pjetër Budi, atdhetar dhe shkrimtar i shquar, poeti i parë i letërsisë shqipe, lajmëtar i qytetërimt europian. Banesa e tij në fshat, Monument Kulture, ruhet nga shteti dhe qëndron e hapur për vizitorët. Guri i Bardhë ka qenë stacion pushimi i karvaneve, kështu që mbetet vend i mrekullueshëm për turistët e natyrës, por dhe të arkivit për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Fshati Batërr, në të djathtë të rrugës automobilistike Burrel-Klos, është vëndlindja e atdhetarit Rexhep pashë Mati, Marshall i Turqisë, ministër i Luftës i Perandorisë Turke, Valì i Madh i Libisë. Në bashkëpunim me rilindasit shqiptarë Ismail Qemali, Hasan Tahsimi, Isa Boletini, Ded Gjo' Luli etj, planifikoi kryengritje për të fituar Pavarësinë e Shqipërisë. Në kohën e lëvizjes së xhonturqëve, nëpërmjet vargjeve të poezisë "Besa-besë", poeti Anton Z. Çajupi e fton të vihet në krye të kryengritjes për pavarësi: "Ngreu Rexhep Pashë, ngreu / ngreu se të pret atdheu, / në ke sedër e namuz, / mos rri në Tarabolluz (Libi). Shtëpia e tij, majë një kodre të bukur, rrethuar me avllì, ruan elemente etnografike dhe historike.

Fshati Urxallë në zonën e Derjanit është vendlindja e Shahin Toçit, i cili në Akademinë Ushtarake të Romës nuk u betua për flamurin italian dhe bashkimin e Shqipërisë me Italinë. I përjetësuar në këngë: "Kjo Shqipni ka lindun burra, / që nuk njohin dy flamura..." muzeu i familjes së tij në Urxallë pret e përcjell vizitorë.

Krahina e Matit përmendet në histori si qendra më e madhe e prodhimit të barutit, zejë që ushtrohej në fshatrat Dars, Bel, Fshat, Guri i Bardhë, Bejn, Klos. Në Muzeun Historik të krahinës ndodhet maketi i dingës së prodhimit të barutit.

Populli matjan trashëgon një pasuri të madhe të kulturës dhe folklorit popullor, sidomos në veshje, muzikë, valle dhe këngë popullore. Si trevë etnografike dallohet për repertorin e pasur të valleve popullore, sidomod për burrat. Vallet e burrave përbëjnë një pasuri të rrallë, ku shquhet tradita e fshatrave Lis, Burgajet e Kurdari. Prandaj Muzeu Etnografik i Klos-Katundit kërkon rihapje, rikonstruksion dhe pasurim.

Mundja, vrapimi, qitja me armë, hedhja e gurit, noti, alpinizmi etj, janë sporte të ushtruara që në lashtësi. Shoqëritë sportive të dikurshme ndihmuan në zhvillimin e futbollit me ekip të stabilizuar. Ali Mata, trajner i ekipit kombëtar të qitjes, si dhe vajza e tij, Diana Mata, kampione kombëtare dhe europiane në sportin e qitjes, janë nga fshati Barbullej i Matit.

Po të ndalemi në fshatin Macukulli, nga më të veçantit, pranë e pranë qëndrojnë mali, pylli, ara, shtëpitë karakteristike të mbuluara me rrasa. Gjithçka këtu është natyrale, male të bukura, njerëz të pastër dhe natyrë e mrekullueshme. Në prehër të tij qëndron mali i Dejës, i mrekullueshëm për alpinizëm të të gjitha moshave.

Edhe lumi Mat, me degët Lezedra, Lusa e Mallunxës, Zalli i Batrrës, Zalli i Germanit dhe lumi i Urakës, bashkë me burimet ujore nëntokësore të Vinjallit, Gurrës së Shëlliut, Gurrës së Vogël, Shutrrejës dhe Gurit të Bardhë, gjatë rrjedhës së tyre kanë një florë dhe faunë shumë të pasur për banorët vendas dhe miqtë turistë.

Mikpritja në traditën e matjanit është nga virtytet më të rëndësishme. Por turizmi familjar është praktikë e re, që kërkon parapërgatitje për krijimin e një mjedisi tërheqës turistik.

Në kuadër të planit për sezon turistik, sidomos Matit, i duhen guidat dhe sinjalistika turistike. Ligji i ri i turizmit sanksionon që guida turistike është institucion më vete.

Edhe turizmi historik afron mundësi. Qyteti i Burrelit ka një muze të pajisur me objekte historike, veshje popullore, relike të luftëtarëve, portrete në skulpturë të figurave matjane më përfaqësuese në shkallë kombëtare. Ata që vizitojnë Matin, informacionin e parë mund ta marrin nëpërmjet mediave: Mat TV, gazetës "Mati", revistës "Emathia" dhe Radios së Parë. Edhe Bashkia ka zyrë të Turizmit, ku nëpërmjet hartave e fletëpalosjeve, afron informacion mbi banesën matjane, shtrirjen e monumenteve të kulturës etj. Këto faktorë natyrorë e historikë përbëjnë bazën dhe mundësinë për zhvillim turizmi në Mat, burim kulture, punësimi dhe kënaqësie për vizitorët.





Dibra, turizëm në tokën ku Korabi përkëdhel Lurën

Rajoni i Dibrës shtrihet në Lindje të Shqipërisë, në një terren të thyer përgjithësisht malor, por i kombinuar në të ashtuquajturën zonë e ulët që fillon nga lumi Drin i zi dhe sa vjen e lartësohet në pllaja. Kodra dhe male të thepisura deri në kufi me Republikën e Maqedonisë. Vargmalet e Korabit, malit më të lartë në Shqipëri, kanë një bukuri të rrallë. Ato mbajnë mbi supe kreshta malesh të përbëra nga guri gëlqeror dhe formacione gipsi, të veshura me bimësi barishtore të kullotave alpine të llojeve të shumta e që formojnë një tapet të gjelbër në periudhën pranverë-verë. Lulet e shumta shumëngjyrëshe, burimet ujore të karaktereve ujëvara, liqene natyrale, drurët pyjorë të llojeve fletore dhe halore të cilat vetullojnë këto zona alpine, shfaqin një pamje të shkëlqyer peizazhi për banorët vendas dhe vizitorët. Shumë zona të tilla si Kalaja e Dodës me Korabin madhështor e livadhet alpine, zona e Gramës me kullotat alpine, liqenet natyrale të tipit karstik, liqeni artificial në qendër të Gramës, i shoqëruar me drurët pyjorë të bredhit e pishës, janë me të vërtetë perla të rajonit tonë.



ZONA E KALASË SË DODËS

Mirë se vini në Kala të Dodës, porta e malit më të lartë të Shqipërisë. Kalaja e Dodës është porta dhe streha për ata që duan të arrijnë majën e Shqipërisë, malin më të lartë të vendit tonë dhe një ndër më të lartët në Gadishullin e Ballkanit. Dy janë rrugët nga arrihet në fshatrat karakteristike të Kalasë së Dodës. Ajo arrihet si nga Peshkopia apo Dibra e Madhe në rrugën Peshkopi-Kala e Dodës, si dhe Kosova e Kukësi mund ta arrijnë që nga rruga Kukës- Bushtricë-Kala e Dodës. Komuna Kala e Dodës shtrihet në verilindje të qytetit të Peshkopisë, me distancën më të afërt 30 km dhe më të largëtën 40 km nga Peshkopia. Tri elemente shumë të rëndësishme për jetën mund të gjenden atje: ajri shumë i pastër dhe i freskët, uji i ftohtë si dhe prodhime blegtorale, mish dhe bulmet i një cilësie shumë të lartë (BIO). Kushtet e strehimit janë në përgjithësi modeste, por që shkojnë çdo ditë në përmirësim, dhe vilat e para të kompletuara vijnë në shtim.

MALI I KORABIT

Mali i Korabit përbën pjesën më të lartë të krejt vargut me të njëjtin emër, duke qenë jo vetëm mali më i lartë i Shqipërisë (2751 m), por edhe një nga më të lartët e Gadishullit Ballkanik. Korabi shtrihet midis luginës së përroit të Veleshicës dhe asaj të përroit të Gramës. Kurrizi i Korabit ndahet në tri kreshta kryesore prej gropash kontakti, si ajo e Panairit, e Staneve të Preshit dhe ajo e Bjeshkës së Shehut. Fusha e Panaritit Ndër këta, më e njohura është gropa e Panairit. Peizazhi i saj është madhështor. Mbi të qëndron maja e Korabit, ndërsa ka formën e një stadiumi në krye të të cilit është një burim me ujin më të ftohtë që buron në Shqipëri. Vendasit rekomandojnë që uji i Panairit mund të pihet vetëm duke përdorur pipëza, pasi përdorimi direkt krijon probleme. Kjo për shkak të temperaturës shumë të ulët. Nëse vizitori arrin në muajin qershor në këtë fushë, pranë burimit ai do të gjejë borë dhe krahas kësaj plot lule me një pasuri të jashtëzakonshme bimësh e ngjyrash. Vendasit mendojnë se emri Panair vjen nga fakti që në shekuj ky vend është përdorur si panair i blegtorisë për të gjitha vendet e Ballkanit. Kjo gropë ka formë vezake, me fund gati të sheshtë, e cila varet mbi lugun akullnajor të rrafshit të Korabit në veri, me një prag gati 200 m të lartë. Gropa e Panairit ka dy kreshta, atë të Moravës (2716 m) dhe atë të Rosnikut (2567 m), të cilat bashkohen te maja e Korabit. Karakteristikë e shkëmbinjve përbërës të këtyre kreshtave janë brezat gëlqerore e të mermerizuara. Cirqet akullnajore që skalitin këto kreshta dhe që formojnë cirqe komplekse, janë të ruajtura më mirë se kudo gjetkë. Ata shtrihen në formë të shkallëzuar derisa përfundojnë në lugun akullnajor të Rrafshit të Korabit në veri dhe në gropën e Panairit në lindje. Gropa e Panairit ndahet nga ajo e Staneve të Preshit (vendburim i ujit që furnizon qytetin e Peshkopisë) nga kreshta e famshme e Moravës, duke formuar një rrëpirë 600-700 m të lartë.

RRAFSHI I KORABIT

Përpara se të arrihet në Panair, vizitori normalisht duhet të kalojë rrafshin e Korabit, e quajtur nga vendasit edhe fusha e Korabit, që historikisht ka shërbyer edhe si urë lidhjeje për Kalanë e Dodës me shqiptarët e Maqedonisë dhe ata të Kosovës. Është kjo arsyeja që vendasit i kanë kushtuar kësaj fushe plot këngë e legjenda. Gjatë periudhës së verës ajo është mbushur plot me stane dhe me tufa delesh. I ngjan një qilimi gjigant me lule, të cilat nga java në javë i lënë radhën njëra-tjetrës. Kjo fushë, që ndodhet në veri të malit, ka tipare të qarta të një korite me gjatësi rreth 3 km. Në të formohen disa pragje, derisa zbret mbi fshatin Radomirë, ndërsa në fundin e saj takohen edhe disa kodrina. Vizitorëve kjo fushë, krahas ajrit të pastër, freskisë e bukurisë mahnitëse, u ofron edhe kushte shumë të mira për pista skish apo aktivitete të tjera dimërore. Në këtë rrafsh dëbora qëndron mesatarisht mbi 6 muaj. Mjafton një orë ngjitje nga fshati Radomirë për t'iu afruar që në mëngjes rrafshit të Korabit. Ky pastaj mund të jetë fillimi për vizitorin. Për t'u vizituar nuk është vetëm maja e Korabit, nuk është as vetëm fusha e Panairit. Janë edhe plot bukuri të tjera të natyrës që shkurt do t'i përshkruajmë më poshtë: Gropa e Staneve të Preshit në jugperëndim ka formë të përzgjatur dhe është më e gjerë se ajo e Panairit. Në të formohen pragje deri në fshatin Radomirë. Në pragun më të poshtëm gjenden 5 liqene akullnajore që janë në tharje, por që akoma ruajnë vlera që i shtojnë këtij peizazhi.

PORTAT E KORABIT

Kreshta tjetër e këtij mali është ajo e Portave të Korabit, e cila ndahet nga vetë maja e Korabit prej qafës me të njëjtin emër (2475 m lartësi). Kjo kreshtë, në të cilën lartësohen dy maja me lartësi mbi 2700 metra, ndan gropën e Staneve të Preshit në verilindje nga ajo e Bjeshkës së Shehut në jugperëndim. Kjo e fundit, në ndryshim prej dy gropave të lartpërmendura, është thelluar aq shumë nga një dege e përroit të Veleshicës, saqë ka marrë më tepër tiparet e një lugine. Në shpatin lindor të kreshtës së Korabit takohen dhe mjaft forma të karstit nival, që përfaqësohen nga hinka, ulluqe dhe gropëza të ndryshme. Dukuritë e ngricave kanë çuar në formimin e rrjedhjeve të shumta gurore që zbresin nga këto kreshta drejt fundit të cirqeve. Kur vizitori don të shkojë në drejtim të malit të Gramës (pjesë e këtij ansambli madhështor), ky kurriz ulet dhe bëhet gjithnjë e më i butë, sepse gëlqerorët i lënë vendin rreshpeve. Shpati perëndimor i këtij kurrizi bie mjaft pjerrët në shpatullën akullnajore të Bjeshkës së Zonjave, midis Malit të Bardhe dhe atij të Gramës. Kjo shpatullinë është formuar në kontaktin tektonik të rreshpeve me gipset e Malit të Bardhë dhe përbën një prag litologjik. Prania e gipseve nën këtë prag e ka ruajtur atë nga shkatërrimi, duke penguar erozionin mbrapësor të përroit të Grames. Ky prag i transformuar në një shpatullinë gjatë akullzimit, ka gjatësi afro 2 km, gjerësi deri në 1 km dhe mbi të gjenden dy liqene akullnajore. Pjesa më mahnitëse e tij është përroi i Lushit, i famshëm për bukurinë e luleve të pranverës si dhe për pasurinë e madhe të biodiversitetit e veçanërisht të llojeve të rralla. Vizitorin e masivit të Korabit e mahnitin kontrastet e theksuara midis majave të larta e mjaft të mprehta me natyrë alpine dhe e luginave, grykave, lugjeve e gropave të thella. Bimët, kafshët si dhe pasuria e madhe në ujëra i shton së tepërmi vlerat e këtyre peizazheve, që përbëjnë një pasuri të madhe, si dhe një të ardhme për zhvillimin e turizmit në vendin tonë.

LURA

Por jo më pas tyre qëndron Lura, e cila është një perlë e tipit alpin, me pyje të shumta të llojeve halore, me fshatrat e saj të vendosura në pllaja e lugina, me shtate liqenesh natyrale të tipit karstik, të cilat janë një shfaqje e rrallë e bukurisë natyrore Fusha e Pelave, me një sipërfaqe 50 hektarë, është e rrethuar kudo me bredh e pishë dhe paraqet një pamje vërtet mahnitëse, ku sipas dëshmive të të moshuarve, në kohë të hershme organizoheshin gara me kuaj gjatë periudhës së verës, ndaj quhet edhe "Fusha e Pelave". Tufa të mëdha dhensh kullotin në bjeshkën e Gjargjishtit, e cila ka bar dhe lule të shumta. Banoret janë shumë mikpritës, ata janë vërtet të varfër, por me zemër të madhe. Mbarështojnë kryesisht dele dhe bletë. Jeta e tyre është e lidhur kryesisht me pyllin dhe tokën e pakët. Druri ata i shoqëron gjatë gjithë jetës së tyre. Në mes të pllajës shtrihet një lumë me ujë të pastër, i cili buron nga malet e larta. Por burimet ujore me ujë kristal janë të shumta.

LURA E VJETËR

Vetëm 2 km nga Fushë-Lura për në perëndim, shtrihet Lura e Vjetër, dikur sektori i sharrave të ish-Ndërmarrjes së Shfrytëzimit. Aty ka burime të shumta uji dhe pishat e bredhat të shoqërojnë kudo. Aty në mes të fshatit ka edhe një kishë për banorët e besimit katolik.

LIQENET E LURËS

Nga Lura e Vjetër rruga të drejton për në zonën e liqeneve, të cilat janë shtatë. Përgjatë rrugës shpaloset bukuria e maleve të mbuluara me drurë, çeltirat me lule shumëngjyrëshe dhe ndjehesh i emocionuar nën cicërimën e zogjve dhe bilbilave. Atykëtu dëgjon edhe këngën e gjelit të egër, një pasuri e rrallë dhe e bukur kjo e kësaj treve.

* * *

Pamje të tilla shumë të bukura mbajnë në vetvete edhe zonat e Ilnicës (Hinoska) dhe bjeshka e Pocestit me ujëvarën e saj fantastike. Në zonën e Bulqizës, në pyjet e Ternovës shpaloset një peizazh shumë i bukur natyror me pyje dhe liqene natyrale, të cilat i zbukurojnë së tepërmi vlerat e mjedisit të kësaj zone. Këto vlera peizazhistike që bartin zona të caktuara të rajonit, bëhen edhe më interesante kur njëherazi shpalosen edhe historitë e banorëve vendas, simbioza e tyre me pyllin, kullotën, blegtorinë. Por ata janë edhe shumë mikpritës dhe të respektuar për mikun, dashamirës për vizitorët dhe vizitat që u bëhen, të gatshëm në rrëfimin e të dhënave historike.

(Ky shkrim është një material i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Turizmit që synon promovimin e turizmit në Shqipëri.)

QEVERISJA VENDORE

Kryetarët e bashkive marrin zyrtarisht detyrën

Konstituohen këshillat bashkiakë dhe zgjidhen kryetarët e tyre në Bulqizë, Klos, Burrel dhe Dibër



Më 22 korrik nisi në qarkun e Dibrës konstituimi i të zgjedhurve të rinj vendore. Në bashkinë e Bulqizës Melaim Damzi mori zyrtarisht detyrën e kryetarit. Ndërsa Gazmend Kenga u zgjodh si kryetar i këshillit bashkiak. Kënga renditej i pesti në listën e këshilltarëve të PS, dhe janë dashur dy dorëheqje që ai të hynte në listën e këshilltarëve, duke të marrë edhe postin e kryetarit të këshillit.

Një ditë më pas Nezir Rizvani u betua si kryetari i ri Bashkisë Mat, ndërsa postin e kryetarit të këshillit e mori Agim Hysa i LSI. Kryetari i bashkisë së Matit do t'i duhet të punojë me një këshill bashkiak që drejtohet nga e majta dhe kjo pritet të sjellë shumë probleme në të ardhmen.

Ndërsa në Dibër Shukri Xhelili e mori zyrtarisht detyrën më 24 korrik. Gjatë ceremonisë së marrjes së detyrës, ishte i pranishëm edhe ish kryetari i bashkisë Peshkopi, Ilir Krosi, i cili i uroi detyrën e re. Ky ishte ndër rastet e pakta në vend, kur tranzicioni i pushtetit bëhet në mënyrë kaq demokratike. Kryetare e Këshillit në Dibër me shumicë votash u zgjodh Lulzime Dani e PS. Kështu që Partia Socialiste në Dibër i ka të gjitha mundësitë që t'i bëjë reformat e reja në këtë bashki, pa pasur asnjë bllokim për shkak të votave në këshillin bashkiak.

Konstituimi i fundit për Qarkun e Dibrës ishte ai i Klosit, kur kryetari i ri ka arritur të binde këshillin bashkiak për t'i marrë koalicionit të majtë edhe kryetarin e këshillit. Zana Elezi e Partisë Demokratike ka marrë shumicën e votave, megjithëse koalicioni i majtë kishte 12 këshilltarë ndërsa aleanca për Punë dhe Dinjitet kishte 9 këshilltarë.

Në ceremonitë e konstituimeve të këshillave bashkiakë kanë marrë pjesë edhe deputetët e Dibrës, si dhe përfaqësues nga qeveria, dhe organizata të shoqërisë civile.

Më parë se kryetarët e rinj dhe këshillat të konstituoheshin, kryeministri Edi Rama dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, gjatë një takimi me të zgjedhurit vendorë, kanë prezantuar manualin praktik që do t'i udhëzojë drejtuesit e rinj ne fazën tranzitore të konsolidimit të bashkive të reja.

Udhëzuesi Praktik përmban rekomandime dhe hapa konkret duke filluar me ditën e parë të mandatit deri në tejkalimin e fazës tranzitore, në fund të vitit 2015. Ky udhëzuesi i përgatitur nga Ministri i Çështjeve Vendore dhe Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, përmban udhëzime praktike për të gjitha hapat ligjor, financiar dhe administrativ që duhet të merren në konsideratë nga të zgjedhurit vendorë për të konkretizuar dhe realizuar me sukses konsolidimin e njësive të reja administrative.

Ndërsa më 16 korrik, disa kryetarë bashkish, gjatë një takimi me zv/kryeministri Niko Peleshi, Ministri për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi dhe Ministrja e Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni, morën asistencën e qeverisë për realizimin e Planeve të Përgjithshme Vendore, sipas ndarjes se re territoriale.

Ky projekti, sipas zv. kryeministrit, ofron asistencë dhe financim të qeverisë shqiptare, synon realizimin e një qasje të re në planifikimin e territorit.

"Qeveria do të mbështesë në të gjitha fazat dhe do të koordinojë punën për realizimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 bashki, theksoi Peleshi gjatë takimit.

26 bashkitë e para që përfitojnë nga ky instrument, janë përzgjedhur nga bashkitë që kanë pasur një plan të përgjithshëm vendor sipas ndarjes së vjetër territoriale, por që duhet të përshtatet dhe të rishikohet sipas ndarjes së re. Bashkitë e tjera që nuk i kanë pasur këto plane, do të përfitojnë nga ky instrument vitin e ardhshëm.

Përmes Planeve të Përgjithshme Vendore do të analizohen territoret e reja administrative, si asete dhe hapësira operimi ku do të zhvillohet vizioni strategjik i zhvillimit të territorit urban, natyror dhe/ose prodhues. Gjithashtu do të hartohen programe zhvillimore dhe investimesh kapitale si dhe paketa projektesh prioritare strategjike, për të testuar modele të ndryshme zhvillimi me aktorë publik e privat.

Ministrja e Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni u shpreh se ky është një projekt ambicioz i cili do të realizohet brenda një kohë mjaft të shkurtër dhe për këtë kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve. Planet do të jenë gati në janar 2016, dhe na bazë të tyre do të fillojnë të jepen lejet e zhvillimit nga kryetarët e rinj të bashkive.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kryetarët e rinj e morën detyrën në Dibër. Dhe lajmi ishte se "pushteti është vazhdimësi" - dhe se "kryetari i Bashkisë Peshkopi e pret në zyrë për t'i dorëzuar detyrën kryetarit të bashkisë Dibër". Dibra votoi në "drejtimin e duhur", kështu që mos vallë pritej që çelësat e derës t'i kishte pastruesja, ndërsa ish kryetari të kërkonte azil në Gjermani?!

Pas marrjes së detyrës nga kryetari i ri në Dibër kanë filluar edhe shqetësimet: cila duhet ndërtuar më parë, stadiumi i ri, rruga për Staravec, ajo për Bugjunec, apo...? Ta bëjmë me short: kujt i bie letra me vrimë...

Vapë e madhe në korrik dhe "Drini mban era djersë", - shkruante një miku im në facebook. Thonë që njerëzia nuk ka para t'i bëjnë pushimet në det, kështu që burrave dhe grave u ka dalë turpi dhe po nxihen në Dri. Në fund të fundit, shyqyr që e kemi. Nuk thonë kot: "Të shpëlaftë Drini"...

Turizmit ia kemi dëgjuar emrin. Thonë që është një punë që duke bërë qejf, fiton edhe lekë. Por kur të vijnë turistat, ndryshon puna: "Dashkan këta të k'naqen, e unë të punoj n'vapë. S'bahet kjo punë..."

I thashë një pronari restoranti diku në këto katundet që shkojnë turistë:

"- Çfarë ke ndonjë gjë të veçantë, pasi javës tjetër dua të sjell ca miq nga larg - rreth 10 veta!"

"- Kos sa t'dush, gjath sa t'dush, ene buke n'çerep. Si ta kesh çefin, ta pres ene ni kinxh a ni eth, ene ta qekish n'zerm".

"- Unë ni eth due, por a duhet me e qek vetë?"

"- Po pse mor, taj dashke me ta qek unë edhin? A do e hash vetë, piçe vete!".

"- Po unë paguaj, sa të duash?"

"- Eee, pagueke taj! Hiçmu mor anej, se si due paret tueja. Taj dashke me ba qejf, e un t'përzhajtëm neë zerm".

Korabi ka filluar stërvitjen, por duket se "një krisje" e ka marrë pa nisur puna. Korabi në FB që mbizotëron ngjyra e kuqe e ekipit, ka filluar stërvitjen në Tiranë, me trajner të ri dhe lojtarë të rinj. Ndërsa Korabi në FB që mbizotëron qielli blu i stadiumit të Peshkopisë ka filluar stërvitjen në Peshkopi, me lojtarët që ishin dhe trajnerët që kishin. Se kush do të shkojë në fushë zyrtarisht, këtë do ta vendosë kryetari i ri i bashkisë.

Ky muaj është edhe kur fëmijët kthehen në shtëpi. Kanë punuar gjithë vitin rrugëve të botës dhe kthehen të pushojnë pranë familjeve të tyre. Se pushime më të mbara se në shtratin ku je rritur, nuk ka në asnjë vend të botës. Por, "turistët" i bezdis pyetja se: "kur erdhe dhe kur do shkosh!" Kështu që një djalë nga Dibra e gjeti zgjidhjen, duke stampuar në bluzën e tij: "Kum ordh me 07.07, do shkoj me 08.08. F.L.M."

Ndërsa ata kthehen, të rinjtë po ikin. Në mes të vapës. Kujtojnë se shkojnë në Gjermani, por strehohen nëpër kampe. Duke fjetur nëpër çadra e duke ëndërruar Europën.

Në Bulqizë humbi jetën një minator. Ngjarja ka ndodhur në një nga galeritë private të zonës. Ca lajme thonë se "është përplasur nga elektrovozi teksa tërhiqte vagonët", ndërsa ca lajme të tjera thonë se "e kishte zënë një masiv shkëmbor". Se si është e vërteta po heton policia. Por kjo nuk e ka penguar opozitën që të akuzojë qeverinë për "neglizhencë", "braktisje", "harresë". Nga ana tjetër, qeverinë gjen rast të bëjë deklaratë për sukseset e saj, uljen e moshës së daljes në pension dhe rritjen e pensioneve për minatorët. Kaq keq janë partitë tona, sa nuk presin tre ditë të paktën, sa t'i bëhen të ndjerit nderimet e duhura?!

Për rrugën e Arbrit tani na siguron ambasadorja e Kinës në Tiranë. Ndërsa ministri numëronte sukseset e qeverisë: me kontratë shembull, me grupe pune që punojnë e negociojnë, me ndihmë e bashkëpunim të konsulentëve ndërkombëtare dhe kismet, vitin tjetër fillon puna, ambasadorja thotë se "me përfundimin e procesit të negocimit të kontratës, Rruga e Arbrit do të mund të fillojë brenda vitit". Me siguri që e ka fjalën brenda këtij viti, se Haxhinasto e kishte fjalën për vitin tjetër..

Dasmat filluan! Mos harro kur të shkosh, merr tampon me vete, kontrollo ushqimin para se ta futesh në gojë, mos pi shumë dhe lëre pistoletën në shtëpi! Për krismat dhe muzikën mendon i zoti i shtëpisë!

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Risk – mjete jetese, të mira materiale
Riza - dëshirë, pëlqim. Për riza te Zotit – Për pëlqimin e Zotit.
Razi – i kënaqur. U bëra razi – pranova, pëlqeva
Runak - i ndritur, i mirë
Rutbe– gradë, pozitë
Ryshfet– ajo që jepet për të ndaluar apo për të realizuar diçka që nuk të takon
Sabah - mengjez
Sabër – durim
Sabij – femijë
Sadaka – lemoshë
Sadrazem– (sadru-el-eadham) Fjalëpërfjalë – Gjoksi më i Madh) kryeministër
Safa - ***pastërti; kthejlltësi; qartësi***
Safë - ***kuti teneqeje; enë prej teneqeje si gota e tj.; bidon***
Safi – i qartë, i paster
Sahab – shok
Sahan - pjatë
Sahat – orë
Sakat – i pavlerë,që nuk të sjell ndonjë të mirë
Saki – ai që të jep të pish ujë, ujedhënës
Sakija – enë me të cilën të jepet të pish ujë
Salep – salep
Salltanet – 1.sulltanat,mbreteri; 2. bashkëshortja e sulltanit
Saraç – prodhues shalash
Saraf - kambist; arkëtar banke; mbledhës taksash
Satër – thikë mishi
Sebep - shkak
Sedef – guackë perlë, guackë deti në përgjithësi
Sefa - pastërti, kthjelltësi, sinqeritet
Sehir – shikues, spektator; Bën sehir- qëndron spektator
Sekine – e qetë, e sigurtë, e heshtur
Selam - paqë, siguri; të fala; nderim
Selamet – shpetim; shërim nga sëmundja
Sënduk - arkë
Sene – vit, motmot
Setër – xhaketë, pallto
Sevap – bërje mirë; shpërblim
Sexhade - tapet
Shahid – (sheehid) dëshmitarë
Shahit– (shehiid) dëshmor; rra shahit - ra deshmorë
Shamatë - zhurmë, zallamahi
Shart – cilësi, kusht. Shartet e burrërisë – cilësitë,kushtet e burrërisë
Shefak - muzg, mugëtirë
Sheh– i vjeter, i ditur; kryetar, mjeshtër
Shehadet – deshmi, betim. Bie në shehadet – thotë betimin islam:" Nuk ka zot, përvec Allahut dhe Muhameti i derguari i Tij"
Shejtan – djall
Sherbet - pije e ëmbël pa alkol; lëng; shurup
Sheriat – e drejta ligjore islame
Sherr – keq, e kunderta e të mirës.Prej këtu: **sherret**- grindavec
Shibe – dyshim
Shirit – rrip prej pambuku ose mëndafshi për flokët; kordele
Shynik – detyrim, pagesë (për vrasje); blerje e gjakut
Shyqyr – falenderim
Silah – armë
Simite - kulaç
Sini - pjatancë
Sofer - tryezë buke
Sokak – rrgicë, rrugë e ngushtë
Subhanallah – i madhëresh ëm është Allahu!
Sugjar – më i vogël, vogëlush
Sulltan - sundimtar
sune - zakon, praktikë; traditë; rrugë, mënyrë; Në fenë islame: tërësia e thënieve, tregimeve, veprimeve dhe e vendimeve të profetit Muhamed (as)
Surat dhe **Syret** - fotografi, formë
Syfyr – të ngrënët dhe pirët në te zbardhë të ditës për agjëruesit
Syrgjin – i burgosur
Tabak– 1. pajisje, ku sillet ushqimi për të ngrënë; 2. sasi,grumbull; një tabak leter duhani - një tufë letër duhani
Tabihat – natyrë, karakter
Tabut – 1. qivur, arkivol; 2. arkë druri
Tahma - makutëri, babëzi; pangopësi
Tahmi - hamendje
Tajare – aeroplan
Takat - fuqi
Takëm - komplet

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 111

futboll



Korabi gjatë një stërvitje në Pezë-Helmës në Tiranë. Foto: © Studio IGLI

Korabi, përzgjedhja e lojtarëve fillon me konflikte

Më datë 25 korrik, Korabi zhvilloi ndeshjen e parë miqësore me Internacional Tirana, ku ekipi e mbylli me një barazim 1-1.

Në këtë ndeshje shumica që luajtën ishin lojtarët e rinj. Pranë ekipit janë afruar Elvis Prenci që vjen nga Teuta, Elio Shazivari i Dinamos, Byrjon Myzyraj dhe Alvaro Bisha të Tomorritt, Odeon Berdufi i Sopotit, portieri Klajdi Kuka i Terbunit, Erlis Frashari i Luftetarit dhe mbrojtësit Halim Begaj dhe Ledi Licaj nga Flamurari.

Por ndërkohë kur pritet hedhja e shortit të kategorisë së Parë, ku Korabi bën pjesë në Grupin A, në ekip kanë filuar të shfaqen shenjat e para të mosmarrëveshjeve.

Presidenti Femi Mëziu njoftoi se më datë 20 korrik do të niste stërvitja e ekipit në Pezë Helmës në Tiranë. Sipas Mëziut, gjatë stërvitjes do të testohen të gjithë lojtarët.

Tashme ekipi do jetë nën drejtimin e një stafit të ri teknik me trajner Dritan Mehmeti, për formimin e një grupi të lojtarëve që do të jenë pjesë e ekipit të Kategorisë së Parë. Mëziu bën me dije se do të vihen në funksionim edhe ekipet zinxhirë.

Por thirrja e tij që lojtarët që duan të testohen pranë ekipit, të bashkohen për të krijuar një ekip të fortë dhe pretendent për Superligë, nuk është pritur mirë.

Një faqe tjetër në Facebook, FC Korabi, i është kundërvënë Mëziut, duke mos e quajtur atë president legjitim dhe kështu që nuk ka të drejtë të bëjë me ekipin çfarë të dojë.

"Pas një takimi disa orë me përfaqësues të tifozëve kemi rënë dakord që duhet të presim vendimet zyrtare dhe i menjëhershëm do jetë reagimi ynë", shkruan faqja FC Korabi.

Me të njëjtin emër në Facebook ndodhen së paku edhe gjashtë faqe të tjera, duke sjellë pështjellim të tifozët.

Por ka qenë një reagim i trajnerit që e kaloi ekipin në kategorinë e parë, Erblin Laçi, i cili shkruan në Facebook se "ekipi korabit s'ka patur dhe akoma nuk ka një president të tillë që mendoni ju dhe shumë të tjerë. Presidenti i vetëm ka qenë dhe është aktualisht vetëm bashkia e qytetit Peshkopi. Mos jepni deklarata të pa qena. Unë skam ndonjë vendim me shkrim për shkarkimin tim nga detyra", komenton ai.

Po ashtu, edhe Shpëtim Toska, zv. trajner i Ekipit, shkruan se "nuk ka asnjë komunikatë zyrtare nga klubi sportiv i Korabit në lidhje me të gjitha njoftimet që janë postuar në këtë faqe. Korabi është i varur nga bashkia Peshkopi, që është dhe mendoj që do të jetë përherë përkrahëse e futbollit në Dibër dhe donatori kryesor".

Toska shkruan se ekipi ka vazhduar stërvitjen në fushën kryesore në Peshkopi. Ai ka kundërshtuar mbledhjen e ekipit në Tiranë, duke theksuar se "të gjitha thirrjet që po bëhen janë për përçarjen e ekipit, të stafit dhe të tifoza të Korabit.

"I vetmi vend ku ekipi i Korabit do të mbajë premtimet e veta është stadiumi i Peshkopisë", shkruan Toska.

Lajmi për një stadium të ri që dha deputeti i Dibrës Ulsi Manja, është shoqëruar me paqartësi në lidhje me të ardhmen e ekipit. Presidenti Femi Mëziu zgjedh trajnerin e ri dhe fillon përzgjedhjen e lojtarëve në Tiranë, ndërsa Erblin Laçi dhe Shpëtim Toska presin kryetarin e ri të bashkisë së Dibrës, si i vetmi autoritet që merr vendime në lidhje me të ardhmen e ekipit.

Ndërkohë që komentet - shpesh edhe fyese në Facebook vazhdojnë, deputeti i Dibrës Ulsi Manja njoftoi se "bashkë me me Kryetarin e Bashkisë Shukri Xhelilin, kemi nisur bisedimet teknike për ndërtimin e një stadiumi model dhe modest që ky ekip meriton me mbështetjen e fuqishme të Qeverisë Rama. Jemi me fazën ku një grup ekspertësh do vijnë për të bërë projektin në kohë rekord. Financimi i ndërtimit është garantuar".

Por, pas lajmeve të mira për stadiumin, duket se pritet një vendim i kryetarit të ri të bashkisë se çfarë do të ndodhë me Korabin.

A do të vazhdojë Mëziu të realizojë projektet e tij ambicioze për ekipin, apo Laçi dhe Toska do të vazhdojnë misionin me të njëjtin ekip që korrën sukses edicionin e kaluar.

Për momentin, debatet vazhdojnë në rrjetet sociale, në pritje të vendimeve zyrtare të bashkisë së Dibrës.

B.KAROSHI

Pajtohu në gazetën
RRUGA E ARBËRIT

***Merr versionin* PDF ose kopjen**
print duke filluar me 50 lekë/muaj



Për informacion: E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

AJA
AlpJon ALBANIA
TURE TURISTIKE NË TË GJITHË SHQIPËRINË
Address: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kati II.
Tiranë, Albania
Mob: +355 (0) 67 47 32 492
E-mail: info@alpjonalbania.com
Web: www.alpjonalbania.com

Bëj pajtimin tënd me
PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.**
Tel: **068 22 46 400**


Qendra Shqiptare e Syve
Prof. Asc. ALI TONUZI
kirurg vitreorentinal

Adresa: Rr. "Dibrës",
Kompleksi Halili,
Përballë Vila "**Gold**", Kati II.
Tel: **+355 4 2419087**
Cel: **0694003600**
E-mail: **tonuzi_ali@hotmail.com**



ekspeditë

Nga datat 4 -11 korrik, 11 speleologë bullgarë eksplorojnë shpellën e Rusit në Çidhën dhe shpellën ujore të Sopanikës në burimet e Setës. Zbulimet mahnistin shkencëtarët dhe të dhënat që pritet të publikohen së shpejti mund të çojnë në riklasifikimin e zonës si pasuri e mbrojtur kombëtare dhe rritjen e numrit të turistëve. Gëzohen ambjentalistët: Ky zbulim mund të ndalojë ndërtimin e HEC-it në lumin Seta.



Gjenden xhevahire në Shpellën e Rusit

"Shpella e Rusit është një humnerë vertikale. Në ekspeditën e mëparshme që u zhvillua në vitin 2013, ne arritëm vetëm 60 metra në thellësi, ndërsa këtë vit ne kemi arritur deri në 200 metra dhe akoma fundi i shpellës nuk shihet".

Nga **BUJAR KAROSHI**

"Te shpella e Rusit, përveç stalaktiteve, stalagmiteve janë gjetur edhe xhevahire". Kështu thotë për radion bullgare BNR, Aleksej Zhallov (Алексей Жалов), njëri nga speleologët më të njohur në Ballkan.

Nga data 4 deri më 11 korrik, 11 anëtarë të klubit "Heliktit" në Bullgari, në bashkëpunim me alpin "Korabi" – Peshkopi kanë eksploruar dy shpella të pa studiuara më parë, ajo e Rusit në Çidhën dhe shpella ujore e Sopanikës në burimet e Setës.

Kjo ka qenë e katërta ekspeditë radhazi e speleologëve bullgarë - studiuesit e shpellave, - të drejtuara nga Aleksej Zhallov.

Zhellov, menjëherë pas kthimit në Bullgari, ka njoftuar "lajmin e mirë se në dy shpella është bërë përparim, dhe ata vazhdojnë në gjatësi dhe thellësi".

Por lajmi që mund të konsiderohet si "skup" gjatë kësaj vere të nxehtë është se në shpellën e Rusit, përveç stalaktiteve, stalagmiteve janë gjetur edhe xhevahire.

"Shpella e Rusit është një humnerë vertikale, thotë Zhellov për radion Bullgare BNR. Në ekspeditën e mëparshme që u zhvillua në vitin 2013, ne arritëm vetëm 60 metra në thellësi, ndërsa këtë vit ne kemi arritur deri në 200 metra dhe akoma fundi i shpellës nuk shihet. U bë e qartë se në disa sektorë kjo shpellë është shumë e gjerë dhe e pasur atje ka stalaktite, stalagmite, xhevahire – gjithçka që mund të shihet nën tokë. Është një shpellë shumë e bukur", thekson speleologu bullgar.

"Në Sopanikë situata ishte më e vështirë – pak pas fillimit të punës arritëm një vend plot ujë. Ne, speleologët i quajmë këto galeri "sifone". Gjetëm mundësi të hynim përsëri në shpellë përmes një hyrje tjetër dhe kësaj radhe ecëm kundër rrymës, por pasi kaluam 20-30 metra përsëri arritëm një sifon tjetër. Në grup kishim një zhytës, i cili vazhdoi më tej, por pas akoma 30 metrash u bë e qartë se nuk mund të vazhdohej më tej. Gjithçka është hartografuar. Zoologu ynë mori shumë prova nga shpellat dhe po presim rezultatet e analizave", shkruan gazetarja e radios bullgare Jordanka Ivanova duke cituar Zhellev.

"Shpella e Rusit, në disa sektorë është shumë e gjerë dhe e pasur. Atje ka stalaktite, stalagmite, xhevahire – gjithçka që mund të shihet nën tokë. Është një shpellë shumë e bukur".



"Pa miqtë tanë shqiptarë nuk do të mundeshim të organizonim këtë udhëtim – këta janë njerëzit nga klubi speleo-alpin "Korabi" – Peshkopi, me udhëheqës Kujdes Haka. Ai dhe biri i tij Gentian na ndihmuan akoma në fazën e përgatitjes së ekspeditës dhe gjatë tërë kohës, kur ishim në Shqipëri ishin pranë nesh – tregoi Aleksej Zhallov.


"Njerëzit nga fshati Çidhën gjithashtu ishin të mrekullueshëm dhe bënë kështu, që të ndiheshim sikur të ishim në shtëpinë tonë. U ndamë me premtime se do të kthehemi përsëri. Krijuam miqësi të reja dhe kjo për mua është më e rëndësishmja. Për këtë e dua Shqipërinë – për njerëzit e mirë. Isha atje me kolegë të rinj, të cilët vizituan Shqipërinë për herë të parë. Dhe mendoj se ky me siguri nuk do të mbetet udhëtimi i tyre i fundit atje", thotë Zhallov për radion bullgare BNR.

Ai është një speleolog i njohur në Bullgari dhe vitin e fundit ka botuar edhe librin "Studimet speleologjike bullgare në Shqipëri 1991-2013" në gjuhën angleze. Zhallov është kryetar i Bashkimit Ballkanik të Speleologëve, ish zëvendës sekretar i Federatës Evropiane të Speleologjisë, anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Shpellave dhe

(Vijon në faqen 24)




Të gjitha fotot në këtë faqe janë pamje të brendshme të shpellës së Rusit. Foto: Hristo Canev (FB)



Thuhet se nëpër Qafën e Xharxhishtit ka kaluar rruga e Skënderbeut që lidhte Lurën me Steelushin. Ajo ka sipërfaqe të vogël dhe një pozicion zotërues dhe shumë të mbrojtur nga natyra, në kontroll të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve dytësore që e lidhnin këtë zonë me Lurën (qytetin mesjetar të Livadhit të Xharrit), kalanë e Stelushit (Qafë-Murrë) dhe atë të Gurit të Bardhë (Petralbës) në Mat.

Vrojtime arkeologjike në zonën e Lurës

Nga **Prof. dr. ADEM BUNGURI**


Kullë karakteristike në Lurë

(Vijon nga numri i kaluar)

Ajo ndodhet në një terren të pjerrët, përveç pjesës veriore, ku hapet një tarracë e gjërë, e përshtatshme për banim. Kalaja ka qenë e fortifikuar me mure,që ruhen në disa pjesë të saj. Sipërfaqja e rethuar është e vogël, 0.4 - 0. 5 ha. Murri ruhet në trajtë të një ledhi gurësh, në anën perëndimore dhe atë lindore, me gjërësi 1.30-1.50 m dhe lartësi maximale 1 m. Më i plotë ai paraqitet në anën veriore, ku ruhet një segment i pashkëputur i tij, me gjatësi 25.20 m, lartësi të faqes së jashtme 2 m dhe të faqes së brendshme 0.40 –0.50 m. Ky mur mund të shihet mirë vetëm në faqen e jashtme, pasi faqja e brendshme,është e mbushur nga rrjedhjet errozive të terrenit.. Ai është ndërtuar me gurë të mëdhenj e mesatar të terrenit, të palatuar dhe të lidhur në të thatë. Muri përbëhet nga dy këmisha anësore dhe bërthama midis tyre, e mbushur me gurë të vegjël. Pranë hyrjes, që gjendet në anën verilindore, gjërësia e murit të mësipërm arin në 2.50 m. Brenda mureve kemi gjetur vetëm një paret ene me ngjyrë kafe, shumë të konsumuar, me fakturë prehistorike. Megjithë shpëlarjen dhe errozionin e shtresës së sipërme të depozitimeve, mungesa e gjetjeve, e cilëson këtë kala më tepër si një stan baritor ose si një rezidencë të përkohshme në situata të trazuara të kësaj periudhe se sa një vendbanim të mirëfilltë sedentar.

II. PERIUDHA E VONË ANTIKE (SHEK. V-VI PAS KR)

1. Kalaja Tytyrës (02.06.83)

Ndodhet në një luginë të bukur të njohur me emrin Tityrë rreth 1 km në veri të pllajës së Lan-Lurës, në rugën që lidh Lurën me Ndërshenën (Nënqytetin) dhe më tej me Reçin në lartësinë mbidetare 1445m. Lugina me orientim veri-jug, kufizihet në të dy anët nga male të lartë e të pakalueshëm, Maja e Madhe në lindje, me shesh pamje mi të gjithë pellgun e Drinit të Zi dhe maja e Bakullimës në perëndim. Të dy këto vargje malorë në jug ulen për të formuar qafën e Lan-Lurës (1500 m), ndërsa në veri mbyllen gradualisht në grykën luginore të Ndërshenës.

Rrënojat e kalasë gjenden në një kodër konike në anën lindore të kësaj lugine, të quajtur edhe si kodra e kalasë. Linja e plotë e murrit nuk duket, por ndiqet nga konfigurimi i terrenit. Murret rrethonin një sipërfaqe rreth 0.5 ha. Ato kanë qenë të ndërtuara me gurë të papunuar të terrenit të lidhur me llaç të dobët gëlqerorë. Shumica e gurëve janë shembur në pjerrësitë e faqeve të kodrës së kalasë. Gjatë kontrollit sipërfaqësor nuk gjetëm asnjë fragment qeramike, që duket se se janë shpëlarë nga errozioni. Megjithatë, ruajtja e pandryshuar e emrit *Tityrë*, ashtu siç përmendet në burimet historike (*Tythyrë*), e identifikon kështjellën e rindërtuar këtu nga Justiniani[7]. Ndërtimi i një kështjelle të tillë në një zonë kaq të thellë, dëshmon se këndej ka kaluar një rrugë e rëndësishme që lidhte pellgun e Dibrës me Lurën dhe më tej me viset piruste (Mirditën) e ato labeate (Lezhë- Shkodër).

2. Qyteza e Murrizit (Arrënmallë)

Rrënojat e kësaj qyteze ndodhen në një kreshtë shkëmbore, të njohur me emrin " *Kepi i Gjytetit "*, në krahun e majtë të kanionit të Zgjorgjës në fshatin Arrënmallë. Kodra ka kontroll të plotë mbi të gjithë luginën e Mallës, nga Pregjë-Lura në jug deri në Vlashaj-Lurë në perëndim dhe Gjur-Reç në veri, dhe kontrollonte rrugën e fshehtë dhe të shkurtër që lidhte Lurën me Reçin dhe më tej me pellgun Bicaj-Kukës. Kreshta shkëmbore ku ruhen gjurmë fortifikimi, ka sipërfaqe të vogël rreth 0.1 ha dhe vegjetacion shkurresh shkoze. Murret duket se kanë qenë të ndërtuar me llaç gëlqerorë, sipas teknikës *opus incertum*. Ata mungojnë në anën veriore, që mbrohet nga rënjet e thikta mbi kanionin e përroit të Zgjorgjës, por gjurmët e tyre me vështërsi gjenden edhe në anët e tjera, pasi janë shembur dhe mbuluar nga shkurret. Llaçi është i cilësisë së dobët dhe i shkriftueshëm dhe është përzier me rërë lumi me përmbajtje kokrrizash mesatare e të mëdha. Megjithëse nuk kemi gjetur fragmente enësh, në këtë kala, në fundin e viteve 70' janë gjetur rastësisht 13 nummia (monedha me vlerë të plotë) bronzi të *Justinit II* (565-578), një të Justinit I dhe një monedhë të Justinianit (527-565)[8], që datojnë kohën e përdorimit të saj, në mos atë të ndërtimit. Për përmasat e vogla, cilësinë e dobët të llaçit, si dhe pozicionin e saj në skalionin e dytë të vijës së mbrojtjes, mendojmë se është ndërtuar nga popullsia lokale për vetëmbrojtje, ndoshta dhe me donacione perandorake.

3. Qyreza e Borie Lurës

Njihet edhe me emrin "Maja e Qytezës" Ndodhet në një kodër shkëmbore konike në fshatin Borie-Lurë, përballë qytetit të Livadhit të Xharrit", në një pozitë dominante. Nga sipërfaqja e saj mund të kontrollohet e gjithë lugina glaciale e Borie Lurës dhe që rrugët që kalojnë nëpër këtë luginë që lidhin Lurën me Stelushin dhe Matin. Nuk ruhen as gjurmë të murit rrethues dhe as fragmente enësh. Datimi në periudhën e vonë antike është vetëm hipotetik.

III. PERIUDHA MESJETARE PARAOSMANE DHE PERIUDHA E SKËNDERBEUT (SHEK. XI-XV)

1. Qyteti i Livadhit të Xharrit (Borie-Lurë) (01. 06. 1983 dhe 23.06. 1988)

Ky vendbanim i quajtur "qytet", gjendet rreth 2 km në jug të Fushë Lurës, në afërsi të fshatit Borie-Lurë, në lartësinë mbidetare mbi 1238m. Ai shtrihet në një sipërfaqe mbi 10 ha, në një syprinë me pjerrësi të lehtë lindore, që kufizohet nga faqja lindore e Nezhdës së Lurës në perëndim dhe përroi Malla e Lurës në lindje. Nga veriu lugina zgjerohet për tu bashkuar me govatën glaciale të Lurës, ndërsa nga jugu ajo mbyllet nga rënja shkëmbore e qafës së Bulshe, mbi fshatin Gur-Lurë. Në perëndim lartësohen malet e Nezhdës dhe të Kunorës (me 9 liqenet e njohur glacialë) plot me pisha, në kontrast me Runjën e zhveshur në lindje. Sipërfaqja e vendbanimit është e lirë nga vegjetacioni, përveç disa pishave dhe shkurreve të rralla. Mbi të ruhen rrënoja të murreve të dikurshme mbrojtëse dhe të banesave të shumta. Me këtë topografi shihet se vendbanimi ka një pozitë të mbrojtur natyrore nga tri anë, përveç anës së hapur veriore të tij, që e lidh atë me viset fqinje. Sipërfaqja e vendbanimit është e lirë nga vegjetacioni, përveç disa pishave dhe shkurreve të rralla. Mbi të ruhen rrënoja të murreve të dikurshme mbrojtëse dhe të banesave të shumta.

Vendbanimi ka qenë fortifikuar nga një murr rrethues i vendosur në anën veriore më të ekspozuar të tij. Ai ka gjatësi rreth 300 m, gjërësi 2.80-2.90m dhe lartësi 1.10-1.20 m. Është ndërtuar me gurë të mëdhenj e mesatarë, me lidhje të thatë. Rrethimi synonte mbrojtjen e shtegut të vetëm që e lidhte atë me Lurën dhe më tej me luginën e Fanit, prej nga mund të vinin sulmet eventuale. Brenda këtyre murreve gjenden një numër i madh banesash, të grupuara dhe të ndara në "lagje", nga disa rrugë tërthore në trajtë koridoresh të drejta me gjërësi 3-5 m. Muret e banesave kanë gjërësi 0.80-0.90 m dhe ato të tarracimit 1.30-1.40m, janë të ndërtuara me gurë mesatarë e të vegjël, me lidhje të thatë. Banesat kanë planimetri katërkëndëshe dhe disa prej tyre, përmasa të brendshme 10 x 5.00 m, 9.50 x 5.50 m etj.

Në pjesën qëndrore të këtij qyteti, një çukë e ngritur në trajtë tume, thiret *" Çuka e Pashës"*, toponim i lidhur me periudhën osmane. Në jug të kësaj çuke, rruhen gjurmët e një rruge mesjetare të shtruar me kalldrëm, nga kalonte rruga që të çonte në Fushën e Pelave[9]. Në afërsi të Çukut të Pashës, pranë themeleve të një banese mesjetare apo kulle vrojtimi, gjatë vizitës sonë të qershorit 1988[10], në tokën e punuar, mundëm të gjejmë për të parën herë disa fragmente enësh. Është fjala për disa parete vorbash mesjetare, me vegjë shiritore të zbukuruara me shpime thike, kronologjikisht të lidhura me shek. XII-XIV. Aty u gjetën gjithashtu edhe shumë pjesë zgjyre hekuri, të lidhura me veprimtarinë metalurgjike të punimit të hekurit në periudhën mesjetare[11].

Qyteti braktiset pas vdekjes së Skënderbeut dhe banorët emigrojnë në Kalabri[12].

Në jug të vendbanimit, përtej përroit të Mallës, gjendet nekropoli i qytetit. Gjithashtu në pjesën jugore të qytetit, pranë përroit të Mallës, gjendet një bllok guri rënor, me formë drejtkëndëshe, me përmasa 1.20x0.30 x0.30m, i zbuluar nga dr. S. Prifti, që ruante gjurmët e një "mbishkrimi", të cilin ai e mendonte si etrusk[13]. Lajmi ishte vërtetë intrigues. Kjo pllakë guri ishte shikuar para nesh nga prof. S. Anamali dhe prof. H. Spahiu që në vitin 1977, dhe është konsideruar prej tyre si gur i zgavruar nga erozioni natyror[14]. Nga raporti i përgatitur me këtë rast, mësojmë se ishte fjala për një bllok masiv serpentinor me përmasa 1.30 x 0.80 x 0.30-0.50m, gjysëm i futur në përruan pranë tij. Shenjat e inçizuara në tri reshta paralelë, 8 në rreshtin I, 17 në rreshtin II dhe 14 në rreshtun III, nuk janë shkronja, por vija vertikale me lartësi e thellësi të ndryshme, të formuara nga veprimtaria e agjentëve atmosferikë[15].

Me kurreshtjen që të ngjall një fakt i tillë, gjatë vrojtimit të faqes së sheshtë të kësaj pllake, mundëm të dallojmë tri radhë shkronjash, të ngjashme me germat ***"h, k, f",*** të konsideruara si "etruske" nga studiuesi i lartpërmendur. Në nivelin e sotëm të srudimeve mbetet e hapur çështja në se ai duhet konsideruar apo jo një mbishkrim i mirëfilltë, qoftë ai edhe etrusk, sqarimi i të cilës do të ishte me shumë rëndësi për jetën dhe trashëgiminë e këtij vendbanimi të madh dhe të rëndësishëm mesjetar.

2. Vendbanimi mesjetar në TROJE (Krej-Lure) (3 qershor 1983)

Ne skajin veriperendimor te Krej-Lures, rrëzë malit te Frashërit[16] të malit të Gurit të Kuq, nen majen e Buzës, në vendin e quajtur "Lugu i shpellës" dhe Troje,gjenden rrenojat e nje fshati mesjetar.Me emrin Troje theritet një pllajë me pjerresi te lehtë jugore (rreth 30º) dhe siperfaqe rreth 5 ha dhe me kuotë relative pak me te larte. Nga veriu ajo kufizohet me malin e Frasherit,nga jugu me rrugen Krej-Lure-Merkurth dhe me tej me malin e Ciplit,nga lindja me Krej-Luren dhe nga perendimi me Merkurthin

Rrenojat perfaqesohen nga nje numer i konsiderueshem banesah dhe kthinash me planimetri drejtkendeshe. Lartësia e ruajtjes së mureve ne anen e jashtme eshte 0.70m,ndersa ne ate te brendshme arin deri ne 1m (nga pjerresia e terrrenit),ndersa gjeresia e tyre eshte 1m. Muret kane qene te ndertuara me gure mesatare te lidhura me llaç argjilor.

Permasat e brendshme të një banese janë 9.70x5.50m. Shumica e tyre janë të orientuara nga jugu, nga i kanë edhe hyrjet, ndërsa dritaret vendoseshin në anët e ngushta lindore dhe perëndimore. Përveç banesave, lexohen qartë edhe rrugët e drejta midis tyre. Në Troje ekzistojne dy rrugë paralele, me gjërësi 3m, të kufizuar nga murre guresh. Distanca midis dy rrugeve të tilla eshte 35-40m, ndërsa gjatesia e lexueshme e tyre eshte perkatesisht 100 dhe 150m. Ato kanë drejtim veri-jug dhe e përshkojnë të gjithë pllajen deri në rrëzën e saj. Muret kufizuese, me gjeresi 1m, kane qene te ndertuara me gure mesatare te lidhur me balte. Rrenojat e banesave gjenden te grupuara ne trajte te lagjeve, ne lindje te rruges se I, ne perendim te rruges II, si dhe tek Lugu i shpellës. Interesante është sistemi gati ortogonal i rrugëve, që i japin ketij vendbanimi, tiparet e një qendre të organizuar mbi bazë "insulash" hipodamike.

Ne skajin perendimor te Trojeve, mbi nje kodrine te quajtur "Kishëza" ndodhen rrenojat

Rrënojat e banesave janë të shumta. Muret e tyre kane qenë ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël të lidhur me llaç argjilor. Lartësia më e madhe e ruajtur e tyre arrin në 0.70m. Ato përfaqësojnë dy tipa planimetrikë: me planimetri katërkëndëshe dhe ovale. Pajisja me mur rrethimi vetëm në anën jugore, dëshmon se kjo ishte dhe zona më e rrezikuar e vendbanimit, gjë që përputhet edhe me topografinë e tij, pasi këtej kalon rruga e vetme që e lidh atë me Krej-Lurën dhe aksin Lurë-Mirditë.

e nje kishe te vogël. Ndërkaq, në jug të Trojeve, në një vend plot shkurre, tek "*Mrizi i thanave*", gjenden mbeturinat e një kroi, i quajtur *„Kroi i Dese „*. Të dy keto elemente plotësojnë skemën planimetrike të një fshati mesjetar. Material të imët arkeologjik në sipërfaqe nuk gjetëm. Sipas gojdhënës[17], popullësia e këtij fshati pas vdekjes së Skenderbeut, është vendosur në fshatin Piran i Vogël të Prizrenit (Kosovë).

3. Vendbanimi mesjetar në KOLDOÇE (Vlashaj-Lurë) (3 qershor 1983)

Rreth 1 km në veri të fshatit Vlashaj-Lurë, në këmbët e malit të Gurit të Kuq, një livadh me sipërfaqe të pjerrët i orientuar nga lindja dhe i veshur me pisha dhe qarr, njihet me emrin Kolë-Doçe. Në qendër të tij, në një sipërfaqe rreth 2ha, gjenden rrënoja murresh e banesash. Ajo që bie menjëherë në sy eshtë pajisja e këtij vendbanimi me një mur mbrojtës në anën jugore. Ky mur me gjatësi 80-100m dhe gjërësi 1m është ndërtuar me gurë të papunuar të lidhur me llaç argjilor, të shpëlarë nga shirat. Lartësia maksimale e ruajtjes së tij është rreth 1m. Në tri anët e tjera të vendbanimit, nuk u konstatua asnjë gjurmë muri mbrojtës

Rrënojat e banesave janë të shumta. Muret e tyre kane qenë ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël të lidhur me llaç argjilor. Lartësia më e madhe e ruajtur e tyre arin në 0.70m. Ato përfaqësojnë dy tipa planimetrikë: me planimetri katërkëndëshe dhe ovale. Pajisja me mur rrethimi vetëm në anën jugore, dëshmon se kjo ishte dhe zona më e rezikuar e vendbanimit, gjë që përputhet edhe me topografinë e tij, pasi këtej kalon rruga e vetme që e lidh atë me Krej-Lurën dhe aksin Lurë-Mirditë. Në aspektin planimetrik dhe të teknikes ndërtimore, është krejt i ngjashëm me vendbanimin mesjetar te Livadhit të Xharrit (Borie-Lurë) dhe duket se i takon të njëjtës periudhë. Sipas gojdhënës, ky fshat është braktisur pas vdekjes se Skënderbeut.

4.Fusha e Pelave

Fusha e Pelave përfaqëson në fushë të madhe ndërmalore, me bukuri të pashoqe në trajtën e një amfiteatri natyror, e veshur me livadhe alpine dhe e rrethuar me pyje pishe, rreth 1.5km në JP të Liqenit të Luleve, në lartësinë mbidetare 1600m. Arkeologu D. Komata informon se aty ruheshin gjurmët e një kishe, tingujt e këmbanës së të cilës dëgjoheshin deri në qytetin e Dibrës. Sipas tij, këmbana peshonte 575 okë dhe përbëhej nga: 555 okë bakër, 10 okë kallaj dhe 10 okë alltan[18]. Pesë minuta pas këmbanës së Fushës së Pelave, binte këmbana e Gurrës së Madhe (Mat) dhe këmbana e kishës së Shën Kollit të kalasë së Grazhdanit (Maqellarë). Me tingujt e kësaj këmbane fillonte gara e kalorësve të Skënderbeut, i cili sipas legjendës, stërvisnin aty kuajt e ushtrisë së tij, prej nga ka ardhur edhe emri "Fusha e Pelave".

5. Murrest

Rreth 200-300 m në lindje të kalasë së Çezës në Ndërshenë, hapet një lëndinë e bukur alpine, në formën e një govate glaciale, e qarkuar nga disa kodrina të ulta, përtej të cilave dhe një qafe jo shumë të lartë, dilet në fushën e gjërë glaciale të njohur me emrin "Fusha e Bujanit". Pikërisht në të dy anët e kësaj lugine, të njohur nga banorët me emrin "Murrest", gjenden gjurmë të qarta banesash. Banesat kanë planimetri katrore, me përmasa 3.80 x 4.40 m, 4.20 x 4.00 m etj ,gjërësinë e mureve 0.80 –1.00 m, dhe lartësi 0.60 –0.85 m. Në pikëpamje kohore, "Murest" duket se përfaqëson një stan të periudhës mesjetare.

6. Kalaja e Skënderbeut

Kjo periudhë në plan arkeologjik është përfaqësuar nga kalaja e *Skënderbeut, ose e Sheut të Thatë* [19] në Xhaxhisht, midis Lurës dhe Çidhnës. Rrënojat e saj gjenden në një kreshtë shkëmbore me lartësi 1205 m, në thellësi të luginës së Setës, në faqen juglindore të malit të Xhaxhishtit, që lartësohet në perëndim të Çidhnës së Poshtme dhe kanionit të Gjalicave. Thuhet se nëpër Qafën e Xharxhishtit ka kaluar rruga e Skënderbeut që lidhte Lurën me Steelushin. Ajo ka sipërfaqe të vogël dhe një pozicion zotërues dhe shumë të mbrojtur nga natyra, në kontroll të Çidhnës së Poshtme dhe rrugëve dytësore që e lidhnin këtë zonë me Lurën (qytetin mesjetar të Livadhit të Xharrit), kalanë e Stelushit (Qafë-Murrë) dhe atë të Gurit të Bardhë (Petralbës) në Mat (Fig. 16). Shtegu i vetëm për të hyrë në kala kalon nëpër qafën e kalasë, në anën jugperëndimore të saj. Në pjesën më të lartë të kalasë duken gjurmët e një kulle rrethore. Trakte të shkëputur muresh mesjetare shihen vetëm në anën lindore dhe atë juglindore. Ata rethojnë një sipërfaqe rreth 500 m^2. Muri është ndërtuar me gurë mesatar e të vegjël, të lidhur me llaç të dobët gëlqeror, me gjatësi të përgjithshme 72 m dhe trashësi 1.50 m. Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është konstatuar edhe në kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Shurdhah (1.30-2.60 m), në Krujë (0.80-1.50 m) dhe Daulë të Krujës(0.75 m, 0.90 m, 1.10m, dhe 1.80m)[20], në Stelush dhe në Gur të Bardhë të Matit(1.50-1.80 m)[21], në Koxhaxhik të Dibrës(1.40-1.70 m)[22] etj. Në anën verilindore të kalasë, ruhet një sterë uji në trajtë katërkëndëshe, me brinjë 1.80 x 2.20 m, thellësi të matshme 2.90 m dhe vëllim mbi 11.484 m^3. Faqet e brendshme të saj kanë qenë të suvatuara me llaç shamot, i cili, edhe pse i shembur, ka lënë gjurmët e tij ngjyrë tulle mbi faqet e murit. Në sipërfaqen e kësaj kalaje janë gjetur edhe disa fragmente enësh të periudhës mesjetare, kryesisht vorba dhe tasa, me formë dhe dekor të ngjashëm me ato të kalasë së Stelushit, të Koxhaxhikut etj, të lidhura me shek. XIV-XV pas Kr.[23] Kjo kala shërbente si pikë vrojtimi dhe lajmërimi me anë sinjalesh dhe si vendstrehim në rast reziku.

[7] PROC. CAES. De Aedeficis, IV,4, 440.
[8] Monedhat janë gjetur e dorëzuar në Institutin e Arkeologjisë Tiranë nga z. Xh. Vladi dhe janë datuar nga H. Spahiu.
[9] Fusha e Pelave përfaqëson në fushë të madhe ndërmalore, me bukuri të pashoqe në Kunorën e Lurës (1600 m), në trajtën e një amfiteatri natyrorë, ku sipas legjendës, Skënderbeu stërviste kuajt e ushtrisë së tij .
[10] Gjatë kësaj vizite jemi shoqëruar nga studiuesi H. Kolgjegja dhe nxënësi i gjimnazit të Lurës D. Kaci, të cilët i falenderoj për ndihmën e dhënë.
[11] Legjenda thotë se " lurasit ishin farkëtarët e Skënderbeut " dhe se në këtë qytet punonin pa pushim farkëtarët e Skënderbeut, që shkrinin metal dhe farkëtonin armë për ushtrinë e tij. Në të vërtetë, pozicioni i mbrojtur strategjik i këtij vendbanimi, rezervat natyrore të hekurit pranë tij, si dhe gjetjet e shumta të zgjyrës, e justifikojnë një vlerësim të tillë.
[12] Gjatë viteve të Luftës II Botërore, oficerë italianë me origjinë arbëreshe, kishin ardhur në këtë qytet, me harta në duar "të shikojnë vendin e të parëve që kishin dalë prej aty ". Këtë e thonin të gjithë pleqtë e Lurës. Mua ma ka treguar z. Istref Kaci, që banonte pranë këtij qyteti, të cilin e falenderoj për informacionin.
[13] PRIFTI 1981, 56.
[14] ANAMALI-SPAHIU 1977, nr.inv. 3698.
[15] ANAMALI- SPAHIU 1977, nr. inv. 3698. Ekipi u shoqërua nga H. Lala, drejtor i Muzeeut historik të Dibrës, H. Bruçi, inspektor i kulturës së rrethit, H. Kolgjegja, përgjegjës i shtëpisë së kulturës në Lurë dhe dr. S. Prifti, autor i zbulimit.
[16] Mali i Frashërit quhet pjesa nga maja e Gurit të Kuq ne verilindje deri në qafën e Mërkurthit në jugperëndim.
[17] Falenderojmë udhërrëfyesin Ndue Bibë Doçi nga fshati Krej-Lurë.
[18] KOMATA, art.cit.
[19] Kalaja quhet ndryshe edhe kalaja e "Sheut të thatë "(e përroit të thatë). Emri "Sheu " ka kuptimin "përrua " dhe mbahet si fjalë mjaft e vjetër e leksikut të shqipes së kësaj zone. Toponime të tjera të lidhura me këtë kala janë : "Qafa e kalasë", "Arat e kalasë", "Gurra e Skënderbeut", "Rrafsha e topit" etj. Krhs. HOXHA 1979, 236; HOXHA 1989, 571.
[20] SPAHIU-KOMATA 1974, 263; ADHAMI 1971, 87; SARAÇI 1987, 205.
[21] Sipas vrojtimeve të autorit në terren.
[22] BUNGURI 2009, 31.
[23] ANAMALI 1967, 95-112; BUNGURI 2009, 34.



BALADA E DRINIT

Kërruesja e historisë...

Nga **DIONIS XHAFA**

Maqellarë, Dibër. Verë, 2013. Furgoni, me të cilin udhëtoja, po afrohej drejt vendit ku hodha hapat e parë, ku u rrita. Përmes dritareve të furgonit, shihja "tërbimin" e Drinit të Zi, që në fakt të tillë ka emrin, pasi në të vërtetë është i gjelbërt, në pamje të parë. Zbres nga furgoni, e shoh tej tutje vargmalet e Korabit, një majë, që në fëmijëri më dukesh si një kokë majmunit, sepse e atillë ish në formë ajo kreshtë. Ajo luginë, për një moment më ktheu në libra të historisë, më dukesh se përfaqësonte vetë historinë e kësaj toke, qysh prej kohës së lavdishme të Skëndërbeut, deri në luftimet me serbët në Luftrat Ballkanike, në kufirin e sotëm, që ndan dy Dibrat.

Prej largësie mundesha me dallu' fushat e Maqellarës, të Gjoricës, e më shkonte ndërmend se aty ishin luftu me serbë e turqë, m'u nj'aty ish shkru vetë historia.

Ata fusha më dukeshin se krejt si të gjakosuna, sikur bari kishte mbi prej gjakut të derdhun për këtë tokë.

E, më tej më shkonte ndërmend se atje në Vajkal, në Koxhaxhik, atyne fushave, Skëndërbeu si luan me ushtri të vet kish mbrojt Arbninë.

E, atje ku kish valu flamur i Kastriotëve, diell i fortë pingul, binte fushës së gjanë.

E, prej këtu, në urë të Topojanit, zbres tëposhtë, në një udhë me guraleca, buzë Drinit të Zi, tu e ecë e tue vëzhgu, vendin tim, të të afërmve të mi, këtë tokë, të nipave të Kastriotëve.

E, tue shkel, po mendojsha se luftëra, beteja e ballafaqime ishin ba në atë tokë, në atë vend që po e shkelsha.

KËRRUESJA E HISTORISË

Tue ecë menueshëm buzë dallgëve të Drinit të Zi, në atë vapë zhegu, që shoqërueme me ni kangë gjinkallash në sfond, ta ndriçojshin shpirtin prej së kaluemes, e ta fikshin prej së tashmes.

E, bash atje në arrë, ni burrë në moshë të mësme, po punonte arrën, me shat, zhytun kokë e këmbë në llucë, me çizme, i lagun krejt në djersë.

E, kohët krejt qenkan rrokullis. Bosht i tokës më duk se lëvizi. Këta nipa të Skandërbegut, q'i si shqiponjë mbrojshin vend e vet, q'i me shpata të zhveshuna kishin prit serbë e turqë e hordhi të huej, sot kërruesun në arra të veta, të lanë të harruem, të varfnuen.

Arbnia historike, zemra e shqyptarisë, zani i tokës së maleve të randa, veç pluhurosun në libra të historisë mujshe me e gjet e se Dibra, qendër e rezistencës, sot asht e kërrusun, e dibranët, në shumicë të rranum.

Ai mal i naltë i krekosun mbi valë të Drinit të Zi, , ata kështjella, ata rrënoja veçse të shkumen e pasqyronin.

E, dibranët, që qenë shtyllë e Arbnisë kreshnike, që në dorë të kurrkujt s'dëgjoi me ra, sot jetojnë në kohën e ekonomisë, në kohët e skllavërimit modern e në të shumtë, të vuajtën, prej varfniet, prej trishtimit.

Dibra e Arbnisë, që si kockë e flamur ballë për ballë flakë iu gjegj krajlave të Servisë e sulltaneve të Stambollet të Turknisë, sot asht' gërthye e pushtue nga një armik, që të gërryen ngadalë, q'i quhet varfni.

E, nj'ashtu, njëlloj thirren, dibranë, këta këtej nga Peshkopia, e ata andej nga Dibër e Madhe, të ndanum në dy shtete, e njani dibran i gjegjet qeverisë së Tiranës e tjetri qeverisë së Shkupit.

Si këta, të qeverisun prej Tirane, si ata prej Shkupit, të lëna me ni shteg, mënjanë, në cep të secilit të shtet.

Kush e kush ka mujt' me u kap prej Amerike, Gjermanie, Italie, Greqie e gjithëçfarë shteteve të huaja perëndimore, se shteteve të veta, hajrin hiç s'po ua shofin.

E, ata të qytetit të lavdishëm, që në qendër e kanë Skandërbegun, si statuje e vetmume, që e luftun brez pas brezi atë Belgrade, si hije të zezë e kanë tash kësaj kohe.

Kjo, se Nikola, kryeministri, veç politika sllave po ndjek, edhe se ata shqiptarë që përfaqësojnë shqiptarët, vetëm shqipen e flasin, se krejt Maqedonia politikë sllave e ruse po ndjek.

E, ai mal fortesë e dikurshme, ngjet i çanum prej realitetit të ashpër.

Lugina e shndërritun prej historisë së lavdishme, e lagun me gjak, sot në fushë të saj dëgjohet shati q'i hap vijat e arrave e në pyje të saj kërcet spata, për me hangër bukën e përditshme.

Ah, ç'vaj! Ç'dhimbë! Medaljonët e kohës moderne, ja këta janë: Buka, paraja!

Lugina, fusha, mali, kanë dhimbë e mbulohen veç me terr, që si hije e zezë bjen kudo, sidomos mbi ata q'i vuejnë.

Në këtë fushë, në këtë luginë, krajl, mbretën e sulltanë ishin luftu.

Sot, shati ban zhurmë, në atë arrë, ku nigjohet kanga e gjinkallave.

Shati e spata bajnë zhurmë, nëpër Luginë të Drinit të Zi, e po dojnë me luftue... varfninë!

** Gazetar i Albeu.com*

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 2000 fjalë (12000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- **Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.**
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail **<rrugaearberit@gmail.com>**, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- **Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.**

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>**

Redaksia.

Libri më i ri i Zyber Gjonit, që mban titullin "Çidhnakë në shekuj", është një kontribut për historinë e Dibrës, mbasi ai, ndonëse kalimthi, prek disa nga figurat më në zë të popullit të kësaj krahine, duke i dhënë mundësi çdo lexuesi, hulumtuesi, studiuesi, që të informohet ose të gjejë lëndën e nevojshme për ndonjë trajtim më të ri ose më të thelluar

"Çidhnakët në shekuj", një libër me vlerë për historinë e krahinës së Çidhnës

Nga **XHAFER MARTINI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Nëse libri do të kishte këtë strukturë, figurat nuk do të dilnin të veçuara, por të të lidhura me njera-tjetrën si për nga origjina ashtu edhe nga veprimtaria, do të dilnin edhe si vazhdimësi brezash, ku një brez ia lë stafetën brezit tjetër, por për një kohë tjetër, ku shtrohen probleme dhe detyra të reja në përputhje me të cilat duhet një sjellje e re politike. Po të veprohej në këtë mënyrë, në bazë të koncepteve më të gjëra, shkrimi për Murat Kaloshin nuk do të fillohej me një frazë të tillë "Murat Kaloshi, me kthimin e serbëve në Dibër në vitin 1918 u afrua me ta, por në mars të vitit 1919 hidhet kundër tyre"(f.170) Murat Kaloshi duhej vështruar si pasardhës i Derës së Madhe të Kaloshëve, si përfaqësues i atij brezi Kaloshësh që duhej të manovronte në kushte dhe rrethana të reja historike, që kishte të bënte jo me një pushtues tolerant dhe me mendësi perandorake si Turqia, por me një pushtues të egër, në kufi, me mendësi asimiluese për racën e shqiptarëve, siç ishin serbët. Pra, ishte e natyrshme që ai të jepte edhe shenja afrimi dhe kompromisi historik. Përfaqësuesit e Dyerve të Mëdha kishin një përgjegjësi të dyfishtë: ata nuk kishin të drejtë, por as edhe përfitim të shkëputeshin prej popullit të vet dhe të bashkoheshin me armikun, se ky populli ishte baza e tyre, por as nuk mund të bënin veprime aventureske për ta lëshuar tërbimin e armikut të egër mbi kokë të popullit për pak e për shumë. Prandaj ata duhen gjykuar në kohë, në përputhje me rrethanat që ishin krijuar, duke i krahasuar me njeri-tjetrin, brezin me brez, jo vetëm për nga detyrat atdhetare, por edhe nga vetitë dhe cilësitë ndividuale. Edhe kur i përkisin një dere, edhe pse mund të ishin babë e bir, ndryshonin shumë nga njeri-tjetri.

Po kështu dy hoxhallarët, megjithëse të ndryshëm nga njeri-tjetri, janë përfaqësuesit e klerit mysliman, kanë rolin dhe misionin e tyre në histori që ka qenë ai i çlirimit të vendit nga pushtuesit osmanë. Misioni i tyre në këtë luftë ishte shpirtëror, kishte të bënte me ndriçimin e mendjes së popullit, prandaj të kemi kujdes kur japim hoxhallarët me kobure se arma e tyre ka qenë tjetër gjë-iluminizmi. Populli i ka përjashtuar ata nga gjakmarrja, prandaj nuk mbanin armë. Kjo do të thoshte që populli e shikonte dhe e kuptonte misionin e tyre dritëpërhapës. Studiuesi duhet ta kuptojë më mirë se populli. Në atë kohë Shqipëria nuk kishte intelektualë. Ata pak që kishte, jetonin jashtë saj. Të vetmit intelektualë brenda Shqipërisë ishin klerikët, pavarësisht cilës fe i përkisnin. Armët e tyre ishin abetarja, shkronjat shqipe, gjuha dhe kultura shqipe. Unë kam shkruar për Hoxhë Kallën tek libri "Gjenerali me shajak" (2012) dhe tek libri "Tempulli i dashurisë" (2014). Ata që janë kuriozë le ta lexojnë se si e kam paraqitur figurën e tij. Ai hapi Shkollën e Fjalëve, ku mësohej pa libra, pa fletore, pa asnjë mjet mësimor.Në këtë lloj shkolle mësuesi, në rastin konkret Hoxha, ishte figura qëndrore e një shkolle femërore që ka funksionuar shumë mirë. Nëse ndonjëri nuk beson se ka edhe Shkollë të Fjalëve, le të mësojnë se filozofi dhe mendimtar i madh Osho jep mësim në disa universitete vetëm me anë të fjalëve, pa shkrim, pa lexim. Është mendimtari më madh pa shkollë.

Disa nga figurat që janë trajtuar nga autori, janë minore dhe janë ngritur në bazë të kujtimeve të njerëzve. Nuk është mirë t'i bëhet vend secilit në histori pse ka marrë pjesë në një kryengritje. Gjithë populli ka luftuar.Sofra e historisë është e ngushtë dhe nuk ka vend për të gjithë:

"Në sofrën e shtruar të historisë
Presin të marrin lugën të gjithë.
Vështrojnë thelat dhe duan të hanë
Kurnacë, grykës, batakçinj, pehlivanë.
Po historia u jep nga një kafe në këmbë
dhe thotë e përmbajtur diçka nëpër dhëmbë:
Më falni, se presin në sofër të vinë
Ata që bëjnë vërtet historinë" (Dritëro Agolli: "Pelegrini i vonuar", Tiranë 1993) (Sofra e historisë)

Por në libër kemi edhe figura episodike, por të merituara, si: Osman Paci, Hasan Shini, Çup Bitri. Kështu, si shembull, Osman Paci jepet në një moment të jetës së tij, kur ai kreu aktin heroik, duke mbetur mbi top të armikut, veprim shumë i guximshëm që u dha guxim atyre që luftonin përkrah tij dhe vetëm në saj të këtij heroizmi u mor një kodër dominuese, me hendeqe dhe vepra të tjera mbrojtëse, me dy sira tela me gjemba, ku edhe zogu nuk mund të kalonte. Por ja që e kaloi Osman Paci. Ky heroizëm nuk mud të kryhej nga një njeri dosido. Nuk mud të tregosh akt heroizmi nëse nuk ke qenë heroik gjithë jetën, nëse atë heroizëm që ti e shfaq në një çast të caktuar nuk e ke pasë përbrenda në shpirt dhe në zemër. Ai nuk vjen nga jashtë, është aty dhe do të shfaqet kur të vijë momenti. Kështu është edhe akti i Hasan Shinit, një akt individual trimërie, për që ka rrënjë të thella dhe vetëm pret të përshfaqet në situata të caktura. Mua më vjen mirë që autori di t'i japë këto figura episodike pikërisht nëpërmjet episodeve.

Figurat e dorës së parë janë sjellë në vepër përmes shumë dokumenteve, shumë referimeve. Kjo është një gjë e mirë se historia operon përmes dokumenteve, por asnjë dokument nuk e përjashton logjikën, njerëzoren. Njerëz, si: Salë Demiri, Selman Alia, Llan Kaloshi, Murat Kaloshi e ndonjë tjetër nuk duhet të denigrohen nga ndonjë e dhënë që nuk duhet marrë seriozisht edhe pse është shkruar më ndonjë libër. Për Salë Demir Alinë, një figurë interesante, autori i referohet disa herë Munir Shehut dhe çka thotë ai e merr si të vërtetë absolute, pa e vënë aspak në dyshim:"Për mosmarrjen pesë në luftë kundër Hajredin Pashës, Abaz Pira mori si shpërblim Zbinecin, Salë Demiri e Sheh Ramadani morën para në dorë. Salë Demiri i mori paratë nga Hasan beg Karahasani; ndërsa sheh Rrahmani i Bulqizës i mori nga Salë Markja" (f. 99). Kujti referohet Munir Shehu? Çfarë dokumenti sjell që ne t'i besojmë për atë që shkruan? Mos vallë gjithçka që shkruhet duhet marrë si e vërtetë?

Me shumë interes është figura e Llan Kaloshit. Autori ka pasë shumë material nëpër duar kur i është futur trajtimit të kësaj figure, por konceptimi është i mangët. Ja si shkruan autori për Llan Kaloshin "Pa frikë barabitet me Robin Hudin e Anglisë". (f. 126) Kjo nuk është e vërtetë. Robin Hudi ishte një kaçak i famshëm, me ëndërrën për drejtësi individuale, në fillim, që dalëngadalë kthehet në dëshirën për drejtësi shoqërore dhe përfundon me idealin e lirisë në zemër. Llan Kaloshi ishte krejt tjetër: ishte i formuar si atdhetar qysh në rininë e tij. Ishte i biri i Ibrahim Kaloshit, edhe ai atdhetar i shquar. Llan Kaloshi si karakter ishte krejt tjetër. Ishte njeri i urtë, i qetë, i parrëmbyer. Nuk e bëri Qabeja të tillë; pse ishte i tillë, ndeju nevojën të shkonte në Qabe dhe të bëhej Haxhi. Kishte marrëdhënie shumë të mira me gruan, Nije Murrja, që ishin unikale në malësorët e asaj kohe. Ishte njeri me botë të pasur shpirtërore, njeri që besonte shumë dhe falte shumë, i epshëm shpirtërisht. Megjithëse i vëllai, Halili, i vrau tre djemtë në një çast, Llani i zgjati dorën e pajtimit. Uragan i papërmbajtur, si Robin Hudi, ishte djali i tij Hasani. Edhe Murati, i biri i Hasanit, ishte i vrullshëm, spontan, që frenohej me vështirësi. Është shumë mirë që figurat historike t'i karakterizojmë edhe si njerëz, me vetitë dhe cilësitë që i shfaqin më tepër dhe që formonin personalitetin e tyre, por kjo bëhet mbi bazën e një njohjeje të thellë dhe jo nëpërmjet frazave që na vinë në mendje kur shkruajmë për to.



Gjëja më pozitive në këtë libër është se ka mjaft referenca. Për këtë autori duhet përgëzuar. Rrallë herë e thotë një gjë pa treguar se ku është mbështetur për ta thënë. Ai u referohet edhe librave dhe autorëve minorë, por ama u referohet. Ka ndonjë rast kur ndonjë pjesë e tekstit konsiderohet si referencë, por në fakt nuk është e tillë.

Mund të bëjmë edhe vërejtje të tjera të kësaj natyre, por e përgjithshmja është se libri ka pasuri dokumentare. Dokumente janë edhe kujtimet e njerëzve kur janë mbledhur në bazë të rregullave dhe kur arshivohen në muze po në bazë të rregullave. Megjithatë, ato janë nga të fundmet gjëra që mund t'u referohemi. Kur e bëjmë një gjë të tillë, është mirë që të përqasen me materiale të tjera dokumentare që të fitojë vërtetësi. Xhon Still thoshte: "Kujtimet e njerëzve janë varëse shumë delikate për të varur historinë në to".

BOTIME

"Përtej retinës", një libër përtej pritshmërisë i poetes Lindita Doda

Nga **ILMI DERVISHI**

Pas botimit të vëllimit poetik "Engjëjt lënë gjurmë" të poetes Lindita Doda, libër që u prit mirë jo vetëm nga lexuesit por edhe nga mediat e shkruara e vizive, që në shkrimet dhe komentet të njerëzve të letrave dhe kritika për këto poezi lanë "gjurmë" në letërsinë shqipe.

Pritej botimi i librit të dytë, se poetja është e vendosur në rrugën e krijimtarisë poetike, por siç tha në promovimin e librit poeti Ilir Balili "Poetja vjen para lexuesve se ishim në pritje të poezisë së saj, por në librin "Përtej Retinës" vjen përtej pritshmërisë sonë si lexues dhe krijues.

Tematika e poezive, këndvështrimi dhe origjinaliteti janë të dukshëm si në poezitë "Përtej retinës", "Të jesh nënë", "Qyteti i heshtur" "Fëmijëria", "Në emër të largësisë" etj., janë poezi që lexohen bukur dhe kanë mesazhin filozofik dhe poetik të përcjellur qartë te lexuesi.

Në poezinë e poetes Lindita Doda ka dhimbje siç ka mall "Malli zgjedh fjalët" ka revoltë, revoltë qytetare për shqetësimet e ditës si në poezinë "Revoltë", siç ka dhe



heshtje, një heshtje që flet me bubullime në "Mungesa s'kishte harruar", optimizmi dhe vështrimi në të ardhmen lexohet dukshëm në poezi. Ka trëndafila, ka lule, ka fije shpirti, pranverë siç ka dhe ngjyra jo vetëm bardhë e zi, por të gjitha ngjyrat e ylberit siç ka dhe gri, një gri "Që vjen me pranverën, që mendimet m'i ka lagur" thotë poetja, por ëndrrën s'ma lag dot".


Tema e dashurisë zë një vend të veçantë. Një dashuri njerëzore, përtej asaj intime, për njerëzit, familjen, vendlindjen, të cilët ja shtojnë vlerën më shumë librit. Së bashku me përfshirjen e poezive për Kosovën dhe Çamërinë.

Në një libër si "Përtej retinës" të Lindita Dodës me një përmbledhje gati 135 poezi, me redaktimin e Faik Gjatës e Kujtim Dashit, me një botim cilësor të Shtëpisë Botuese "Toena" vjen si një sukses i autores me një dimension të ri artistik e bashkëkohor.

Fjalët e zemrës

Te ty i lashë gjitha fjalët e zemrës
si mora me vete, veç vetë kam ik,
si mbaja dot peshonin të rënda
ti humbisja udhës, ndoshta pata frikë...

E në fund të fundit ç'i dua me vete,
kur askujt tjetër s'mund t'ia them,
s'kanë kuptim,
le të mbeten aty, përmendore jete
fjalë zemre që s njohën ikje as kthim.



Tematika e poezive, këndvështrimi dhe origjinaliteti janë të dukshëm në të gjitha poezitë.

Mos u mat

Kurrë mos u mat
me bij
te tokes se zhuritur...
njomur
me gjak
lagur
me lot kristal,
ke harruar
po plaget mire j'ua ke ditur,
j'ua ke kafshuar vite me radhe...
Kafshuar jua ke nder shekuj
shtratin etnis,
ndaj flamurin
as ne shtepine tende
mos j'ua prek,
nder thonje te shqipes
rrit djemt e shqipnis
perpara se te lindin
mesojne perse me v'dek....
Kurre me, mos u mat
me bij
te tokes se zhuritur...
me gjak e lot
etjen shpirtit
i'a kane shuar ,
lumi i tyre do marre fryme etshem
vetem ne brigjet
qe hershem
j'ua kane mohuar

ese

Një vuajtje prej adoleshenteje!



Nga **ARJETA TAFÇIU**

E c'mund t'i thuash jetes valle, kur ne formen e nje pikepyetjeje te perplas pas murit?! E cuditur ti me sjelljen e saj ndaj teje, e cuditur ajo me formen tende! C'mund t'i thuash burgut, kur mbas hekurave te mban turpshem?! Renkon ai kur lotet te rreshkasin, kompozojne muret kenge vajtimi me brengat e tua!

- Ah, jete! Mos me servir me dhurata te tilla. Mjaft! Jam mese e ngopur tashme!:- ishin keto fjalet e sykalteroshes, sic e thirrja une gjithmone miken time te dashur. Kishte brenge ne shpirt, brenge qe e kishte mbeshtjelle te teren e s'po e linte te merrte fryme lirisht. Dhe ate pasdite pushimi teksa po shetisnim ne oborrin te cilin e kishim pushtuar te gjithin, i verehej dhimbja ne sy. Doja t'ia gjeja burimin e dhimbjes ne thellesine e kaltersise se qarte te atij shikimi te thelle. Nuk munda! Apo nuk dita! Nuk e di arsyen! Dija vetem qe duhej t'i rrija prane e ta degjoja. Duke folur, ajo humbiste ne kaltersine e qiellit tutje ne horizont.

Duke e degjuar, humbisja ne kaltersine e syve, te cilat po perpiqesha t'i lexoja.

Shume here i kisha pare ata sy magjike te lotonin. I isha afruar dhe vetem perqafim i ofroja. Nuk e pyesja dot per arsyen e loteve. Nuk mund t'i ngulja gjilpera mbi plagen e gjakosur me fjalet qe kisha frike mos e vrisnin. Thjesht i qendroja prane.

Nje nate, teksa po ngjisja shkallet e konviktin me nje shoqen time, e pashe te perlotur duke zbritur me vrap nga shkallet e tjera, drejt nje vendi te vetmuar ne kat te pare. U trodita nga ajo skene. E ndoqa nga pas dhe pse s'po e arrija dot. Nuk ia shuaja dhimbjen, e as vetmine. Thjesht isha kraharori ne te cilin binin lotet e saj me ngasherim.

Ishte vajze e mrekullueshme, e ndjeja si moter, prandaj dhe lotet e saj me copetonin shpirtin. Me dermonin kur s'ua dija kuptimin. Kishte ndrojtje te fliste. Ndoshta frike paragjykimi dhe pse e dinte vleren e saj tek une. Ndoshta kishte akoma fuqi, dhimbjen brenda qelqit te kristalte ta mbante. Ajo ishte e buzeqeshur dhe plot humor. I mbante vuajtjet perbrenda. Kur shpirti i mbushej plot, shperthente ne lot. Ishte e forte ne karakter. Dhe ate pasdite, plot dinjitet, ate fortesi po tregonte.

-Arjeta, e ke provuar te marresh pjeseza nga jeta e dikujt? Si pjeset e nje fotografie te grisur, kujtimet t'i ngjisesh? Sado te perpiqesh t'i kthesh formen e pare, nuk do mundesh kurre. Shenjat e grisjes aty do mbesin. Une e kam provuar te bej kete ngjitje, por me rezultoi e pasuksesshme. Fotoja ish' ndare mijera copash. As formen s'po ia jepja dot, e jo me ta ngjisja.

E di?! Ti gjithmone me je gjendur prane ne merziti. Dhe buzeqeshja me eshte rikthyer vetem duke ditur se ka akoma njerez qe me duan pa shkak. Vuajtjen s'ta kam treguar. Jo per shkak te mosbesimit. Ishin lotet e renduar qe s'me linin te flisja. Ishin aq egoist, sa gjithmone vete mbanin fjalimin. Por, se kuptonin qe ishin memece per te tjeret. E di qe s'i ke njohur, e s'kishe nga tua dije kuptimin.

U ndjeva me keq se kurre gjate qendrimit me te. Vuajtja e saj, mu duk sikur mu be plotesisht e imja dhe pse ishte akoma e huaj per mua. O Zot! C'te jete valle kjo femer? E dija qe ishte e pamposhtur. Lotet i dilnin vetem kur i mbushej shpirti plot.

Po benim ecejake ne oborr e ajo si shkepuste syte nga horizonti i larget. Sikur po i lexonte fjalet ne qiellin e kalter e vetem kaltersia e syve te saj kishte aftesine e deshifrimit. U ulem nen hijen e pemes "sone" qe pranvera i kish' hedhur vellon e gjelbert te asaj stine. Syte ne shenje proteste iu ulen ne te kafenjten e tokes se njomesht nga shiu i mengjesit te asaj dite. Papritur u degjua nje ze. Sa te pakomandueshem ishin ata sy magjik nga ai ze. Instiktivisht u drejtuan per nga ai dhe ngrine per nje cast. Ishte ai! Djali qe dashuronte. Shpertheu ne lot denese. Kishte nevoje per perqafimin e atij kraharori ne te cilin ishin thare shume lote.

Djali ishte nje i njohuri i yni, ne nje marredhenie me nje tjeter tashme, e cila kishte tentuar vetvrasje per ta fituar ate. Eh, cfare kompleksiteti! Sapo piva nje gllenke brenge te panjohur nga jeta! Per here te pare ndjeva dhimbjen e nje ndjenje te humbur te dikujt, pa e provuar vete ndonjehere. Per te paren here, pas rrefimit te dikujt fjalet u zhduken si era pas pemeve te pyllit. Por, qava! Qava bashke me te dhe kisha nevoje me shume se kurre ta perqafoja.

Instiktivisht drejtova gishtin drejt pemes. Kisha degjuar se koha ishte si goma per dhimbjet, sa me shume te kalonte aq me shume i zbehte dhimbjet dhe pse deri tani me te kishte ndodhur komplet e kunderta.

E dashur, shiko! Te kujtohet kjo peme ne dimer. Peshen e rende te bores se ftohte mbante mbi vete. Nganjehere dhe akujt qe shkelqenin nga nje diell i rreme e qe neve na mahnisnin, ajo i duronte. Dielli i nxehte i pranveres i shkriu. Pema serish rilulezoi. E mendon se dhe dhimbja jote eshte si bora dhe akujt qe te rendojne ne shpirt? Mua me mahnit me forcen e ketij shpirti, mrekullueshmerine e te cilit e kam njohur prej kohesh. Ka vlere diamanti e shkelqim kristali. Nje dite pranvera do vije, dielli do lindi e ti serish do lulezosh. Buzeqeshjen e embel pa plage renkuese, perseri do ta shikosh ne fytyren tende. Por, te lutem! Trego durim!

Pasditja sikur kishte marre krahe. Kishim qendruar me ore te tera ne ate oborr rrefimi. Dhe ai dukej se kish' vajtuar nga degjimi i gjate ne ate pasdite. Mbyllem nje dite te plakur, me shpresen e lindjes se nje dielli te buzeqeshur te nesermen!

FOTOMESAZH



Megjithëse krahasimi me dy media të rëndësishme botërore është shumë hiperbolik, ideja është shumë e mirë, dhe ndjehemi të mikluar nga Gazmend Kërkuti, një nga mbështetësit e gazetës që ditën e parë.
Gazmendi edhe herë të tjera ka përdorur fotografinë për të pasqyruar gazetën, dhe për këtë ai ka gjithë falënderimet tona.
E vetmja gjë që i bashkon tri gazetat në foton e mësipërme është "liria".
Liria për të shkruar dhe për të pasqyruar të vërtetën dhe të mirën - sigurisht aq sa mundemi.
Dhe kjo liri nuk do të ekzistonte pa mbështetjen e lexuesit, kudo qoftë ai.
Lexuesit jashtë vendit, sidomos në SHBA, tani mund ta marrin gazetën në PDF duke paguar me PayPal përmes adresës <rrugaearberit@gmail.com>
Një abonim në Europë kushton 10 Euro në vit, ndërsa në SHBA dhe vende të tjera 15 USD.
Brenda Shqipërisë dhe Dibër të Madhe pajtimi kushton 600 lekë në vit.
Faleminderit që kontribuoni që gazeta "Rruga e Arbërit" të jetë një gazetë e lirë!



Rrefimet e Mondit

Llotistët

***Nga* EDMOND HASANI**

Përfundimisht llotistët janë kategoria më injorante në lidhje me njohuritë dhe shijimin e futbollit! I shikoj në çdo bastore të çdo qyteti dhe kuptoj se janë njësoj: nuk ndjekin bukurinë e lojës, nuk njohin të kaluarën historike të ekipeve, nuk njohin biografi futbollistësh a trajnerësh, janë bërnut në kujtesë, ama sytë ju dalin si topa të shëmtuar ngulur për orë të tëra te monitorët, ku jepen rezultatet në vijueshmëri dhe gjithmonë të gjithë për një ndeshje apo për një gol humbasin lloton!

Duhanxhinj të neveritshëm, rrallë pijanecër, tek-tuk gazmorë, ndonjëherë kavalierë, gjithmonë të tensionuar ngrysin ditët me shpresë se paratë do ju shtohen në përpjesëtim të drejtë me rrudhat në fytyrë, thinjat në kokat boshe dhe vitet në kurrizet e kërrusura nga pesha e thasëve me bileta llotosh të humbura!

Por, sidoqoftë, janë vital! Kurrë nuk e humbin shpresën e mezi presin të gdhijë nata e mëngjesi t'i gjej atje, te vendi ku mallkimi dhe bekimi janë dy anë të një medalje!



Pamje nga një kam azilantësh në Gjermani

Azilantë në shpirt...

Nga **SAMET ZAGRADI**

Rrugë bosh. Xhepa bosh. Zemra bosh. Gjithçka bosh. Boshllëku po futet thellë në zemrën, moralin dhe materializmin e të gjithëve. Nuk ka më para, nuk ka më të ardhme. Nuk ka më të rinj. Ata ikën, dhe vazhdimisht po ikin. Eksodi po përsëritet. Qetësi vrastare në qytet.

"Është e kotë që qeniet njerëzore duhet të kënaqen me qetësi. Ato duhet të lëvizin, duhet të vendosin për të ardhmen e tyre. Radhë gjigante përballe gjendjeve civile për aplikime. Dielli përvëlues bie mbi kokat e thinjura të hallexhinjve, dhe mbi lëkurën e njomë të fëmijëve të pafajshëm.

Foshnje të shtrira në trotuar, polic që qëndrojnë mbi kokat e tyre duke u mbajtur pishtarin e lamtumirës. Gra shtatzëna të bëra qull dhe që shtyhen në radhë. Dera e hekurt e institucionit të vetëm në qytet që goditet nga nervat dhe egoja e qytetarit që nuk po merr shërbim. Para të lëna mënjanë për të blerë biletën e ikjes nga ky makth.

Diku aty, në turmë, një humbje ndjenjash e një pensionisti, që kishte dy tri orë që qëndronte nën turmë. Një telefonatë nga larg thonë se lajmëroi se azilantët e parë janë pranuar, gjë që shtoi besimin dhe vullnetin e qytetarëve për ti bërë ballë boshllëkut, vapës, turmës dhe dëshirës për të qëndruar akom këtu. Askush nuk e verifikon. Edhe sikur të mos jetë e vërtetë, nuk duan ta besojnë!

Ditët kalojnë, historia po përsëritet. Fryma e dëshirës për të ikur shtohet. Po ashtu, shtohen turmat, shtohen ankthet e qytetarëve, shtohen ikjet masive, shtohet dhe frika e mospranimit, gjë që për ta do ishte fatale.

Fjala azil ka zënë dëgjueshmërinë më të madhe kudo. Kudo në Europë gjen edhe azilantë. Gjen kërkues të një fati më të mirë, të një të ardhme më të sigurt. Çdokush është dyshues, megjithatë merr guximin të futet në një rrezik që nuk di ku e ka fundin.

Litari tashmë u erdhi në fyt edhe çdo ditë e më shumë po i shtrëngon, saqë nuk durojnë dot më. Shqipëria është kthyer në një vend me shpresë të pa shpresë. Ikja mbetet e vetmja shpresë dhe rrugëzgjidhje e miliona halleve që u kanë zënë sytë shqiptarëve.

Fati ky është, sfidat, sakrificat kanë qenë gjithmonë pjesë e shoqërisë shqiptare dhe mendoj që kjo sakrifica do të vazhdojë.

Ndihemi fatkeq, po për fat të keq këta jemi ne...

"Dibra dhe institucionet e saj nuk mund të jenë kurrsesi pa memorie kur është fjala për të vlerësuar punën e njerëzit e punës, kontributorët e aktorët e rëndësishëm që kanë lënë një shenjë në zhvillimin dhe historinë e saj".

Nazmi Koçi, "Qytetar Nderi i Peshkopisë"

Më datën 14 korrik 2015, ora 18.00 pasdite, në një nga sallat e bukura të Hotel "Tirana International", iu dha titulli i lartë "Qytetar Nderi i qytetit të Peshkopisë" Prof. Asoc. Dr.Nazmi Koçit. Kishin ardhur miq, shokë, kolegë, të afërm e familjarë të Dr. Nazmi Koçit.

Në fillim për të pranishmit u shfaq një dokumentar mbi jetën dhe veprimtarinë e Nazmiut, ideja dhe skenari përgatitur nga Defrim Methasani, i cili ishte dhe moderator i kësaj mbrëmje dibrane.

Për të folur mbi aktivitetin e Dr.Nazmi Koçit në qytetin e Peshkopisë në fillim e mori fjalën Elmaz Lala, i cili kishte njohje të hershme me të dhe solli detaje të reja për të pranishmit. Marjana Sina, dentiste, kolege e Nazmi Koçit, tregoi për marrëdhëniet e mira që kishte vazhdimisht Nazmiu me kolegët, por dhe vartësit. Me zërin e saj të mrekullueshëm këngëtarja Liri Rasha do ta ndizte atmosferën duke kënduar një potpuri të bukur dibrane.

Foto Toti, ish shef i katedrës së Ortodontisë, por dhe udhëheqës i temës së Dr. Nazmiut, kur mbrojti doktoraturën, përshëndeti të pranishmit duke uruar që kështu si Nazmi Koçi iu shtofshin bijtë dhe bijat Dibrës.

Folën edhe Agron Dhëmbo e Nikoll Bushi. Në fund, Ilir Krosi, kryetari Bashkisë së Peshkopisë në detyrë i dorëzon mes duartrokitjeve të zjarrta titullin: "Qytetar Nderi i Peshkopisë" Nazmi Koçit, i cili në fjalën e tij ndër të tjera tha: "Mes punëve të shumta të qytetit tonë jemi munduar t'i vlerësojmë, respektojmë dhe nderojmë bijtë dhe bijat e qytetit tonë që kanë kontribuar ndër vite në fusha të ndryshme, por për qytetin e Peshkopisë".

Në fund përshëndeti edhe Dr.Nazmiu, i cili e nisi: "Edhe pse një jetë kam dhënë leksione, sot para këtij auditori e ndjej veten një nxënës i dobët. Unë ju falenderoj sinqerisht për pjesëmarrjen tuaj në këtë ceremoni vlerësimi që më bëhet mua nga vendlindja. Në fakt, ky aktivitet duhej të ishte bërë në Peshkopi, por rrethanat e sollën këtu në Tiranë, megjithatë jam i bindur se sonte kemi një copë Dibër këtu në metropolin shqiptar".

Fjalën e tij ai e mbylli me fjalët: "I mbetsha borxh gjithmonë Dibrës time!"

Ky aktivitet u mbyll me këngën tashmë himn të Dibrës "Sillu shqipe nga kalaja", ku të gjithë u ngritën në këmbë e këngën e kënduan së bashku, por shekullori Zeqi Agolli, një diplomat karriere, u përlot tek dëgjonte këtë këngë të bukur dibrane.

Për të pranishmit u shtrua një koktej nga klinika dentare "Evident"



Nazmi Koçi duke marrë titullin nga ish-kryetari i Bashkisë Peshkopi, Ilir Krosi. Foto: F.Lleshi

I përkushtuar pas punës, profesionit, vendlindjes dhe familjes

Nga **ELMAZ LALA**

Auditori i sotëm në pjesën dërmuese të tij është shumë i njohur për mua.

Ndjehem plot emocion dhe njëherit i privilegjuar ta marr fjalën sot këtu, në ceremoninë e dorëzimit të titullit "Qytetar Nderi të Qytetit të Peshkopisë" , z. Nazmi Koçi, një nga ish-drejtuesit më të spikatur të sektorit të shëndetësisë në rrethin e Dibrës dhe njëherit një bashkëpunëtor i vyer i imi dhe i shumëkujt të asaj periudhe. Më shumë se kaq jam këtu për të dhënë një dëshmi apo për të pohuar disa prej shumë të vërtetave në një eveniment të tillë për jetën, përkushtimin në punë, pasionin për profesionin dhe seriozitetin e nëpunësit model të administratës publike që ka shfaqur në vijimësi kolegu ynë, Nazmi Koçi.

Detyra e ish punonjësit të seksionit të Arsimit e Kulturës në rrethin e Dibrës më ka bërë të kaloj gjithë fshatrat e zonat e saj, të njoh shumë kolegë të profesionit, mjaft kuadro e nëpunës të sektorëve të tjerë dhe të bëj miq shumë prej tyre. Kështu fillon edhe raporti im i njohjes me Nazmiun, në vitet '80. Në fillim njoha Vjollcën, atëherë mësuese në shkollën e mesme të Shupenzës e më pas në Pedagogjiken e Peshkopisë. Është rasti të them se ajo është një ndër mësueset më të respektuara për mua dhe më të vlerësuara edhe në opinionin pedagogjik dhe organet arsimore të Dibrës, kontributi i së cilës për mjaft breza nxënësish është vërtet i çmuar. Ndërsa Nazmiu kishte krijuar emër si një mjek-stomatolog profesionist, si një veprimtar shoqëror mjaft aktiv, me funksione drejtuese në trevën e Grykës së Vogël dhe me vëmendje të posaçme nga sektori i arsimit. Më pas njohja jonë u zgjerua edhe pse fare të afërm tanët banonin e ishin komshinj në Balldre të Lezhës. Një familje nga Okshtuni i thellë dhe i ashpër, por me traditë patriotike e mikpritjeje, një familje që ndërsa luftonte për mbijetesë, pretendonte e luftonte si pakkush për jetën dhe të ardhmen, një familje shumë arsimdashëse, që shkollimin e fëmijëve e vinte edhe mbi bukën për ta. Ishte ky lloj trualli që e bëri Nazmiun të vazhdonte 8–vjeçaren nga Okshtuni në Ostren, të këmbëngulte për arsimim në nivele të tjera më të larta, të përfundonte Fakultetin e Mjekësisë si njëri prej 2-3 studentëve më të shkëlqyer të tij, duke arritur deri në mbrojtjen e Doktoraturës dhe të titullit të Profesorit.

Por njohja jonë u thellua dhe mori një përmasë më të madhe ndërgjegjësimi kur puna na bashkoi në ish-Komitetin Ekzekutiv të rrethit. Një rreth i madh, që fillonte nga Studna, Qafë Bualli e deri në Qaf Draj të Reçit, me fshatra shumë, me terren të vështirë, me zona të varfra e me probleme nga më komplekset. Dhe mendoni sa të ndjeshëm ishin për njerëzit sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë. Kishte probleme të mëdha të shtrirjes në pikëpamje sasiore të këtyre shërbimeve, të rritjes dhe përmirësimit së cilësisë së tij, të përgatitjes shkallë-shkallë të personelit të kualifikuar vendës, duke rihapur në Peshkopi shkollën Pedagogjike dhe atë të Infermierisë apo duke rritur ndjeshëm kontigjentet e shkollës së lartë, etj. Me kohë gjërat u përmirësuan, disproporcionet midis zonave u zbutën dhe renditja e Dibrës në rang kombëtar në këta dy sektorë ndryshoj esencialisht për mirë. U kërkoj ndjesë për ndonjë dozë të lehtë nostalgjie, por edhe nostalgjia është sentiment njerëzor i pranueshëm, aq më tepër kur pasqyron realitetin e kohës dhe nuk e deformon atë. Pastaj nostalgjinë e kam për njerëzit e për punën dhe jo për sistemin që lamë pas.

Po pse e paraqita këtë tablo? Në këtë proces të punës dhe të bashkëpunimit midis nesh, madje më gjerë edhe të një brezi më të ri, që u vu në drejtim në atë periudhë, kam evidentuar te Nazmiu një varg cilësish e virtytesh të admirueshme. Një njeri këmbëngulës e punonjës i ndërgjegjshëm, një drejtues kompetent dhe i aftë, një administrator serioz dhe me vizion, njeri me shpirt të gjerë dhe i virtytshëm, me ambicie të lartë dhe sedërli në punë, një burrë i mençur dhe me muhabet të këndshëm, që i njeh dhe i respekton rigorozisht limitet e mikut, të bukës, të besës dhe të detyrës, një nëpunës që nuk bënte kompromis me ligjin, por që nuk i mungonte edhe sensi human e njerëzor në zbatimin e tij. Janë këto disa prej cilësive që e bëjnë Nazmiun të respektuar në opinionin e gjerë edhe pas transfuzionit të thellë që përjetoj shoqëria jonë në çerek shekullin e fundit.



Dua ta them me bindjen më të thellë se ajo çfarë e karakterizonte punën tonë ishte fryma e punës në ekip, ndjenja e thellë e përgjegjësisë për detyrën, ritmi i lartë e puna nën presion, në zona nuk shfaqnim kurrë interesa të ngushta sektoriale, por përpiqeshim të zgjidhnim aq sa mundeshim problemet që ishin funksion i institucionit tonë. Për mua, dhe të tjerët më të rinj, kjo periudhë ku gërshetoheshin përvojat drejtuese të Bajram Stojkut, inteligjenca e Nazmi Koçit, uraganet e të ndjerit Bajram Puca, energjitë e pashtershme të Bajram Krrashit e Sefer Manrekës, gatishmëria për të shërbyer e Bardhok Rajtës, korrektësia shembullore e Qamil Sulës apo burokracia e domosdoshme e Myrteza Renës, aftësitë organizative të Xhemal Gazidedes, lapsi i mprehur i Ali Kazës dhe mendja e hollë e një gruaje të rrallë, me aftësi të pamata ekuilibruese dhe me personalitet shumë të dashur për të gjithë ne, të së ndjerës Lumturi Gjoni, përbëjnë një përvojë të jashtëzakonshme dhe një prej krenarive për secilin prej nesh. Kjo atmosferë pune, ky raport përgjegjësie e solidariteti dhe kjo marrëdhënie midis nesh e me publikun kanë qenë edhe për Nazmiun një universitet më vete, sepse ai mishëron nga të gjitha këto dhe që e bënë atë një ndër nëpunësit e spikatur në Administratën e Lartë të Shtetit, kur shërbeu dy herë në Ministrinë e Shëndetësisë.

Së dyti, dëshiroj të potencoj një dimension tjetër shumë domethënës të Nazmiut, që në thelb është tipar i njerëzve të fortë e kurajozë. Ai, në tërë jetën e tij, është dëshmuar si njeri i sfidave dhe përballjes me to, si njeri që rriskon e provon rishtas t'ia dalë mbi vështirësitë e natyrave të ndryshme që jeta na i servir shumë herë. Mjafton t'ju përmend këtu se i detyruar nga rrethana të ndryshme apo faktorë jologjikë, në një moshë në kapërcyell, të marrë rrugët e kurbetit matanë detit dhe të bëjë çdo punë, vetëm në fund atë të profesionit të vet në një nga klinikat e Romës. Më pas, i nisur nga asgjëja ekonomikisht, por me ide e vizion të qartë dhe me një kurajo të admirueshme ia doli të krijojë një ndër klinikat dentare më të kohës në qytetin e Tiranës, konkurruese e mjaft të aksesueshme. Kompleksi dentar i tij është mëshirimi më i qartë i zbatimit të thënies proverbiale të shkencëtarëve francezë " se Franca nuk ka naftë, por kemi ide".

Së treti, nuk mund të mos evidentoj një dimensioni tjetër të rëndësishëm të Nazmiut, atë familjar. Një familje e tërë me arsim të lartë, që investimin për shkollën nuk e kondicionon me asgjë, me specializime të kryera në universitetet më të njohura ndërkombëtare, me fëmijët që ndjekin me ngulm rrugën akademike, një familje–katedër. Është vërtet kënaqësi e duhet të ndjehesh një prind i lumtur dhe krenar, miku ynë.

Në fund, më lejoni të shpreh gjithë falenderimin tim për institucionin e Bashkisë së Peshkopisë dhe të Këshillit Bashkiak të saj për vlerësimin e punës dhe kontributit të gjatë të dhënë nga shoku ynë, Nazmi Koçi, në dobi të qytetit e rrethit të Dibrës, por veçmas në atë të zhvillimit e progresit të sektorit jetik të shëndetësisë. Këto organizma na dëshmuan qartë se Dibra dhe institucionet e saj nuk mund të jenë kurrsesi pa memorie kur është fjala për të vlerësuar punën e njerëzit e punës, kontributorët e aktorët e rëndësishëm që kanë lënë një shenjë në zhvillimin dhe historinë e saj, edhe të asaj më të vonshme. Këtu është rasti për të theksuar sentencën se "nuk është kurrë vonë për të bërë gjëra të mira" dhe pa kurrfarë mëdyshje mund të pohoj se titulli i akorduar sot për kolegun tonë është njëra prej gjërave shumë të mira. Në anën tjetër veprimtaria e sotme, edhe pse në dukje shënohet si event personal, realisht merr përmasë më të gjerë. Ajo i shërben kontinuitetit e kompaktësimit të mëtejshëm të komunitetit dibran të vjetër e të ri, i cili po bëhet një faktor gjithnjë e më relevant në Tiranë.

recensë

"Kruja trime flet me motrën: Gjirokastër shtroje sofrën!"
Duke lexuar vëllimin e ri "Shqipëria e dashur" të poetit Halim Laçi

50 vite punë, pasion dhe vullnet

Nga **RAMAZAN BUCI**


Jam këtu si koleg, bashkëpunëtor, por edhe si shok i Prof.Dr.Nazmiut. Së pari, dëshiroj të shpreh konsideratën time për kryetarin e bashkisë dhe këshillin bashkiak të qytetit Peshkopi, që i kanë dhënë këtë titull një personaliteti si prof. Dr.Nazmi Koçi, i cili i jep vlerën e merituar edhe vetë titullit "Qytetar Nderi". Për personalitete me background të pasur si prof.Dr.Nazmiu është e lehtë të flasësh, sepse ka shumë për të folur, por njëkohësisht është aq e vështirë, sepse puna dhe veprimtaria e tij mbi 50 vjeçare ka në themel një pasion, vullnet, vendosmëri, përkushtim, një thirrje intelektuale gjenetike, për të cilat duhet një mjeshtëri rrëfyese që jo gjithkush mund ta zotërojë. Sidoqoftë, unë për të qenë mirë me veten dhe të pranishmit, po ju drejtohem fakteve:

Dr.Nazmiu me të mbaruar Fakultetin e mjekësisë, dega Stomatologji, me rezultate të shkëlqyera emërohet mjek dentist në zonën e Shupenzës, ku punoi për 16 vjet intensivisht, si profesionist dentist, si studiues shkencor, por pa neglizhuar edhe detyrat shoqërore që atëherë nuk ishin të lehta për t'u kryer dhe për të qenë i suksesshëm. Rrallëkush në atë kohë, në fshat, ndoshta është rast unikal që një mjek si Dr.Nazmiu të mund të jepte 6 provime pasuniversitare, gjë e cila i detyroi strukturat shtetërore të asaj kohe ta dërgojnë në specializim në katedrën e Ortopedisë stomatologjike në Tiranë. Për aftësitë e spikatura drejtuese e menaxheriale në vitin 1986 emërohet shef i Seksionit të Shëndetësisë deri në vitin 1991, detyrë të cilën e kryen me kompetencë,konstruktivitet, vizion dhe shumë sukses. Për të njëjtat arsye emërohet kryetar i një agjencie kombëtare të porsakrijuar në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilën e drejton me aftësi të admirueshme dhe pas dy vjetësh për shkak të ambicieve të tij profesionale dhe situatës politike kaotike largohet për 2 vjet për të punuar dhe specializuar në një klinikë private në Romë. Pas kthimit nga Italia, me vullnet të jashtëzakonshëm punon si mjek në klinikën private të tij pranë Qendrës Shëndetësore Nr. 10 në Tiranë, pedagog i jashtëm në Fakultetin e Mjekësisë si dhe në disa fakultete të tjera të profilit stomatologjik, duke vazhduar njëkohësisht edhe punën shkencore, të cilën e kurorëzon me sukses në vitin 1999, duke fituar gradën "Doktor i Shkencave Mjekësore". Por fitimi i kësaj grade nuk i duket i mjaftueshëm dhe për këtë vazhdon me pasion punën shkencore, duke botuar mbi 50 punime shkencore, një numër i madh i të cilave të paraqitura në aktivitete edhe revista shkencore ndërkombëtare, duke marrë pjesë në shumë aktivitete shkencore si brenda dhe jashtë vendit, duke botuar librin "Proteza e Plotë dhe Fusha e saj" dhe duke marrë kështu dhe titullin "Prof i Asociuar". Si gjithmonë, pa ndaluar punën shkencore, akademike dhe pedagogjike ka vazhduar edhe punën e tij si drejtues i nivelit të lartë, të cilën e konsideron art në vete, duke punuar mbi 10 vjet si drejtor i shërbimit stomatologjik në Ministrinë e Shëndetësisë, drejtor i klinikës stomatologjike universitare dhe në fund si shef i shërbimit stomatologjik te ASHR Tiranë. Përveç këtyre, Prof.Dr Nazmiu është edhe qytetar shembullor. Ai ka dy fëmijë të mrekullueshëm, të cilët janë që të dy dentistë dhe vazhdojnë me konsekuencë rrugën e të atit, qoftë si profesionist, po ashtu edhe në shkallët e karrierës akademike shkencore. Për të gjitha këto e shumë vlera të tjera, intelektualit të rangut kombëtar dhe qytetarit model Prof. Dr.Nazmi Koçit i jepet titulli "Qytetar Nderi i qytetit të Peshkopisë".

Poeti Halim Laçi, fjalëmençur e fjalëbukur

Nga **VIRON KONA**





Halim Laçi, është një emër i njohur dhe i respektuar i artit dibran, krutan dhe i tërë Shqipërisë, është një nga ata emra poetësh e rapsodësh që kanë lënë gjurmë të ndritshme për dekada në "detin" e muzikës, poezisë, koreografisë,folklorit popullor. Ai është një personalitet modest që rrezaton me thellësinë e mendimit të mençur, me ritmin e vargjeve, me figuracionin mbresëlënës artistik, me bukurinë e përshkrimeve, portretizimin e tipave dhe karaktereve që harmonizohen ëmbëlsisht me bukuritë e reliefit shqiptar, të maleve, kodrave, fushave dhe bregdetit të Shqipërisë. Me krijimtarinë e tij Halim Laçi i ka bërë vazhdimisht jehonë madhështisë së kombit tonë.

Të rrallë janë ata artistë, tek vepra dhe repertori i të cilëve afishohen dhe kombinohen aq bukur llojet e artit dhe mjeshtëritë: krijues, koreograf, instrumentist, rapsod, drejtues, udhëheqës artistik, moderator. Është një shumëvlerësh që shumëkush do ta kishte zili e që pasohet me: 250 tekste këngësh, shumë prej të cilave pasurojnë e nderojnë albumet e mjaft këngëtarëve të njohur të Shqipërisë, ndërkohë që ky personalitet artistik, është pjesëmarrës dinjitoz në të gjitha festivalet folklorike kombëtare 1967-2009, i dekoruar shpesh herë si rapsod, valltar, krijues, interpretues. Mbi të gjitha, njeri i mirë.

Halim Laçi është në zemrat e dëgjuesve dhe shikuesve, vepra e tij përmendet në biseda, në avllitë krutane dhe odat dibrane, në Fushë-Krujë dhe kalanë e Krujës, në Reç, Lurë dhe Radomirë, por ai ndodhet mes tyre edhe fizikisht, vazhdimisht i kërkuar, nga këngëtarë e kompozitorë, veçanërisht për tekstet e bukura dhe të frymëzuara, i kërkuar nga populli për ta përjetuar bukurinë e artit të tij:

"Kruja trime flet me motrën:
Gjirokastër shtroje sofrën!
Vijnë krushqit nga anë e anës,
Këndojnë bashkë n`gjuhë të nanës".

Halimi nuk lë as ditën, as muajin e vitin t`i shkojë kot dhe pa qëllim, ai shkruan dhe boton pareshtur, shkrime, vargje, këngë dhe libra. Vëllimi "Nuk Harrohen", një libër me vlera të mëdha ideore dhe atdhetare, libër që i bënë homazh dhe nderim heronjve të kombit, por edhe njerëzve të thjeshtë, që e shprehin heroizmin e tyre në përditshmërinë e jetës, të heshtur dhe të pa fjalë, me vepra. Në 70 vjetorin e çlirimit, ai botoi përsëri, e kësaj here "Shqipëria e dashur" për të cilin po shprehemi.

Te vlerat e Halim Laçit ndrit mirësia, vezullojnë e shfaqen njerëzit e thjeshtë dhe heronjtë. Halimi shkruan mjeshtërisht dhe me ritëm shqiptar, me humor dhe satirë populore si dibran i mençur, shkëlqen me fjalën dhe mendimin, por edhe me gjuhën e Ezopit, me vargjet e tij kur ligjëron në odat dibrane, në sheshe kuvendesh, në salla koncertesh, në krijime e libra, në valle e këngë.

"Nga trimi lindi trimi,
Si djem të një nane,
Kështu është motivi,
I këngës dibrane".

Halimi është nga ata krijues rapsodë që di t`i përgjigjet flak për flak realitetit dhe jetës, që di të vëzhgojë e të shigjetojë, por që di të mbaj edhe qëndrim, sikurse pasqyron realisht të bukurën në jetë, të bukurën në shpirt, të bukurën në artin e popullit, ai sjellë jetën në vargje dhe në krijimtarinë e tij shumëplanëshe,edhe me diell e furtuna, edhe të qetë dhe me krisma bubullimash, Halim Laçi thur vargje e ndez këngë:

"Për trojet shqiptare,
Do të shkruaj derisa të vdes,
Jam betuar në gjakun e të parëve,
Penën time nuk e shes".

Faleminderit Halim Laçi për artin që na dhuron, për kënaqësitë që na fal, për gjurmët e shndritshme dhe vlerat nxitëse e frymëzuese.

"Të bardhë e mbajtëm kësulën,
Me gjak skuqëm gurin,
Një ditë vumë vulën,
N`kala ngritëm flamurin."

Të bukura poezitë që i dedikohen kolegëve dhe shokëve, drejtuesve dhe njerëzve të thjeshtë në profesione. Të fuqishme poezitë që pasqyrojnë jetën, ndodhitë, ngjarjet, episodet edhe ato me ngarkesë negative apo pozitive, e ku kurdoherë ai di të vendos ekuilibra, di të pikëzojë dhe të krijojë vizione e këndvështrime, por di edhe të hedh sytë nëpër botë, të gjejë miq dhe shokë, di t`i respektojë e nderojë ata, t`u shprehë respektin, mirënjohjen dhe mikpritjen shqiptare. Kështu me shqiptarët në Suedi: Sadulla Zendeli-Daja dhe Sokol Demaku, por, ai, po aq mjeshtërisht dhe me patos i ngre këngë edhe Mikut të Madh të Shqiptarëve, suedezit të shquar, albanologut Ullmar Kvik(Qvick).

"Suedezë edhe shqiptarë,
E kanë gjetur miku mikun,
Kemi zgjedhur krushk të parë,
Të nderuarin Ullmar Kvikun"

Ashtu siç u këndon trimave, ai di t`u këndoj dhe t`u thur himn edhe krijuesve e kolegëve të tij, që me artin e tyre kanë kontribuar për atdheun, kanë lartësuar vlerat e kombit. Është ky nivel arti që na bënë të na mbetet në mendje poezia "Amaneti i Gjok Becit", apo poezia kushtuar Lekë e Terezina Gega (Grupi i Milotit):

"Ashtu si rrufeja,
Që shkrepi prej motit,
Me këngë të reja,
Vjen grupi i Milotit."

Halimi është edhe një veprimtar që se ka shokun. Së bashku me mikun tij Mehmet Deliun, dhe të tjerë veprimtarë në Fushë-Krujë, ai organizon dhe zhvillon veprimtari të bukura e tërheqëse për banorët e qytetit dhe të krahinës; sjellë në kujtesë dhe prezanton me artin e valleve dhe këngës, historinë dhe jehonat e shekujve, duke lartësuar në piedestale arti trimat që ranë për liri, dëshmorët e atdheut, por edhe njerëzit e punës dhe të jetës, ata që me shpirt të zjarrtë e zemër të madhe zhvillojnë demokracinë shqiptare drejt vlerave më të mira evropiane.

Poeti Halim Laçi, ky valltar e koreografi i shquar, ky njeri i urtë, fjalë-mençur e fjalë-bukur, i dashur si ai, i vendosur, krenar dhe me kurajë, që respekton më tepër se gjithçka të vërtetën dhe lirinë, edhe tani në moshë disi të thyer, i shërben pa u lodhur dhe me dinjitet atdheut, nderon dhe respekton me fjalë zemre popullin dhe historinë e tij, i ngre himn lirisë, të vërtetave të jetës dhe heroizmit popullor.

Faleminderit, Halim Laçi!

EKSPOZITË PIKTURE

Piktorët Bleranda Borova - Gashi dhe Rinor Sllova në një ekspozitë

Më 22 korrik 2015, në Hamamin e qytetit të Dibrës së Madhe u hap ekspozita e përbashkët e piktorëve dibranë Bleranda Borova-Gashi dhe Rinor Sllova.

Mes dashamirësve të artit, miq dhe familjarë të piktorëve ishin të pranishëm dhe personalitete të kulturës dhe artit dibran. Mjaft vëmendje dhe interes u ndjek dhe nga mediat e shkruara dhe vizive.

Bleranda pas mbarimit të studimeve në Akademinë e Arteve Tiranë, vjen nga Oslo i Norvegjisë për të hapur ekspozitën e saj në qytetin e lindjes në Dibër të Madhe.

Po kështu dhe Rinor Sllova, ka mbaruar në Shkup, ekspozitat e tij të njëpasnjëshme në qytetin e lindjes në Dibër të madhe ka patur suksesin dhe një vëmendje nga dashamirësit dhe njohësit e pikturës.

Përshëndetje dhe vlerësime të shumta nga të pranishmit dhe veçanërisht nga piktori Zabit Bocku, i cili trajtoi ekspozitën me gjuhën e artit dhe vlerësimet me detaje të pikturës të të dy piktorëve. / **I.Dervishi**





Në foto: Bleranda Borova-Gashi dhe Rinor Sllova, dy piktorët që hapën së bashku ekspozitën në Hamamin e Dibrës.

Rruga e Arbërit nr. 111



Foto: © Fehmi Lleshi

veprimtari

Do të vijnë dhe përvjetor të tjerë, do të mblidhemi përsëri, do të mblidhemi në festivale e në Odën dibrane, do të dëgjojmë këngët e bukura që na ka lënë Naim Plaku dhe me plot gojën do të themi: Jo, nuk ka vdekur! Është kënga që na la ne, është kjo këngë që e bën të pavdekshëm Naim Plakun.

Na mblodhe përsëri, o Naim Plaku!

Nga **SHAQIR SKARRA**

Na mblodhe edhe njëherë, o Naim Plaku! Na mblodhe si atëherë në ato vite kur në atë shtëpi të vogël kulture në qytetin e Peshkopisë, por që bëri punë të mëdha, jehonte kënga e vallja, përgatiteshin grupe artistike për të konkurruar në skena brenda e jashtë vendit e ne dëgjonim këngën himn të Dibrës:

"Po i sjell era retë e zeza,
Vijnë prej malit breza-breza,
Na ka shkelë hasmi ke dera…!"

nga zëri brilant i Qerim Sulës, që u bë një nga këngët më të dëgjuara anembanë vendit, por që pati një jehonë shumë të madhe dhe në skenat e botës. Dhe Arif Vladi do të buçiste me një tjetër këngë dhe pikërisht në ato vite kur shpërthyen dhe demonstratat e Kosovës:

"O, prite Azem Galicën, me gjithë nuse!
Shqipja ban valë në fushë të kuqe.
Lufton Kosova me besë-a besë,
Shumë po na vritet, kurrë s'ka me vdekë!
Po prin Azemi në log të burrnisë,
i prin Kosovë,
Lufton për Kosovën
Lulja e trimnisë!
O, prite, Azem Galicën, se po vjen,
O, hej!"

Pikërisht me këtë këngë, këngëtarin e madh të Dibrës emigrantët shqiptarë e ngrinin hopa në krah dhe radha bëhej e madhe kush e kush ta takonte më parë. Bilbili i këngës dibrane Liri Rasha na sillte në skenë të gjitha këngët e Korabit si:

"Moj fusha e Korabit,
T'i na erdhe hakit,
T'i na ndave shtratit,
me yll të sabahit…"

apo kënga tjetër:

"Na u dunën kepat,
o kepat e Gramës,
për kë t'i çoj fjalët,
ore shpirt i nanës…"

Dhe Vera Laçi do të na sillte këngën:

" Kur t'vijnë shoqet nanë me m'taku,
U trego shaminë që e kam shkru,
E kam shkrue nanë me lotët e mallit
Në gjergjev kam vu dy sytë e ballit…".

Kurse Saje Poleshit i pëlqente më shumë fshati se sa qyteti, këngë kjo që u bë në ato vite hit në të gjithë Shqipërinë nga jugu në veri:

"O mirë se na erdhe!
O mirë se ju gjeta…"

Dhe të gjitha këto këngë të bukura, thesare me vlera kombëtare, nëse deri dje nuk e dinim se kush ishte autori i këtyre perlave dibrane, sot ato kanë një emër, kanë një autor që njihet nga i madh dhe i vogël jo vetëm në Dibër dhe trevat e saj, por dhe më gjerë: Naim Plaku!

Data shënon 4 korrik 2015, ora 10 paradite. Tek hedh vështrimin sot e shikoj sallën e madhe të Muzeut Historik të mbushur plot për plot meditoj shumë e shumë. Meditoj e kujtoj raste të ndryshme, ditë të lodhshme duke u përgatitur, duke shpërndarë ftesa e duke njoftuar njerëz me telefon dhe prapë në ditën e fundit kur do të zhvillohet aktiviteti ende në sallë mbeten karrige bosh. Në fakt, sot ndodhi krejt e kundërta. Aktiviteti u organizua nga vetë familja, por dy shokë, miq, koleg e ish nxënës të Naim Plakut, Baftjar Çera dhe Shaqir Skarra që u angazhuan për mënyrën e organizimit të këtij aktiviteti nuk e patën të vështirë aspak, por u desh thjesht një njoftim në rrjetet sociale, mjaftoi të përmendej emri i Naim Plakut dhe ja kjo sallë prestigjioze në metropolin shqiptar të mbushet plot e për plot.

Erdhën në një vjetorin e vdekjes së Naim Plakut, erdhën të gjithë dibranët, por dhe nga vise të tjera, se gjeografia e miqve e shokëve të tij ishte e madhe, ishte nga gjithë Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Diaspora. Erdhën miq e shokë, të afërm e ish nxënës, këngëtarë e artistë. Erdhën të gjithë e mbushën plot për plot sallën e Muzeut. Erdhën si atëherë kur u mblodhën në sallën e Teatrit të Operas dhe Baletit për shtatëdhjetë vjetorin e ditëlindjes së tij. Por sot ishte disi ndryshe. Erdhën prapë, por të mërzitur, të përlotur, të menduar, pasi Naimi u mungonte të gjithëve. Kishte plot një vit që ishte ndarë nga jeta. Erdhën tok të gjithë që dhimbjen, mungesën e poetit të këngës popullore dibrane Naim Plaku ta ndajnë së bashku.

U mbush plot një vit që Naimin nuk e kemi më fizikisht midis nesh, por shpirtërisht do të jetojë gjithmonë se jeton kënga popullore dibrane, e cila brodhi kudo në skenat e vendit, por dhe jashtë kufijve në skenat më prestigjioze të botës, se të tillë e bëri Naim Plaku këngën, të tillë e bënë artistët dibranë. E kënga dibrane, edhe pse ka vdekur Naimi, ende jeton. Jeton kjo pasuri e madhe me mjaft vlera që na ka lënë, do të jetojë në shekuj se me të u dashuruan dibranët kudo që ndodhen, jeton folklori aq i pasur që ka mbledhur dhe e kemi sot të botuar, jetojnë mijëra e mijëra vargje, qindra e qindra tregime, mijëra proverba, fjalë të urta e frazeologji dibrane.

Sot vërtet na mungon, na mungon shumë, por këtë pasuri të madhe ama na e ka lënë ne të gjithëve, ia ka lënë Dibrës që e deshi më shumë sesa jetën e tij. Do të shkruante diku në një bllok të vogël shënimesh e që sot faqet e tij janë zverdhur nga koha:

"Dibër moj, ti Dibra ime
Sa e lashtë, aq edhe trime,
Në rrebeshe e në tërmete
N'log t'burrnisë ballin e rreshke
Dibër ishe, Dibër mbete…. "

Po sa e sa të tilla ndodhen sot në arkivin e familjes së Naimit, që ndoshta presin dita-ditës të shikojnë dritën e botimit. Megjithatë, edhe në këtë përvjetor të Naim Plakut mungojnë plot miq e shokë të tij, mungojnë: Prof. Nuri Abdiu, Hasan Leka, Shaban Xhajku, Imer Seferi, të cilët u ndanë para kohe nga kjo jetë zhurmëmadhe, por që Naimi i deshi dhe vlerësonte shumë për punën dhe kontributin që bënë në të gjallë për Dibrën dhe dibranët.

Naim Plaku la shumë miq e shokë. Ai i tillë kishte lindur, vetëm për të bërë miq e shokë, pasi nuk dinte të urrente njeri, nuk dinte të shante, nuk dinte të fliste prapa krahëve për miq, shokë e kolegë. E një mik i tij, një dashamirës i artit dhe kulturës dibrane, një biznesmen i suksesshëm, Zaim Korsi, kishte kohë që mendonte për një vjetorin e vdekjes së Naim Plakut, kishte dëshirë që ta bënte si atë ditë kur Naimit i festuam shtatëdhjetë vjetorin e lindjes në Teatrin e Operas dhe Baletit mes një koncerti të madh festiv. Dhe sot ky aktivitet me përmasa të mëdha, me një minikoncert homazh u sponsorizua nga Zaim Korsi.

Në sallë heshtje e madhe dhe kjo heshtje pasi ishte mbushur plot një vit që këngës popullore dibrane i mungonte autori, i mungonte gjenerali i saj, siç e etiketoi Naim Plakun, kompozitori dibran Përparim Tomçini.

Sy e vesh të gjithë tek dokumentari i shkurtër që po shfaqej. Në ekran dilte edhe njëherë Naim Plaku i gjallë, kur shkruante e hidhte në letër ato tekstet e këngëve të mëdha, që u bënë hit e morën udhë dhe nëpër botë. Emocione të mëdha për të pranishmit, por këto emocione u shtuan edhe më shumë kur në skenë u ngjit si gjithmonë gazetari i talentuar dibran, ish nxënës i Naimit, Defrim Methasani, i cili ishte dhe moderator i këtij koncerti homazh për të madhin Naim Plaku.

E kush më mirë se kompozitori Përparim Tomçini, i cili sa e sa net e ka gdhirë bashkë me poetin Naim Plaku pa gjumë, di të flasë bukur e rrjedhshëm për një karrierë të gjatë artistike. Të parin që ftoi në skenë Defrimi ishte Përparim Tomçini. Ai tregoi edhe ato detaje të vogla që spektatori nuk i ka ditur kurrë e poeti Naim Plaku i mori si sekret profesional me vete. Përparim Tomçini na bëri një pasqyrë të gjatë të bashkëpunimeve të Naimit me të gjithë këngëtarët, të njohur dhe panjohur, brenda dhe jashtë vendit, me kompozitorë të ndryshëm, me tekste këngësh që sot kanë mbetur në kujtesën e gjithsecilit prej nesh. Tregoi mes miqsh dhe shokësh kur së bashku me Naimin për një rresht nën dritën e hënës dhe shkrepëses e gdhinim bashkë tek ura ku shkon rruga për në fshatin Pilafe dhe kur e gjenim vargun e duhur, gëzonim si fëmijë e brohorisnim thua se kishim gjetur "Eurekën". Tregoi edhe kur përgatisnin të dy bashkë festivalin folklorik të Gjirokastrës e kur grupi i Peshkopisë bëhej gati për t'u nisur me autobus, Naimin e zbrisnin poshtë, e zbrisnin se për "dikë" ishte i "rrezikshëm" . E kush? Naim Plaku, njeriu më i qetë, më i dashur, më i respektuar, njeriu që nuk dinte të mbante inate apo të hakmerrej, njeriu që nuk shkelte milingonën rrugës, siç i thonë fjalës. Naimi nuk mërzitej për këto që i bënin, ai vonë e kuptoi se dora tinëzare e dikujt shkruante në ato letrat anonime, ia nxinte të bardhën e ia bënte të zezë. Por përkundrazi edhe me këto njerëz nuk mbante mëri. Veli Vraniçi, drejtor i Qendrës kulturore "Haki Stërmilli" Peshkopi kishte ardhur direkt nga Peshkopia për përvjetorin e Naim Plakut. "Për ne nuk ka vdekur, - e nisi diskutimin e tij, - se artistët nuk kanë vdekje, por kanë vetëm lindje. Nuk ka vdekur Naim Plaku, se në çdo aktivitet kulturor që bëjmë, në repertorin tonë pa dyshim që do të kemi këngët e Naimit, kemi këtë pasuri të madhe që na e ka lënë. E sapo Defrim Methasani që nga skena reciton vargjet:

"Miku i shpisë e la konakun,
Dhandri i ri kapi bajrakun,
Nusja e re hoqi dullakun,
Plaka n'votër e thej furkën,
Fmija i djepit rrokën pushkën,
Gratë n'llogore pjekin bukën…"

Qerim Sula ngjitet në skenë e zëri tij si ortek dëbore jehon në e salla e theu heshtjen që kishte pllakosur dhe filluan të duartrokasin dhe pas këngës çdo gjë rrodhi ndryshe.

Përvjetori i vdekjes së poetit Naim Plaku u kthye në një minikoncert, pasi këngët kryesore të tij filluan të këndohen nga artistët dibranë, nga ata artistë që ishin ngjitur në skenë me tekstet e Naimit dhe morën famë kudo nëpër botë po me këto tekste. Folën shumë nga të pranishmit, recituan, kënduan e herë-herë Defrimit i iku edhe skenari, pasi nuk mund t'i ndalonte njerëzit të shprehnin fjalë zemre dhe malli për Naim Plakun.

"E shikoj dhe unë se sot paskam shumë emocione kur flas këtu në këtë sallë për mikun, shokun, kolegun dhe njeriun model Naim Plaku, i cili na mungon të gjithëve", - e nisi diskutimin e tij Dr.Fejzulla Gjabri. Diskutimin e tij Baftjar Çera, drejtor i Pallatit të Kulturës Kamëz e nisi me këto fjalë: "Ka njerëz që vdesin sapo lindin dhe ka njerëz që nuk kanë vdekje, por vetëm lindje. I tillë është edhe Naim Plaku, ish mësuesi im, poeti i këngës popullore dibrane. Ai do të jetojë në shekuj, se e tillë është vepra që na ka lënë".

Edhe Liri Rasha me zërin e saj prej kanarine do të ngjitej në skenë e do të këndonte një këngë me tekst të Naimit; edhe Sherif Derivishi do të këndonte.

Foli edhe Bedri Alimehmeti, shkrimtar nga Tirana, Ahmedie Daci, Mevlud Buci, Metush Skeja, recituan Munir Hoxha, Fran Vukaj, Bleona Merhadi, Xhelal Luca, Hamdi Skeja.

Në fund, në emër të familjes përshëndeti nipi i Naimit, njeriu që gjithmonë i ka qëndruar pranë, Afrim Çenga: "Nga të gjithë njerëzit e familjes së Naim Plakut unë ndjehem më i privilegjuari që po flas sot para një publiku të tillë. E shikoj se daja im ka pasur plot miq e shokë dhe asnjëherë nuk ka qenë i vetëm e të gjithë ata që i qëndruan pranë në ditë të mira dhe vështira shikoj se janë prapë në këtë sallë dhe është meritë e tyre që po bëhet një aktivitet kaq dinjitoz. Unë kam shumë për të folur e treguar për jetën dhe veprën e Naim Plakut. Në ato vite për të ishte e vështirë. Unë isha i vogël, por mbaj mend fare mirë kur vinte vonë në shtëpinë tonë në Pilafe dhe zgjohej në mëngjes në orën pesë, në mos dhe më shpejt. Dilte në ballkon e ulej në një karrige të thjeshtë druri e rrinte ashtu i kërrusur mbi tavolinë në ato letrat e bardha, ku hidhte vargjet e ndonjë kënge të re që ia kërkonin. Një ditë i numërova gjithsej 127 letra format të shkruara me dorë dhe me stilograf. Sinqerisht, m'u dukën shumë, ndaj dhe unë e pyeta:

- Dajë! Po a nuk ke shkruar shumë për një tekst kënge?

- Kështu e duan nip, kështu ma kërkojnë. Ai ishte i kujdesshëm kur hidhte vargjet, se mjaftonte vetëm pak të gabonte pa dashje e ngjarjet rrokulliseshin krejt ndryshe dhe bashkë me këngën shkonte në humnerë. Ndaj Naimi çdo tekst kënge e bënte të paktën në tre - katër variante".

Aktivitetin e mbylli kënga hit:

"Sillu shqipe nga kalaja,
Kjo është Dibra maja-maja"

e kënduar nga Dritan Jashari, por që do ta shoqëronin dhe vetë të pranishmit në sallë. Në fund për të pranishmit u dha një koktej si dhe u shpërndanë librat e Naimit falas për të gjithë.

Sot ishte një vjetori i vdekjes së Naim Plakut, një ditë që e përkujtuan dibranët në metropolin shqiptar. Do të vijnë dhe përvjetor të tjerë, do të mblidhemi përsëri, do të mblidhemi në festivale e në Odën dibrane, do të dëgjojmë këngët e bukura që na ka lënë Naim Plaku dhe me plot gojën do të themi: Jo, nuk ka vdekur! Është kënga që na la ne, është kjo këngë që e bën të pavdekshëm Naim Plakun. Na mblodhe edhe njëherë, o Naim Plaku, na mblodhe! Do të na mbledhësh përsëri, se këngët e tua do të jehojnë vite me radhë.

Çdo gram i shpirtit artistik të poetit Naim Plaku ka peshën e një vlere kombëtare

Nga **PËRPARIM TOMÇINI**

UNË DHE NAIMI

Në koncertin recital me krijimtarinë time për mbrojtjen e diplomës në muajin maj 1980 kisha në repertor të këtij koncerti një këngë me titull: "Ballë për ballë Dibra e dushmani!" me tekst të Naim Plakut. Kënga u këndua shumë bukur nga Liri Rasha dhe u prit shumë mirë nga publiku artdashës, por në fakt unë dhe autori i tekstit nuk e ndjenin të plotësuar atë çka ne donim të shprehnim. Kështu përpjekjet vazhduan teksa përgatiteshim për Festivalin folklorik të Gjirokastrës të vitit 1983, ku përveç përgatitjes të komplet skenarit të grupit të Dibrës, preokupimin më të madh e kishim për këngën "Ballë për ballë Dibra e dushmani". Mund të jenë shkruar dhjetëra e dhjetëra variante tekstesh e melodish, derisa më në fund arritëm tek variant i sotëm i këngës: "Na këndojnë pushkët nëpër kulla!", kënduar nga mjeshtri i këngës dibrane Qerim Sula. Edhe sot e kësaj dite kjo këngë këndohet me gëzim e krenari në gëzime familjare e dasma dhe ka hyrë në fondin e artë të kulturës dibrane.

Në janar të vitit 1981, artisti i kompletuar dibran, regjisori, aktori dhe këngëtari Skënder Cala më dha një tekst kënge që i kushtohej Avdyl Krasniqit, mësuesit drenicar që nxori eshtrat e Azem Galicës nga gremina (babai i heroit të UÇK-së Xhev Lladrovci) dhe që u përndoq tërë jetën nga regjimi serb. Këtë material letrar Skënderit ia kishte dhënë në mënyrë të fshehtë një kosovar, i cili në tekst thjesht përcillte në mesazh dhe nuk mund të flitej për vlera artistike. Naim Plaku e zbërtheu mesazhin dhe arriti të ndërtojë me mjeshtëri vargjet e këngës: "O prite Azem Galicën, more heeeeej..." që ishte edhe thirrja e pjesëtarëve të çetës së Azemit kur hidheshin në sulm. Kënga u këndua nga këngëtari dibran Arif Vladi, fill në periudhën e postdemonstratave të vitit 1981, dhe suksesi ishte i jashtëzakonshëm, pasi në çdo tingull dhe varg të saj ndjehej dhe vazhdon të ndjehet krenaria e të qenit shqiptar dhe ëndrra shekullore e popullit kosovar për liri e pavarësi. Edhe kjo këngë, sikurse edhe shumë të tjera, tashmë ka marrë përmasat e vlerave artistike kombëtare.

Ditë pas dite e vit pas viti unë e Naimi asnjëherë nuk u ndjemë të lodhur nga njeritjetri. Numri i kompozimeve të mia me tekstet e Naim Plakut arrin në mbi 150 dhe secili kompozim ka një histori të veten dhe asnjëri nuk është krijuar rastësisht dhe me të drejtë i ndjeri Naim Plaku duke pasur parasysh edhe punën kolosale me libretet e koncerteve të ndryshme të ansamblit "Dibra", qofshin ata artistike apo folklorike më ka quajtur mua, "Miku im i betejave artistike" dhe me të drejtë edhe unë do ta quaj Naim Plakun "Miku im i shtrenjtë i betejave artistike", të cilat i kemi fituar të gjitha!

NAIMI DHE TË TJERËT (KOMPOZITORË DHE KËNGËTARË)

Këtu kam parasysh një ushtri të madhe kompozitorësh dhe këngëtarësh, ushtri të betejave artistike me gjeneral poezie Naim Plakun. Të tillë kanë qenë: i ndjeri kompozitor "Artist i Popullit" Tish Daija, që kompozoi muzikën e këngës "Një gjergjef me lule" me tekst të Naim Plakut, kënduar nga grupi vokal i vajzave të Peshkopisë në takimin e ansambleve artistike të klasës punëtore Durrës, tetor 1984. "Artisti i Popullit" kompozitori Tonin Harapi me romancën lirike "Era këputi një lule blini", kënduar nga Zurka Mati në të njëjtin festival. Kompozitorë të tjerë janë: Ymer Seferi, Lahim Kola, Zef Çoba, Isak Shehu, Xhevat Fana, Xhelil Imeri, Edmond Zhulali, Selami Kolonja në Strugë, Nazim Kaba në Dibër të Madhe, Haxhi Maqellara në Amerikë etj.

Pas kompozitorëve vjen ushtria e madhe e artistëve e këngëtarëve si: Liri Rasha, Caje Poleshi, Zyrka Mati, Flora Toska, Flora Shabani, Fitnete Hoxha, Vera Laçi, Elmonda Feta, Dhurata Shehu, Rozeta Paçuku, Ruhije Hasi, Antike Berisha, Lindita Plaku, Adelina Greva, Lirim Hoxha, Avdyl dhe Ali Sturçe, Skënder Cala, Rakip Poshnjari, Shaban Mziu, Nuz e Baki Dauti, Fatmir Loca, Ylber Sopoti, Eduard Hoxha, Sabrie Hoti, Sherif Dervishi, Myfterim Kupa e Fatmir Daku, Jeta Mazari, Defrim Mandri, Arif Vladi, Qerim Sula, Dritan Jashari etj., të gjithë pjesëtarë të veprimtarive artistike të Shtëpisë së Kulturës Peshkopi.



Përparim Tomçini duke folur gjatë veprimtarisë në kujtim të poetit Naim Plaku. Foto: © Fehmi Lleshi

Më tej vijojmë: Haxhi e Agron Maqellara, Sulejman e Muharrem Borova - Amerikë, Elmaz Lala, Selim Beqiri, Nehat Kupa, Violeta Turkeshi e Habibe Ostreni - Dibër e Madhe, Selami Kolonja, Lirim Skënderi e Drita Kaba - Strugë, Naim Selmani, Drita Sahiti, Xhemail Murtishi, Merita Maqellara e Fortesa Hoti - Zvicër, Jetmir Rexhepi, Hazir Haziri e Besjana Kasami (Big Mama) - Tetovë, Adnan Isaku - Austri, Ilir Shaqiri e Shkurte Fejza - Prishtinë. Ka edhe shumë të tjerë, sidomos këngëtarë të vegjël të qendrës kulturore të fëmijëve të qytetit të Peshkopisë që kanë kënduar në dhjetëra festivale të këngëve për fëmijë, por që unë e kam të vështirë t'i gjej emrat e tyre.

E gjithë kjo ushtri artistike e këngëtarëve i ka kënduar,vazhdon t'i këndojë e do të vazhdojnë të këndojnë edhe "ushtarë " të tjerë artistikë këngët që janë kompozuar mbi bazën e teksteve të poetit Naim Plaku kudo ku ka shqiptarë. Bazuar mbi këto fakte unë do të citoj një shprehje islame që thotë: "Trupi është kasollja e shpirtit njerëzor". Në këtë kuptim, mund të themi se trupi i Naimit ishte një kasolle shumë e vogël për të strehuar shpirtin e madh artistik të tij, pasi një gram shpirt artistik i Naimit, ka peshën e një vlere kombëtare. Këtë e them me bindje të plotë dhe do ta faktoj edhe me ato çka do të citojmë në vijim.

PUBLIKU DHE NAIMI

Po kush ishte publiku i Naimit?

I pari është e do të jetë publiku dibran, i cili e gjen veten në të gjithë krijimtarinë letrare të Naimit. Është publiku gjirokastrit që ka duartrokitur shpesh vargje të këngëve të Naimit. Edhe në festivalin e fundit nuk kishte si të ndodhte ndryshe, ku Qerim Sula dhe grupi i Dibrës do të këndonin:

"Ismaili jep kushtrimin,
Krah për krah me Boletinin,
Ban gajret bir i Kosovës,
i pret plumbat në pllam të dorës"

Ishte publiku austriak që duartrokiti Vera Laçin në interpretimin fantastik të baladës së Drinit të Zi:

"Kur t'vijnë shoqet nanë me m'taku,
U trego shaminë që e kam shkru.
E kam shkru nanë me lotët e mallit,
Në gjergjef kam vu dy sytë e ballit"

Ishte publiku i Strugës që duartrokiste këngëtaren strugane Drita Kaba kur këndonte:

"Derdhen lotët mbushin Drinin,
Treqind nana shkulin gjinin"

Baladë kjo që u kushtohej mbi treqind viktimave shqiptare që u rrëzuan në fillim të viteve nëntëdhjetë me avion në Shkup dhe në Ohër.

E gjithë kjo ushtri artistike e këngëtarëve i ka kënduar,vazhdon t'i këndojë e do të vazhdojnë të këndojnë edhe "ushtarë " të tjerë artistikë këngët që janë kompozuar mbi bazën e teksteve të poetit Naim Plaku kudo ku ka shqiptarë. "Trupi është kasollja e shpirtit njerëzor". Në këtë kuptim, Naimi ishte një kasolle shumë e vogël për të strehuar shpirtin e madh artistik të tij, pasi një gram shpirt artistik i Naimit, ka peshën e një vlere kombëtare.

Ishte publiku i Gostivarit kur këngëtari Zirap Ibrahimi do të këndonte:

"Këtu është dielli,këtu është drita,
Jo nuk shkulet Mitrovica"

Ishte publiku i Kaçanaikut kur Qerim Sula këndonte:

"Jam dibran nga Dibra e Madhe,
N'Dukagjin e kam konakun.
Jam shqiptar në troje shqiptare,
Për vatan e derdhim gjakun"

Ishte publiku i Tetovës që do të shoqëronte në refren këngëtarin Hazi Haziri kur këndonte:

"Kjo Tetova ka hap derën,
Hapi krahët e pret pranverën.
Prej gjithë botës falë me shëndet,
Udhë të mbarë Universitet"

Ishte edhe publiku i Dibrës edhe më gjerë tek duartroket e shoqëron Dritan Jasharin:

"Sillu shqipe nga kalaja,
Kjo është Dibra maja-maja"

E kam të vështirë të përcaktoj publikun që duartrokiti Liri Rashën, e cila ka kënduar në shumë e shumë skena brenda dhe jashtë vendit dhe ku suksesi i saj ka qenë i jashtëzakonshëm qoftë në interpretimin e këngëve të punuara mbi bazën e teksteve të Naim Plakut, qoftë edhe në interpretimin e këngëve të tjera dibrane, të cilat vetëm Liria di t'i këndojë e interpretojë.

Po kështu edhe Caje Poleshi e duartrokitur brenda dhe jashtë Shqipërisë për shumë e shumë interpretime, por e veçanta e këngëve të Cajes është "O mirë se na erdhe!" me tekst në Naim Plakut.


Publiku i Kosovës edhe më gjerë do të duartrokiste Ilir Shaqirin tek interpretonte baladën për vëllanë "Dëshmor i Atdheut":

"Ku po shkojnë vëlla këto pranvera,
Ç'janë këto gjamë që po i jell era
Ç'ka kjo nanë që po i çahet zemra
Or vllau i jem or vlla....."

Unë nuk di t'i harroj kurrë emocionet që na dhanë në mars të vitit 1999 publiku tetovar tek duartrokiste tablonë koreografike "Lulkuqet e Kosovës" me temë nga demonstratat e vitit 1981 me koreografi të Avni Ndreut, interpretuar nga valltarët e SH.K.A "Xheladin Zeqiri" Tetovë, ku për herë të parë në historinë e koreografisë futet si element të saj edhe recitimi, të cilin e interpretoi me shumë përkushtim aktori i ndjerë tetovar Shpend Pustina:

"Pushkë e lodra po gjëmojnë,
Ç'ashtë kjo nuse ku po shkon,
Ç'janë këto krushq larë me gjak,
Ç'asht kjo nuse në demonstratë,
Floktë e gjata i bien mbi supe
Për mbi ballë ka një plag lufte,
Zbret prej kalit heq duvakun
Përmbi tank e ngre bajrakun"

Këto shembuj që i solla janë një përqindje shumë e vogël e atyre emocioneve që kemi përjetuar ne artistët dibranë, por edhe të tjerë me tekstet e të ndjerit Naim Plaku. Ndaj po e mbyll duke përsëritur edhe përforcuar edhe njëherë mendimin tim që: Çdo gram i shpirtit artistik i poetit Naim Plaku ka peshën e një vlere kombëtare.



Lindi prapë një Naim tjetër

(kushtuar mësuesit tim,Naim Plaku)

Nga **JAHE DELIA (SELMANI)**

Në Sllatinë te kullë e moçme,
Lindi prapë një Naim tjetër,
Koh't e para e të soçme,
N'gjerdan këngësh i hodhi n'letër.

Piu ujë në kroje zanash,
S'pushoi pena asnjëherë,
Sa shumë këngë për bij nanash,
I ktheu lule mbi mermer.

Jo veç pushka këndoi në kulla,
Por dhe shqipja nëpër maja,
Zjarr u jep ky Qerim Sula,
Mall e lot Liria e Saja.

T'gjitha lulet e Korabit,
Që i bëri gjerdan kënge,
I vaditëm me lott e mallit,
Për t'i sjellë në ditën tënde.

Ngreu Çajup,mos rri në varr!
Sa ty pena kujt s'i ngjit,
T'i që ngjalle Naimin e parë,
Thuaj:"S'ka vdekë Naimi i dytë!"

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Rruga e Arbërit nr. 111

portret



Vehbi Xheka la gjurmë në Gjoricë me punë dhe projekte

Nga **ZABIT LLESHI**

Komuna Gjoricë pas 23 qershorit 2015 është pjesë e bashkisë së re të Bulqizës. Kryetari i saj Vehbi Xheka përfundoi me sukses mandatin 4-vjeçar dhe e gjetëm duke përgatitur dosjet e dorëzimit të detyrës. Thuhet se tashmë ish-komunat do të kenë disa punonjës, që do të kryejnë shërbimet e domosdoshme për popullsinë, bashkë me një administrator. Është folur gjatë për epërsinë e domosdoshmërisë e krijimit të njësive më të mëdha administrative. Zgjedhjet e treguan këtë, para se bashkitë të fillojnë nga puna. Si qytetarë, urojmë punë të mbarë, kryetarit të ri Melaim Damzi.

Zgjedhjet ishin një testim bashkë me bilancin e punës së komunave. Gjorica pas katër vitesh, me kryetar Vehbiun, realizoi shumë objektiva e zotime, për t'u marrë shembull nga komunat simotra. Zotimet ishin në fushën politike, ekonomiko-shoqërore e social-kulturore. Ata janë të prekshme dhe e radhitën Gjoricën ndër komunat e dalluara jo vetëm në Qarkun e Dibrës, por në shkallë kombëtare.

Pasi fitoi mandatin në vitin 2011, Vehbi Xheka fitoi zgjedhjet në 2013 dhe dha kontribut të rëndësishëm së bashku me Shupenzën (koordinator Rrahman Manjani), për fitoren e koalicionit të PS me LSI në bashkinë e Bulqizës.

Në fushën ekonomike u realizuan disa vepra. U asfaltuan 6 km rrugë automobilistike Ura e Çerenecit – Gjoricë e Poshtme, me zgjerim 2 korsi, 3 km deri në Gjoricë të Sipërme, bashkë me ndriçimin e qendrës së fshatit.

Kanali Lubalesh – Fushë e Thatë (14 km), pas 22 vitesh ndërprerje, u pastrua dhe u sigurua mirëmbajtja; po ashtu vija e Mullirit 6 km u vu në funksionim. U riparuan mullinj e kovaçhane, u zgjeruan rrugët brenda fshatrave, ato të varrezave, bashkë me sinjalistikën e rrugëve të fshatrave, emërtimet etj. Përfundoi ndërtimi I argjinaturës së Drinit, kolektori i ujërave të zeza Çerenec i Poshëm, muri mirëmbajtës, bashkë me kanalin te Lagjia e Duke etj.

Në fushën sociale, kulturore e shëndetësore. Shkolla 9-vjeçare "Ahmet Cami" u rikonstruktua, palestra e re pranë saj 540 m2, shkolla e re "Zenepe Gjata (Miftari) në Çerenc të sipërm, qendra e re shëndetësore "Rizvan Kazani" ka rritur në mënyrë të ndjeshme shërbimet shëndetësore ndaj popullatës.

Komuna ka kryer detyra që në dukje janë të vogla, por që luajnë rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të banorëve. U bënë emërtimet e rrugëve, të shkollave, mirëmbajtja e tyre, pajisja me orendi e shkollave dhe institucioneve etj. Administrata e Komunës ka qëndruar në krye të këtyre punëve, nën drejtimin e kryetarit. Gjithashtu kanë ndier përgjegjësinë e tyre Këshilli i Komunës, me kryetar Shyqyri Ballën, duke u vënë në funksion të kryerjes së detyrave. "Kryetari dhe Këshilli i Komunës kanë qenë në unitet e harmoni për zgjidhjen e problemeve të ndryshme", thotë ish-kryetari i komunës, Ferit Cami.

Shumë i 'bezdisur' ishte Vehbi Xheka për ministrat, drejtorët e ministrive., prefekturën, qarkun etj. Ai me projekte në dorë, javën e punës e fillonte në dyert e ministrive si në atë të Bujqësisë, të Transportit, industrisë etj. Ai respektohej për korrektësinë në shpenzimin e fondeve, realizimin e projekteve në kohë e me cilësi. Sigurisht që merrte falenderime jo vetëm nga zgjedhësit, përfaqësuesit e drejtuesit e pushtetit vendor e qendrorë. Falenderimet i vinin nga nga banorët, nga emigrantët, mësuesit, mjekët, gratë, forumet partiake e shoqëria civile. Mbështetje për Komunën Gjoricë ka dhënë edhe deputetët e Dibrës, Shkëlqim Cani - ministri i Financave dhe Përparim Spahiu.

UJËSJELLËSI I RI PËR GJORICËN

Gjatë gjithë mandatit, kryetari Vehbi Xheka pati një merak: Ujësjellësin për Gjoricën. Ky ujësjellës mbarte historira të vjetra, ëndrra e projekte të hershme, po asnjëherë të realizueshme. Ishte një zotim i Vehbiut ky projekt. Me vullnet të madh, këmbëngulje e pasion, kërkoi pranë institucioneve shtetërore akoordimin e fondeve për ujësjellësin Ostren i Vogël - Gjoricë. Ai tashmë u bë realitet duke e lidhur kontratën me 10 korrik 2015. Ujësjellës është 16 km i gjatë linjë kryesore dhe 4 km linja shpërndarëse. Marrin ujë fshatrat Viçisht, Çerenec i Sipërm, Çerenec poshtëm, Dy Gjoricat, pra rreth 1000 familje me 5400 banorë.

Financimi i objektit do të bëhet nga grandet e vëna në dispozicion nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-kanalizimeve, me vlerë kontrate mbi tetëdhjetë e tre milionë lekë.

Tenderi u zhvillua në Komunën e Gjoricës, me kontratë midis Komunës Gjoricë, përfaqësuar nga kryetari Vehbi Xheka dhe operatorëve ekonomikë EGLAND shpk dhe ALBLEAA INTERNACIONAL shpk. Afati i përfundimit të fazës parë, linja kryesore gjashtë muaj (180 ditë). Kjo vepër është një fitore e gëzim i madh, pasi historikisht uji ka qenë problem i pazgjidhur për Gjoricën. Ajo ka shfrytëzuar disa burime që gjithsesi nuk i plotësonte nevojat. Cilësia e këtij uji është shumë e mirë dhe do ndikojë në shëndetin e njerëzve të këtyre fshatrave, duke zbutur edhe dallimet midis fshatit dhe qytetit.

Historia e vuajtjeve dhe përpjekjeve për ujë të pijshëm do të harrohet shpejt, ndërsa në memorien e popullit do të ruhet puna e përkushtimi i kryetarit Vehbi Xheka. Vendi i punës nuk është i përjetshëm, aq më pak si drejtues. Merita e Vebiut është se në komunën e Gjoricës ai la gjurmë për të cilën populli do të gëzojë respekt e do të jetë mirënjohës.

Kudo e kurdoherë, nga banorët dhe gjithë komuniteti i fshatrave të Gjoricës do dëgjojmë të thonë: Faleminderit, Kryetar!



portret

Përparim Duka, intelektuali që vlerëson vendlindjen - Katër Grykët

Nga **MEVLUD BUCI**

Rinjohja me Përparim Dukën, intelektual i Katër Grykëve, Dibër, e sjell gjithnjë atë demonstrim të natyrshëm të thjeshtësisë dhe të së vërtetës, harmonizuar në një pikëtakim që është përçuarja e atyre vlerave drejt një reflektimi realist për jetën dhe vendlindjen.

Vendlindja si nocion hapësinor shkrihet në vertikalitetin e një ndjesie të hershme që nga fëmijëria e shkollimi, suksesi në jetë dhe arrin një mendim në stadin e kthyerjes së borxhit ndaj saj. Ky borxh mblidhet në ideotemën se çfarë mund të bësh për të, si mund t`i vesh energjitë, kurajon intelektuale në shërbim të saj, edhe pse sot shumë gjëra percepitojnë shpejt dhe koha jonë shpesh pështjellohet nga dilema dhe mundësi që nuk e afrojnë njëra-tjetrën në mundësinë e një zgjidhje optimale.

Në radhë të parë ajo që quhet lidhja shpirtërore me vendlindjen manifestohet tek ky njeri në trajtën më të qëndrueshme. Jo vetëm si nderim për brezat dhe traditat aq të vyera, si veneracion për gjurmët historike të të parëve, por edhe në përballimin e sfidave të të sotmes. Shteti shqiptar, sot, disa zona malore i ka lënë në harresë. Edhe pse ato mbajnë resurse të shkëlqyera turistike, bimë medicionale, apo të ardhura të tjera, të cilat specifikohen si të fjetura nga mos eksplorimi e mos shfrytëzimi, interesi i shtetit dhe shoqërisë për to është i pakët. Kjo varet nga mundësitë e pakta financiare, shpopullimi herë-herë i pajustifikuar, largësia prej qendrave, mos investimi në kohë e tjerë faktorë të ndryshëm social politikë dhe kulturorë, që përbëjnë tregues dekurajues.

Shumë njerëz të cilët në pamundësi për ta gjetur veten atje, ikën drejt qendrave të mëdha, drejt metropolit. Atje ata njohën edhe suksesin, ndaj sot është detyrë e tyre të kthejnë sytë, vëmendjen drejt vendlindjes, ata nuk janë misionarë, po, thjesht njerëz që vihen para një misioni human, kur është fjala në kontributin ndaj vendlindjes.

Familja Duka e Qafë Murrës, kulla e të paharruarit Hazis Duka, është e përmendur në histori, për atdhetari, qëndresë, mikpritje. Po t'i referohemi historisë, plaku i mençur çidhnak Selim Leshi argumenton se "Duka i Qafë Murrës ishte gjenerali më besnik në kalanë e Stelushit, kala kjo, ngjitur me Qafë Murrën.

Geni pason genin. Përparim Duka eci në rrugën e xhaxhallarëve të tij si i talentuari drejtor i SMT-ve, agronom, Abaz Duka, apo të nderuarit, Rifat e Rexhep Duka. Njëzet metra ndanë përroi varosh u hodh Gjergji me kalë dhe gjurmët e kalit të tij ndodhën sot nëpër gurë. Po kështu, qëndresë të rrallë fisi Duka dhe fiset e tjera, bënë edhe në betejën e Talmuranës në hyrje të Vranisë. Kështu, kohë pas kohe, e vit pas viti me armë në dorë për liri, flamur, komb e vendlindje.

Në histori ndodhin disa procese të pakuptueshme. Në kohra luftrash, qëndrese dhe kërcënimi të ekzistencës, këto vende jo vetëm nuk u shpopulluan, por edhe u shtuan, sepse luftrat e ardhshme kërkonin njerëz, trima, luftëtarë. Atëherë, si ndodhi që në periudhën e demokracisë kemi një lëvizje demografike që pothuajse i la vetëm këto male. Kjo nuk ka ndodhur vetëm me Qafë Murrën, Katër Grykët, por, pothuajse me vise të tjera malore të Shqipërisë.



Përparim Duka

Në të gjitha shkrimet që rrokin këtë temë, pothuajse e gjen këtë theksim, si një ide mospranuese apo si një mundësi për rikthim. Duke iu rikthyer atij raporti ekzistencial midis njerit dhe dheut të lindjes, raport i definuar përmes përmasave shpirtërore, shpesh tek njerëz të caktuar, siç më ndodh me Përparim Dukën, e gjej këtë si shpresë, se diçka do bëhet në të ardhmen edhe për këto zona.

Përparim Duka u lind më 27 maj 1976 në qytetin e minatorëve, Bulqizë. Nxënës i shkëlqyer që kërkonte mineralin e dijes thellësive të enigmave të vështira, ashtu si babai i tij, Feriti kërkonte thellësive të minierës mineralin e kromit. Kjo e bëri atë që të mësojë shumë, ashtu siç ndodhte rëndom me mjaft fëmijë të atyre zonave ku sedra dhe dëshira shtynin njëra tjetrës drejt shkollës.

Unë si ish mësimdhënës dhe punëtor i drejtimit, drejtor i shkollës, ruaj kujtimet më të çmuara për të. Ai studionte, krijonte, shëmbëllente dhe aktivizohej në mësim dhe jashtë tij. Kështu, Përparimi do ta mbarojë shkëlqyeshëm shkollën e mesme topografike dhe të lartën për menaxhim biznes, e më pas do të ngjitë shkallët e suksesit si biznesmen i fabrikës së artikujve ushqimorë të fëmijëve në Qytetin e Nxënësit.

Vlerësime të mira, madje shumë të mira, bën për të deputeti Ulsi Manja dhe kryetari i ri i Bashkisë Dibër, Shukri Xhelili. Gjer këtu kemi nënvizuar atë që mund të thuhet për një njeri suksesi, po sa njerëz të suksesshëm ka sot? Sa prej tyre meqë arrijnë një standard ekonomik, transferojnë kapitalet jashtë shtetit, fëmijët i shkollojnë jashtë shtetit, ose bëjnë një jetë të vakët sociale, ndërsa as kujtohen të shohin një herë rrënjët e të parëve, rrënjët e tyre, e quajnë veten kozmopolitë. Këta njerëz të rrethuar me roje, apo të zhytur në ngjyrën e errët të xhamave të makinave luksoze e humbin gjykimin dhe kridhen në një botë krejtësisht të shkëputur nga populli, nga njerëzit e thjeshtë. Madje prej tyre disa e kanë për turp të tregojnë se nga janë. Pastaj as bëhet fjalë të hedhin ndonjë mendim për fatin e vendlindjes, larg qoftë edhe ndonjë investim sado të vogël për ndonjë shkollë apo kopësht, sepse trurin e tyre e ka mpirë ideja fikse e parasë.Në bisedë me Përparimin nuk mund të mos hetosh lehtësisht shqetësimet e tij për vendlindjen, për zonën kaq të bukur të Katër Grykëve. Sapo sillet biseda për një zonë të caktuar, ajo së pari fillon me rrugët. Gjuha shkon ku dhemb dhëmballa. Rrugët automobilistike Lis - Vinjoll - Qafë Murrë-Muhurr, pastaj pikat turistike mjaft të bukura si njëmbëdhjetë liqenet e Kacnisë, Prati, Vanasi, rrugët brenda fshatrave të Katër Grykëve, për të vijuar tek vlerat muzeale, kultura etj., prodhimi, blegtoria, tregu.

Sot Katër Grykët janë nën juridiksionin e Bashkisë së Dibrës. Natyrisht, kjo ndarje e re administrative do ta sjellë edhe një shpresë për investime, po të kemi parasysh komunat e vogla me pak banorë që ishin e që s'bënin asgjë. Por, kësaj bashkie i duhet dhënë projekti, duhet të shfrytëzohet mirë mendimi i intelektualëve të zotë, duhet punuar fort e duhet trokitur drejt aty ku duhet, sepse mundësitë i zotërojnë jo vetëm njerëzit e ditur po edhe guximtarë e të respektuar dhe me reputacionin e nevojshëm. Kujdesi për t`i zgjedhur ato nuk duhet të ndikohet nga ethet fisnore, as njohjet personale e të tjera gjëra që ecin në kundërvajtje me zgjedhjen e drejtë.

Është koha e vlerave, humanizmit dhe e një mendimi që duhet ta kapërcejë interesin meskin personal në emër të diçkaje më të madhe, më të qenësishme dhe njerëz të tillë ka plot. Një sugjerim përmes një shkrimi nuk është se zgjidh ndonjë gjë, po sidomos e sensibilizon diçka. Përparim Duka i njohur për projektet dhe ndihmesat ndaj vendlindjes, mund të jetë administrator i suksesshëm i kësaj zone në suazën e Bashkisë Dibër me qendër në Peshkopi. Vënia e njerëzve të provuar në suksesin e tyre personal, të angazhuar në mendimin politik dhe si veprimtarë shoqëror do të sillte të tjera mendësi, të tjera vrulle tek njerëzit, një komunikim më praktik me ta në dobi të komunitetit. Këtë e shoh edhe si një shpresë që këto zona malore të thella të mos lëngojnë më në nga gjumi i indiferencës dhe i apatisë ku i pat zhytur një administratë komunale që nuk kishte mundësi dhe në mundësitë e pakta nuk dinte çfarë të bënte. Kjo mund të bëhej një realitet premtues edhe po të shikonim psikologjinë e re të drejtimit që vjen nga kjo ndarje dhe zgjedhjet administrative. Ka mjaft njerëz që i kanë përqafuar këto mendësi dhe një nga këta është Përparimi tek i cili, gjithë cilësitë që thashë më lart, i shoh në perfeksionin e një djali modern.

Pasionin, humanizmin,dëshirën dhe thjeshtësinë për komunikim me njerëzit, nevojën e shtrimit të problemeve dhe të sqarimit të tyre përmes një debati konstruktiv i shoh tek ky njeri jo si rreshtim elokuent i nevojës për elozhe të pamerituara, por si vlera që tek shumë të tjerë lëkunden ose nuk e gjejnë vendin e merituar sa tek Përparimi. Kjo vjen, siç e theksuam, edhe tek ajo traditë familjare, tek ajo lidhje dhe formim që vjen nga vendlindja, por edhe nga spikatja e një personaliteti që gjithçka e ka arritur vetë, me djersë, pasion duke guxuar dhe sakrifikuar në emër të kapjes së standardeve të reja jetësore. Dhe, zakonisht, njerëz të tillë që nuk kanë pasë nevojë për paterica, dinë të sjellin modelin e punës së vet edhe tek të tjerët, dinë të rrezatojnë përvojat dhe vetitë e tyre modestish, larg shtirjes, e mbi të gjitha, dinë të përcjellin e të konfirmojnë projekte të reja për këto zona që, një ditë ato të shkunden nga apatia e braktisjes, harresa dhe injorimi shekullor, duke u integruar me pjesët e tjera, jo vetëm në infrastrukturën rrugore, po edhe në ekonomi, turizëm, biznes.

Dhe bijtë e tyre më të mirë do hapin perspektiva zhvillimore. Një i tillë është edhe Përparim Duka...

Homazh

Mensur Bekteshi, atdhetar dhe humanist i shquar

Të dielën më 28 qershor, në moshën 70-vjeçare, në Prishtinë papritur pushoi së rrahuri zemra e Mensur Bekteshit atdhetarit dhe humanistit dibran.Mensuri u lind në Dibër të Madhe në një familje me taban dibran dhe mbarë kombëtar, ku u brumos me edukatën e mirfilltë humane dhe kombëtare. Aftësia e tij dhe komunikimi i tij i ngrohtë me njerëzit, shpirti i tij i pastër, sjellja e tij fisnike dhe virtytet e tij të larta njerzore do të mbesin shembëlltyrë dhe udhërëfim për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Shkollën fillore e kreu në Dibër, atë të mesme në Manastir kurse studimet në Fakultetin e Veterinarisë në Universitetin e Zagrebit. Si student ishte aktivist i dalluar në Shoqatën studentore "Shkëndija" ku mernin pjesë studentë nga tërë trevat shqiptare në ish Jugosllavinë. Mensuri ishte pjesëmarës në recitalin kushtuar 500-vjetorit të lindjes së heroit kombëtar Skënderbeut të përgatitur nga studentët shqiptarë të Zagrebit. Me këtë recital mori pjesë sëbashku me shoqatat studentore "Përpjekja" e Beogradit, "Lulzimi" i Sarajevës dhe "Ramiz Sadiku" e Prishtinës, që organizuan kremtimin e këtij jubileu mbarëkombëtar që u mbajt në këto qytete në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar. Punoi në Dibër,Gjakovë dhe Prishtinë. Gjenocidi serb i vitit 1999 në Kosovë e detyroi që sëbashku me 1 milion kosovarë të tjerë të shpërngulet me bashkëshorten dhe fëmijët fillimisht në Tiranë, pastaj në Dibër të Madhe dhe nga Dibra për në SHBA. Mensuri gjatë tërë jetës së tij mbajti kontakte të vazhdueshme me intelektualët nga tërë treva shqiptare duke u angazhuar për çështjen mbarëkombëtare dhe për përparimin e shqiptarëve në trojet shqiptare. As malet e Evropës dhe as valët e oqeanit nuk aritën ti'a shuajnë dashurinë për vendlindjen, të cilën e vizitonte gjatë pushimeve për çdo vit për tu çmallur me shokët dhe farefisin. Para se të ndërojë jetë ai arriti në Dibër të Madhe për tu çmallur. Me këtë rast i ndjeri Mensur vizitoi edhe Zerqanin në Shqipëri ku kishte jetuar dhe punuar gjyshi i tij Rexhepi, dhe ku kishte lindur babai i tij Shuipi, të cilin në vitin 1947 përshkak të ideve të tij demokratike dhe mbarëkombëtare sistemi monist i Enver Hoxhës e burgosi dhe e dënoi me 10 vite burg.Pas vuajtjes së dënimit Shuipi iku për në Dibër të Madhe ku iu bashkua familjes së tij.

Humanizmi i Mensurit dëshmohej me ndihme konkrete dhe të menjëhershme sa herë që dëgjonte se dikush ka vështirësi financiare. Rrallë mund të gjejmë person që jetoi me aqë devotshmëri dhe respekt për të tjerët siç ishte Mensuri.Ai u varros më 30 qershor në Dibër me nderime të mëdha nga bashkëqytetarët e tij, shokët, farefisi dhe miqtë e dashamirët e tij nga Gjakova, shumë qytete të Kosovës,të Maqedonisë dhe



Mensur Bekteshit

Shqipërisë. U varros pranë prindërve të tij të urtë e bujarë, pranë babait Shuip dhe nënës Verdije i ndjeri Mensur la pas bashkëshorten Dashnore nga Gjakova, djemtë Brikendin e Blendin dhe vajzën Brikenën, të cilët nuk rreshtin ta duan Dibrën dhe Gjakovën ngjashëm si babai i tyre.Familjes Bekteshi i aritën shumë telegrame ngushëllimi:

Flora Brovina nga Prishtina- "Ngushëllime familjes, e kisha koleg e shok, ishte njeri bamirës, fisnik i dashur për familje e miq.Qoftë i përjetshëm kujtimi për Mensurin tonë".

Prof.Dr.Skënder Kodra Neë York – "Ngushëllime familje,fisit, kolegve dhe të gjithë patriotëve të kombit. Isha i privilegjuar që ta njoh Mensurin duke punuar sëbashku. Kishte virtyte të larta njerëzore dhe kombëtare.Nderoi Dibrën,dibranët dhe mbarë kombin. Pusho i qetë miku im në botën e amshimit ".

Selman Ferhati-"Me dhimbje dhe keqardhje të thellë mësova për vdekjen e papritur dhe të parakohshme të Mensur Bekteshit, mikut dhe shokut tim të çmuar, bujar,zemërmadh,i virtytshëm, fisnik e atdhetar i madh dhe i përkushtuar. Shpreh ngushëllimet e mija të sinqerta familjes të të ndjerit Mensur".

Musa Paçuku,kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibra në SHBA – "Mensur Bekteshi ishte një veprimtar i dalluar. Ai ishte një burrë i rralllë që do ti mungojë këtij komuniteti të dibranëve dhe do ti mungojë familjes, miqve dhe shokëve, të gjithë dashamirëve të tij".

Haxhi Maqellara, këngëtari dhe kompozitori i mirënjohur, dibran, - "Ngushëllimet më të thella për vdekjen e mikut tim Mensur Bekteshi. Ai ishte Model i qytetarisë dibrane, atdhetar e patriot, demokrat i flakët, bujar dhe humanist, i përkushtuar për familjen , fjalë pak dhe i dashur me të gjithë"

Rexhep TORTE

Gjenden xhevahire në Shpellën e Rusit




Shpella e Sopanikës

(Vijon nga faqja 13)



Pamje nga Shpella e Rusit





Pamje e brendshme e shpellës së Sopanikës

pranë Federatës Evropiane të Speleologjisë, anëtar i komisioneve për studim dhe për bibliografi pranë Bashkimit Speloeologjik Ndërkombëtar pranë UNESKO-s. Ai është autor i 9 librave dhe mbi 250 artikujve.

Kërkimi i tyre në shpellat e Rusit dhe Sopanikës, sipas Zhellov, është bërë me lejen e Ministrisë së Mjedisit të Shqipërisë.

HEC-I MBI SETË, KËRKOHET NDALIMI I DHËNIES SË LEJES

Por ndërkohë që studiuesit bullgarë gjejnë xhevahire, pasuri natyrore e turistike në Çidhën që në të ardhmen mund të rriste numrin e vizitorëve në rajon, duket se procesi i ndërtimit të një hidrocentrali mbi lumin Seta po vazhdon.

Me gjithë kundërshtimet e shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", institucionet e qeverisë shqiptare po vazhdojnë dhënien e lejeve për të bërë të mundur ndërtimin e tij.

"Shoqata e quan ekspeditën e paleologëve bullgarë si të fundit, pasi me ndërtimin e HEC, i cili i mbledh të gjitha burimet e lumit në një tubacion me diametër 2 m dhe gjatësi 1870 m, do ta prishë gjithë ekosistemin e rajonit dhe do t'i japë një dëmtim të madh të ardhmes së turizmit në rajon", shkruhet në faqen në Facebook të shoqatës.

Një peticion me afro 700 firma është firmosur kundër hidrocentralit, por duket se qeveria shqiptare është e angazhuar për ta përfunduar procesin e dhënies së lejes. Gjatë një takimi të disa anëtarëve të shoqatës në Ministrinë e Energjisë, u është bërë e ditur se firma i ka marrë të gjitha lejet dhe është gati për të marrë lejen finale për të vazhduar punimet.

Kundërshtarët e HEC thonë se me ndërtimin e kësaj vepre energjetike, do të zhduken pasuritë e shpallura Monument Natyre, siç janë Gryka e Lumit Seta dhe kanionet e saj të papërsëritshme, shpella dhe burimi i Sopanikës dhe burimet natyrore të Kllogjneshës. Gjithashtu, në dëm të pariparueshëm do të pësojë flora, fauna dhe pasuritë arkeologjike e historike të paeksploruara në zonë.

"Këto dëme do të jenë të pariparueshme, thotë një anëtar i kryesisë së shoqatës, pasi firma për ndikimin mjedisor ka parashikuar vetëm 2 milionë lekë".

Ministria e Energjetikes, e Mjedisit, e Kulturës , e Rregullimit të Territorit, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore etj., e kanë dhënë lejen për këtë HEC, por është koha që institucionet në këtë vend të bëjnë një verifikim të asaj që ka ndodhur, pasi, sipas kundërshtareve, të gjitha këto leje janë marrë në kundërshtim me ligjin.



Shpella e Sopanikës

ANULLIMI I LEJES, SHPRESOHET TE VENDIMI FINAL I QEVERISË

Por ndërkohë që dukej se, pavarësisht kundërshtimeve, punimet në terren mund të fillojnë së shpejti, një dritë shprese vjen nga kryeminisri Edi Rama.

"Të gjithë ato që nuk kanë filluar, nuk do fillojnë. Do të ndalohen", tha ai prerë gjatë konferencës "zhvillimi i burimeve natyrore në harmoni me mjedisin", majtur të martën më 28 korrik në Tiranë.

Ai premtoi se së shpejti do të miratohet një ligj që do ti japë fund njëherë e mirë krimeve mjedisore në vend, në emër të investimeve.

" Shumë shpejt, do t'i çojmë parlamentit një paketë të re për krimet mjedisore dhe do të mendojmë në mënyrë shumë të ndjeshme ndëshkimet për të gjithë ata që prekin nga një pemë deri te një pyll i tërë", tha kryeministri gjatë fjalës së tij.

"Ne nuk do të ndalemi! Ne nuk do të kemi asnjë tolerancë për të gjithë ata që vazhdojnë të shfaqin sjellje barbare apo dhe të papërshtatshme me mjedisin", theksoi Kryeministi.

Duke përshkruar gjendjen e mjedisit në vend, Kryeministri Edi Rama tha se "se shumë kompani, të cilat kanë operuar qoftë në sektorin e ndërtimit të HEC-eve, vazhdojnë t'i kenë detyrime të rënda shoqërisë dhe një pjesë e tyre për vite të tëra as nuk kanë denjuar të paguajnë garancinë e rehabilitimit. Pa llogaritur faktin që në të shkuarën batërdia e korrupsionit dhe pa dyshim e këtij modeli zhvillimi pa asnjë qëndrueshmëri ka sjellë një numër të drejtash apo lejesh të dhëna për HEC-e ndër të cilat 113 janë drejtpërdrejtë në zona të mbrojtura. Pra, zona të përcaktuara ligjërisht si zona të paprekshme nga rrugët e zhvillimit dhe prej tyre 42 janë tanimë në prodhim, 23 janë ende në proces ndërtimi, ndërsa 58 të tjera nuk kanë filluar dhe nuk kanë për të filluar punë, pasi në projektligjin që propozohet për të rishikuar lejet e dhëna do të ndalohet një herë e mirë ndërtimi i HEC-eve apo i çfarëdo lloj tjetër aktiviteti në zonat e mbrojtura".

Fotografitë janë nga klubi "Heliktit" dhe Aleksej Zhallov

cyan magenta yelloë black